



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 109

Tiranë – E premte, 9 korrik 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 387, datë 30.6.2021	Për miratimin e raportit të 13-të dhe 14-të periodik kombëtar për zbatimin e konventës ndërkombëtare, “Për zhdukjen e të gjitha formave të dallimit racor”..... 10027
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 30.6.2021	Për miratimin e raportit të tretë periodik kombëtar për zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike..... 10075
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 394, datë 30.6.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1151, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore”..... 10121
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 8.7.2021	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH)..... 10123
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 422, datë 8.7.2021	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Arbas Hoxha..... 10123
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 423, datë 8.7.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall”, të ndryshuar..... 10123
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 8.7.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji”, dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat”, Bashkia Tiranë”, të ndryshuar..... 10124
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 8.7.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar”, të ndryshuar 10124

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 8.7.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave”, të ndryshuar.....	10125
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 427, datë 8.7.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në bashkitë Kamzë dhe Kavajë dhe caktimin e tyre si njësi zbatuese”, të ndryshuar.....	10126
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 428, datë 8.7.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Kurbin dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese.....	10126
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 269, datë 1.7.2021	Për përcaktimin e procedurës së regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, të refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.....	10127
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 277, datë 1.7.2021	Për miratimin e formularit, në zbatim të nenit 10, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.....	10128
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5436, datë 6.7.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rehabilitimi i fasadës së pallatit të kryqëzimit të Rrugës së Dibrës me Unazën e Vogël”, Tiranë.....	10131
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Osman Halilaj..	10133
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Kol Nikolla.....	10133



VENDIM
Nr. 387, datë 30.6.2021

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË 13-të
DHE 14-të PERIODIK KOMBËTAR PËR
ZBATIMIN E KONVENTËS
NDËRKOMBËTARE, “PËR ZHDUKJEN
E TË GJITHA FORMAVE
TË DALLIMIT RACOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 9, të konventës ndërkombëtare, “Për zhdukjen e të gjitha formave të dallimit racor”, aderuar me ligjin nr. 7768, datë 9.11.1993, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të 13-të dhe të 14-të periodik kombëtar për zbatimin e konventës ndërkombëtare, “Për zhdukjen e të gjitha formave të dallimit racor”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave
të Diskriminimit Racor
(CERD)**

**SHQYRTIMI I RAPORTEVE DËRGUAR
NGA SHTETET PALË
NË MBËSHTETJE TË NENIT 9/1/b TË
KONVENTËS
“PËR ZHDUKJEN E TË GJITHA
FORMAVE TË DALLIMIT RACOR”
SHQIPËRIA**

**Raporti Periodik Kombëtar
Çikli 13-14**

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve

Hyrje

I. Masat për zbatimin e neneve të Konventës kundër Dallimit Racor

Neni 1

Neni 2

Neni 4

Neni 5

Neni 6

Neni 7

Masat për zbatimin e vëzhgimeve dhe rekomandimeve përfundimtare

Shtojcat

LISTA E SHKURTIMEVE

AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
CAT	Komiteti i Konventës kundër Torturës
DPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DNJF	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
KiE	Këshilli i Evropës
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MKRDHF	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të dhunës në familje



MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
QKPA	Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkues
RSH	Republika e Shqipërisë
VP	Vëzhgimet përfundimtare
VT	Viktimat e trafikimit
VTM	Viktimat e mundshme të trafikimit

I. HYRJE

Republika e Shqipërisë ka aderuar në Konventën Ndërkombëtare “Për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Dallimit Racor”¹, me ligjin nr. 7768, datë 9.11.1993.

Bazuar në nenin 9, pika 1/b të Konventës CERD, Shqipëria ka paraqitur pranë Komitetit të Konventës (Komiteti CERD), raporte kombëtare sipas cikleve periodike, mbi zbatimin e dispozitave të Konventës CERD dhe të rekomandimeve të Komitetit të Konventës CERD².

Komiteti mori në shqyrtim raportet e kombinuara të ciklit 9–11, paraqitur në një dokument, në mbledhjet e tij të mbajtur në dhjetor 2018³ dhe miratoi vëzhgimet përfundimtare në datën 2 janar 2019⁴.

Ky Raport është hartuar në përputhje me udhëzimet specifike (*guidelines*)⁵, për hartimin e raporteve periodike. Në pjesën e parë të Raportit trajtohen masat e ndërmarra për zbatimin e dispozitave të Konventës, zhvillimet kryesore në kuadrin ligjor, institucional sipas fushave. Në pjesën e dytë trajtohen masat për zbatimin e vëzhgimeve përfundimtare dhe rekomandimeve të Komitetit CERD. Raporti përfshin informacion kryesisht mbi periudhën janar 2019 – prill 2021. Gjithashtu, përfshihet informacion edhe mbi zhvillimet dhe arritjet para kësaj periudhe, në funksion të një

raportimi të plotë mbi çështjet që mbulon Konventa CERD. Në shtojcat, pjesë përbërëse të Raportit paraqitet informacion shtesë mbi zbatimin e saj.

Kushtetuta e RSH-së, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, që janë pjesë e sistemit ligjor të brendshëm dhe kuadri ligjor i brendshëm, garantojnë zbatimin në praktikë të të drejtave të njeriut.

Mbështetur në ligjin nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” (neni 25, pika 3), ministrat dhe institucionet kompetente, informojnë periodikisht Ministrinë për Evropën dhe Punët të Jashtme (MEPJ), në funksion të hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, në të cilat RSH-së është palë. Bazuar në pikën 4 të këtij neni, MEPJ-ja drejton procesin e hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve për të drejtat e njeriut, të cilat i paraqet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 112, datë 5.3.2014, “Për ngritjen e grupit ndërmintor të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, MEPJ-ja koordinon procesin e përgatitjes së raporteve kombëtare mbi zbatimin e konventave për të drejtat e njeriut. Ky Raport është hartuar si rezultat i koordinimit dhe përfshirjes të kontributeve të institucioneve qendrore si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në këtë Raport janë përfshirë edhe kontributet e institucioneve të pavarura, si: Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komiteti i Pakicave Kombëtare.

Raporti Periodik Kombëtar mbi Zbatimin e Konventës CERD miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në shtojcat pjesë përbërëse e këtij Raporti paraqiten gjithashtu informacione shtesë, sipas çështjeve dhe fushave, që trajton Konventa.

¹ Këtej e tutje Konventa CERD. Versioni anglisht i Konventës – Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination.

² Këtej e tutje Komiteti CERD.

³ CERD/C/SR.2693 and 2694.

⁴ CERD/C/ALB/CO/9-12.

⁵ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme – General Assembly resolution 68/268.



I. INFORMACION MBI ZBATIMIN E NENEVE TË KONVENTËS CERD

Neni 1. Përcaktimi dhe parashikimet ligjore rreth përkufizimit të diskriminimit

1. Kushtetuta e RSH-së, e ndryshuar, sanksionon parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit. Në nenin 18, parashikohet: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”. Neni 16/1, i Kushtetutës, parashikon se të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë, vlejné njëloj edhe për të huajt, edhe për personat pa shtetësi në territorin e RSH-së.

2. Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (i ndryshuar), e përkufizon diskriminimin, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1, të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e RSH-së, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH-ja, si dhe me ligjet në fuqi (neni 3).

3. Me ligjin nr. 124/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’”, u miratuan në datën 15 tetor 2020 ndryshimet ligjore në ligjin, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të cilat hynë në fuqi më 18 nëntor 2020. Janë shtuar shkaqe të reja të diskriminimit, si: diskriminimi për shkak shtetësisë, karakteristikat e seksit, jetesa me HIV/AIDS dhe pamja e jashtme. Me ndryshimet e reja ligjore përcaktohen forma të reja të diskriminimit, si: diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, gjuha e urrejtjes, veçimi, shqetësimi seksual. Përcaktohen “format e rënda të diskriminimit”, të cilat meritojnë të ndëshkohen më rëndë dhe të parandalohen kudo ku shfaqen.

Neni 2. Informacione mbi masat ligjore, institucionale kundër dallimit apo diskriminimit racor

4. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH-së”, neni 5, lidhur me ushtrimin e të drejtave, parashikon se: 1. Çdo person, që i përket një pakice kombëtare, ka të drejtën të zgjedhë lirisht që të trajtohet ose jo si i tillë, duke mos pasur asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që janë të lidhura me këtë zgjedhje. 2. Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, i ushtrojnë të drejtat dhe gëzojnë liritë e garantuara me këtë ligj, në mënyrë individuale dhe në komunitet me të tjerët, në të gjithë territorin e RSH-së.

5. Në nenin 8, të këtij ligji “Ndalimi i diskriminimit”, parashikohet se:

- Ndalohet çdo diskriminim ndaj cilido personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare.

- Institucionet publike, qendrore dhe vendore, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme:

- a) për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës;

- b) për të mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional;

- c) për të forcuar dialogun ndërkulturor;

- d) për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional.

- Masat e miratuara në përputhje me pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë akte diskriminimi.

6. Ndryshimet e reja ligjore në ligjin nr. 124/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’”, përcaktojnë:

- forma të reja të diskriminimit, si: diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi



ndërsektorial gjuha e urrejtjes, veçimi, shqetësimi seksual;

- “format e rënda të diskriminimit”, të cilat meritojnë të ndëshkohen më rëndë dhe të parandalohen kudo ku shfaqen;

- përcaktohet roli aktiv i organizatave me interesa legjitime, duke u mundësuar atyre paraqitjen e ankesave drejtpërdrejt pranë institucionit ose mund të paraqesin informacion të besueshëm për nisjen e hetimeve kryesisht nga Komisioneri;

- përcaktohet detyrimi i autoriteteve publike për të promovuar barazinë dhe mosdiskriminimin.

- Mundësia e marrjes së ekspertëve kur shqyrtohet çështja në varësi të kompleksitetit të fushës ku po hetohet (mendim profesional). Ndryshimet sigurojnë, gjithashtu, mundësinë e bashkimit të rasteve, për ekonomi procedurale, që vijnë nga subjekte të ndryshme, por që kanë të njëjtin objekt dhe i referohen së njëjtës sjellje diskriminuese të pretenduar.

- Komisionerit KMD i është shtuar edhe një kompetencë e re, krahas monitorimit të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, siç është monitorimi i zbatimit të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

7. Kuadri ligjor dhe nënligjor, që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit, përbën një garanci për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, trajtimin në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare, filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale, përkatësisë prindërore. Ligji nr. 108, datë 31.7.2014, “Për Policinë e Shtetit” përcaktohen parimet bazë që udhëheqin veprimtarinë e Policisë dhe, në veçanti, mosdiskriminimi dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

8. Në nenin 115 garantohet e drejta që kanë personat e shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar për të paraqitur kërkesë/ankesat lidhur me qëndrimin, trajtimin, kushtet e trajtimit, sjelljet/qëndrimin e personelit policor, shkeljet dhe abuzimet që kryhen ndaj të drejtave të tyre. Në nenin 133 përcaktohen rregullat për përdorimin e forcës nga Policia.

9. Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së”⁶ garanton të drejtën për azil të shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, i cili ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi për shkak të frikës së bazuar për të qenë i persekutuar për arsye të racës, të besimit fetar, të kombësisë, të anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose të bindjes politike (neni 5).

Neni 4. Eliminimi i nxitjes së frymës së urrejtjes dhe veprimeve diskriminuese

10. Në Kodin Penal (i ndryshuar) parashikohen dispozita që dënojnë nxitjen e frymës diskriminuese, si më poshtë:

- Neni 50/j ku parashikohet qartësisht se kryerja e një vepre penale për motive diskriminimi racor, do të shërbejë si rrethanë rënduese në caktimin e dënimit.

- Neni 84/a parashikon: “Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, që i bëhet një personi, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, për shkak përkatësie etnike, kombësie, race apo feje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet”.

- Neni 119/a parashikon: “Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”.

- Neni 119/b parashikon: “Fyerja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”.

- Neni 253 “Shkelja e barazisë së shtetasve”. Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti

⁶ I cili ka qenë në fuqi deri në hyrjen e ligjit të ri për azilin, ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së”, miratuar nga Kuvendi, më 1.2.2021.



gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

- Neni 265 “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”: “Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet”.

- Neni 266 “Thirrja për urrejtje nacionale”: “Vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet”.

11. Ndryshimet e reja ligjore në ligjin nr. 124/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” mundësojnë detyrimin e medias kombëtare për të publikuar vendimet e Komisionerit KMD që kanë gjetur diskriminim përmes gjuhës së urrejtjes. Vendosja e një detyrimi të tillë do të mundësojë një efektivitet më të madh. Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, ndryshimet e fundit ligjore në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi (neni 33, pika 17), parashikojnë se: “Operatorët mediatikë shtetërorë kanë detyrimin që të publikojnë përmbledhjen e vendimeve të formës së prerë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt gjuhën e urrejtjes”. Gjithashtu, në kuadër të ndryshimeve ligjore është parashikuar detyrimi i autoriteteve publike për të promovuar barazinë, për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (neni 7/3).

12. Detyrimi i publikimit vetëm për këtë formë diskriminimi lidhet, së pari, me faktin që konsumimi i kësaj sjelljeje ndodh publikisht, prandaj dhe vendimi i marrë duhet të këtë rezonancë publike; së dyti, lidhet me efektshmërinë e vendimeve të Komisionerit në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga

personat publikë. Vendosja e një detyrimi të tillë do të mundësojë rritjen e efektivitetit të tij.

Neni 5. Barazia përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, lidhur me të drejtat politike, civile dhe sociale, ekonomike dhe kulturore

13. Kushtetuta parashikon një sërë dispozitash mbi garantimin e ushtrimit të të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë personat pavarësisht nga gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Gjithashtu, Kushtetuta garanton se çdo individ, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kuadri ligjor dhe nënligjor sipas fushave synon garantimin dhe zbatimin në praktikë të të drejtave të njeriut (të drejtat e grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e pakicave kombëtare etj.).

14. Ligji nr. 124/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” sjell si risi “zhvendosjen e barrës së provës”, duke i kaluar subjektit ndaj të cilit pretendohet se ka kryer sjellje diskriminuese. Sigurimi i zhvendosjes së barrës së provës në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” do të sigurojë zbatimin e këtij parimi në çdo fushë dhe në të gjitha rastet kur pretendohet se nuk zbatohet parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit.

15. Këto ndryshime ligjore kanë parashikuar, gjithashtu, kompetencën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), për të paraqitur padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektivë dhe të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Me ndryshimet ligjore, vendimet me gjobë të Komisionerit KMD do të konsiderohen si “tituj ekzekutivë” për lehtësimin e procedurave të ekzekutimit të



gjobave (pas vendimit të gjykatës për lëshim urdhri ekzekutimi).

E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur

16. Kodi Zgjedhor, i ndryshuar⁷, në nenin 3 “Parime të përgjithshme”, parashikon garancitë kushtetuese për të gjithë shtetasit shqiptarë të së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, duke përcaktuar:

- zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës;
- çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod”.

17. Në nenin 63, të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se: “Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.

- Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.

- Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69, të Kushtetutës, dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie apo komune ose për këshillat vendore në KZAZ.

- Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, ka të drejtë të zgjidhet si kandidat i një partie politike, kandidat i një koalicioni partish politike apo i mbështetur nga një grup zgjedhësish.

18. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, përcakton se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka si kompetencë drejtimin e punës për edukimin,

informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve. Për zgjedhjet parlamentare të datës 25 Prill 2021, KQZ-ja ka punuar për hartimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend.

19. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” parashikon garancitë ligjore, garantimin e të drejtave të pakicave kombëtare si (të drejta individuale), të drejtat dhe liritë themelore, si të drejtat civile, politike, sociale etj., që Kushtetuta dhe kuadri ligjor dhe nënligjor sipas fushave parashikojnë për të gjithë shtetasit shqiptarë. Garantimi i të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare bazohet në kriteret e përcaktuara nga konventat ndërkombëtare: kriteret objektive, të cilat kanë të bëjnë me ekzistencën e karakteristikave etnike, kulturore, fetare, gjuhësore të veçanta dhe të qëndrueshme, nga pjesa tjetër e popullsisë të këtij grupi, shfaqjen e vullnetit për të ruajtur kulturën, traditat, fenë, gjuhën e tyre, si dhe kriterin që nënkupton zgjedhjen personale për të qenë ose jo pjesë-pjesë e pakicës kombëtare.

20. Ligji nr. 96/2017 plotëson kuadrin ligjor dhe institucional për pakicat kombëtare në Shqipëri, si dhe shërben për qartësimin e politikave ndaj pakicave, duke adresuar rekomandimet e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër. Ky ligj adreson një sërë çështjesh që lidhen me: përkufizimin, kriteret ligjore të njohjes, shmangien e dallimeve midis pakicave kombëtare dhe atyre etno-gjuhësore, si dhe përmban parashikime ligjore për garantimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe mekanizmat e përfaqësimit. Ky ligj parashikon përkufizimin e një pakice kombëtare, duke eliminuar diferencimin e dy kategorive të pakicave (pakicave kombëtare dhe etnike-gjuhësore) dhe njohjen formale të pakicave si pakica kombëtare. Për qëllimet e këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë: pakica greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

21. Garantimi i të drejtave të personave që u përkasin minoriteteve/pakicave kombëtare bazohet në kriteret e përcaktuara nga

⁷ Miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjet nr. 74/2012, datë 19.7.2012, nr. 31/2015, datë 2.4.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020 dhe nr. 118/2020, datë 5.10.2020.



konventat ndërkombëtare: kriteret objektive lidhur me ekzistencën e karakteristikave etnike, kulturore, fetare, gjuhësore të veçanta dhe të qëndrueshme, nga pjesa tjetër e popullsisë të këtij grupi, shfaqjen e vullnetit për të ruajtur kulturën, traditat, fenë, gjuhën e tyre, si dhe kriterin që nënkupton zgjedhjen personale për të qenë ose jo pjesë-pjesë e pakicës kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është pandashmërisht e lidhur me kriterin objektiv të identitetit të personit dhe nuk nënkupton thjesht një të drejtë për një individ që të zgjedhë arbitrarisht që t'i përkasë një pakice kombëtare.

22. Ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij synojnë të garantojnë gëzimin dhe ushtrimin e plotë të së drejtave individuale të personave që u përkasin pakicave kombëtare, për të mbrojtur identitetin e veçantë të pakicave kombëtare, mosdiskriminimin dhe barazinë para ligjit. Kuadri ligjor dhe nënligjor bën të mundur marrjen e masave konkrete për të mbrojtur të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare, si: e drejta për të shprehur lirisht përkatësinë e tyre, për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre, elemente të veçanta që karakterizojnë jetën e komunitetit të tyre, mësimin e gjuhës amtare, veprimtarinë kulturore, ushtrimin e kultit fetar etj.

23. Ligji nr. 96/2017 “Mbi pakicat kombëtare” (neni 15/4, “Përdorimi i gjuhës”) parashikon, ndër të tjera, se: Në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat, që u përkasin pakicave kombëtare, përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj njësie, ata kanë të drejtë të marrin informacion, krahas gjuhës shqipe edhe në gjuhën e pakicës, mbi zhvillimin e procesit zgjedhor. Dhënia e informacioneve në gjuhën e pakicave për zhvillimin e procesit zgjedhor rregullohet me akte të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për zgjedhjet parlamentare të datës 25 Prill 2021, KQZ-ja ka punuar për hartimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend.

24. Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” parashikon parimet e ndihmës juridike nëpërmjet: a) aksesit të barabartë të individëve në ndihmën

juridike; b) barazisë dhe mosdiskriminimit të individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike; c) profesionalizmit në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike; ç) cilësisë, eficiencës dhe efikasitetit në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike; d) ruajtjes së konfidencialitetit; dh) shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit; e) mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël.

25. Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku barazia dhe mosdiskriminimi përmenden që në parimet e përgjithshme të tij. Ligji përcakton se çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar “masat e mbrojtjes” që mund të aplikojnë punonjësit/punonjëset kur konstatojnë raste të fëmijëve në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Për herë të parë parashikohet mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge apo që punojnë/shfrytëzohen për punë, adresimi i formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve, si: bulizmi, dhuna në shkollë, në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik, siguria e fëmijëve në internet, fëmijët e pashoqëruar ose viktimat të trafikimit etj.

26. Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, ku parimi i mosdiskriminimit për një tërësi shkaqesh, duke filluar nga gjinia, renditet në parimet bazë për ofrimin e shërbimeve. Ligji, gjithashtu, parashikon ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të trafikuar, për gratë dhe vajzat shtatzëna ose prind i vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç etj.

27. Ligji nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në RSH”, që, ndër të tjera, synon punësimin e personave të pafavorizuar në tregun e punës, si: personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, jetimet/jetimët, gratë viktimat të dhunës dhe trafikimit etj. Ligji 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, parashikon “Grupe të veçanta” të punëkërkues(e)ve të disavantazhuar(a) në tregun e punës, të cilët/cilat përfitojnë nga shërbimet dhe programet e nxitjes së punësimit. Ndër punëkërkuesit të disavantazhuar në tregun e



punës, janë edhe persona nga pakicat rome dhe egjiptiane.

28. Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në RSH” përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale. Një nga parimet e këtij ligji është mosdiskriminimi, që përcakton të drejtat që burojnë nga ky ligj pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga: gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.

Neni 6. Mbrojtje dhe mjete juridike efektive (barazia para ligjit) ndaj çdo veprimi të diskriminimit racor

29. Mbështetur në Kodin e Procedurës Penale (KPP), dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit (neni 2).

30. Ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale’, të ndryshuar”, parashikon:

- Të drejtat e viktimës nga vepra penale: gjatë procedimit penal, viktimat ka të drejtat e parashikuara nga ky Kod. Organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga ky Kod.

- Dispozitat procedurale mbi rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.

- I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.

- Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

- Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit.

- Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit. Cilësia e të pandehurit rimerret kur priset vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit (neni 34).

31. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale (i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) përmirësojnë ndjeshëm të drejtat dhe pozitën e viktimës së veprave penale, duke përfshirë edhe parashikime të posaçme për viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore. Më konkretisht, është prezantuar detyrimi për pjesëmarrjen si palë në proces të viktimës së veprës penale, duke garantuar aksesin e saj në procesin penal, janë shtuar nene të tjera, specifikisht për viktimat e trafikimit, në të cilat janë parashikuar si figura të posaçme viktimat e mitur dhe viktimat e abuzuar seksualisht apo subjekt i trafikimit, përkatësisht nenet 58, 58/a dhe 58/b, 59, 60 dhe 61 të KPP-së.

32. Ndryshimet dhe shtesat e vazhdueshme në Kodin Penal⁸ e parashikojnë dhunën në familje si vepër penale me sanksionet përkatëse (neni 130/a)⁹, konkretisht: rrahja; kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë ndaj personit në lidhje familjare.

33. Ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, që garanton një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët,

⁸ Në vitet 2012, 2013 dhe 2020.

⁹ Informacion i detajuar jepet në vijim.



promovon riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe parandalon riviktimizimin/viktimizimin dytësor të fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një veprë penale.

34. Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ka hyrë në fuqi, më datë 1.6.2018, dhe qëllimi i tij është krijimi i një sistemi ligjor, të konsoliduar, lidhur me ofrimin e ndihmës juridike falas, për të gjithë individët në sistemin e drejtësisë dhe garantimi i aksesit të barabartë, si dhe ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

35. Ligji nr. 111/2017, ndër të tjera, garanton ndihmë juridike falas për kategori të veçanta: viktima të dhunës në familje, abuzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore, të mitur/mitura në konflikt me ligjin, fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim etj. Ky ligj ka përforcuar aksesin në drejtësi, duke i dhënë mundësi ligjore të gjitha kategorive përfituese sipas këtij ligji, të përfitojnë ndihmë juridike, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre, të cilët janë edhe personat, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

36. Ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSH”, përmirëson qasjen e viktimave në informacion përmes vendosjes së një koordinatori/koordinatoreje për marrëdhëniet me publikun në secilën prokurori, përgjegjës/përgjegjëse për informimin e viktimave. Në këtë kuadër, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr. 17/2020, “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtjeje”. Ky udhëzim synon unifikimin e masave procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm. Hetimet dhe ndjekja penale në çështjet për veprat penale kundër dhunës ndaj grave dhe

dhunës me bazë gjinore të jenë në afate të shpejta, eficiente dhe me kërkesa për masa dënimi efektive, proporcionale dhe frenuese, që kontribuojnë në parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të autorëve të këtyre formave të kriminalitetit.

37. Ligji nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”, parashikon forcimin e masave mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave, përmes lëshimit të urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme. Për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesë ose bashkëjetesë. Ligji u ndryshua edhe në tetor 2020, duke saktësuar masat për largimin e dhunuesit nga banesa dhe kthimin me mbarimin e afatit të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes UM/UMM, programet specifike të rehabilitimit për dhunuesin, regjistrin e UMM/UM-ve etj.

38. Ky ligj synon në:

- parandalimin dhe reduktimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;

- përmirësimin e masave mbrojtëse të parashikuara në ligj në kuadrin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrit të mbrojtjes, duke pasur parasysh sidomos përmirësimin e masave mbrojtëse për fëmijët;

- rritjen e ndihmës së kualifikuar gjyqësore falas;

- përcaktimi i afateve të qarta procedurale, për regjistrimin e kërkesës për urdhër mbrojtje (UM) dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM) dhe për ankimet ndaj vendimeve gjyqësore;

- përcaktimi më i qartë i organeve përgjegjëse për kryerjen e detyrave dhe i përgjegjësisë së zyrtarëve;

- parashikimi shprehimisht i detyrimit të organeve shtetërore për të ofruar falas, çdo shërbim ekspertize për rastet e dhunës në familje;

- rritja e pjesëmarrjes së dhunuesve në shërbimet specifike të rehabilitimit me fokus të veçantë dhunuesit e alkoolizuar, drogë ose me çrregullime të shëndetit mendor, të dhëna



qartësisht në vendimet e gjykatave për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.

39. Ligji nr. 81/2020¹⁰, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ka si qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues. Ndër parimet e këtij ligji (neni 5), parashikohet se të burgosurit trajtohen në mënyrë të barabartë, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

40. Ky ligj parashikon, krijimin dhe funksionimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (Mekanizmi Kombëtar) i krijuar në përputhje me legjislacionin për Avokatin e Popullit. Mekanizmi Kombëtar vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, paraburgimit dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, me qëllim që të forcohet mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues, si dhe paraqet rekomandime për organet përkatëse.

41. Në nenin 115, të ligjit nr. 108.2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, është përcaktuar: e drejta për të paraqitur kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore nga çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë, si dhe çdo shtetas tjetër lidhur me sjelljen/qëndrimin dhe veprimet e policisë, si dhe detyrimin e policisë për të evidentuar/regjistruar, trajtuar, zgjidhur dhe kthyer përgjigje ankuesit/kërkuesit. Kuadri ligjor parashikon:

- të drejtën për të paraqitur ankesë/kërkesa nga personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuarit në ambientet e policisë, si dhe çdo shtetas tjetër që cenohet nga veprimet e qëndrimet e policisë;

- mënyrat e bërjes së ankesave me gojë ose me shkrim;

- institucionet se ku drejtohen ankesë/kërkesat, si: drejtuesve të policisë dhe institucioneve të tjera shtetërore;

- të drejtën për personat e shoqëruar që t'i drejtohen gjykatës në çdo kohë;

- detyrimin e policisë për të evidentuar e trajtuar ankesë kërkesat e paraqitura;

- afatet e trajtimit të ankesë/kërkesave dhe kthimit të përgjigjeve për ankuesit: nëse ankesa drejtohet drejtuesve të policisë ku është i shoqëruari apo ndaluar përgjigja duhet të jepet menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë.

42. Është hartuar dhe vënë në zbatim procedura standarde e punës për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e policisë dhe zgjidhja e ankesë/kërkesave të tyre. Pjesë përbërëse e procedurës standarde për trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar janë dhe rregullat për evidentimin, trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave që bëhen nga personat e shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar. Janë miratuar:

- urdhri nr. 938, datë 24.7.2017, i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit mbi procedurat dhe rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit;

- urdhri nr. 925, datë 18.7.2019, “Për miratimin e procedurës standarde të punës: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

43. Gjatë periudhës 2019 – në vijim, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka nxjerrë në sërë aktesh administrative:

- tërheqje vëmendje nr. 3582, datë 2.5. 2019, “Për zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, në ambientet e njërive vendore të policisë”;

- tërheqje vëmendje e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit (DPPSH) nr. 5669/2, datë 15.8.2019, “Për respektimin e të drejtave të njeriut gjatë përdorimit të forcës në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiive ligjore nga Policia e Shtetit”;

¹⁰ Hyrë në fuqi në qershor 2020.



- letërporosi e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 5126, datë 15.8.2019, “Për respektimin e të drejtave të komuniteteve/pakicave kombëtare, parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve diskriminuese që cenojnë dinjitetin e tyre”;

- letërporosi e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 6104/3, datë 2.9.2019, “Për njohjen e raportit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit”;

- letërporosi e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 278/1, datë 15.1.2020, “Për zbatimin me korrektësi të ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, në veçanti të të drejtave të fëmijëve, gjatë kryerjes së veprimeve policore dhe procedurale nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit”;

- Tërheqje vëmendje nr. 1449/2, datë 2.3.2020, “Për zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde për sigurimin dhe trajtimin e të arrestuarve/ndaluarve dhe shoqëruarve në ambientet njësive policore”;

- letërporosi e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 4641/2, datë 26.8.2020 “Shoqërimin e personave, respektimin dhe garantimin e të drejtave të tyre në ambientet e Policisë së Shtetit, konform akteve ligjore dhe nënligjore”;

- tërheqje vëmendje e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 293, datë 16.2.2021, “Për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave gjatë shoqërimit, arrestimit, ndalimit në ambientet e Policisë së Shtetit, si dhe së drejtës së organizimit, pjesëmarrjes në tubime paqësore të të miturve”.

Neni 7. Masat kundër diskriminimit në fushën e arsimit, kulturës dhe informacionit

Në fushën e arsimit

44. Ligji nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH-së (i ndryshuar)” garanton të drejtën për arsimim të shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga: gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet

politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar (neni 5). Personave që u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore (neni 10).

45. Ligji nr. 96/2017, “Për pakicat kombëtare në RSH-së” (neni 13), parashikon të drejtën e arsimit në gjuhën e pakicës kombëtare: 1) Personat, që i përkasin një pakice kombëtare, gëzojnë të drejtën të mësojnë gjuhën e pakicës. 2) Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ato banojnë tradicionalisht ose në numër thelbësor, nëse ka kërkesë të mjaftueshme, u sigurohen mundësi për të mësuar ose për të marrë mësim në gjuhën e pakicës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit. Ligji përcakton:

- Kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrave përgjegjës për arsimin dhe çështjet vendore.

- Masat e përshtatshme në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor, me qëllim nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare dhe të shumicës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.

- Masat e përshtatshme për krijimin e mundësive dhe kushteve për pajisjen me tekste shkollore, formimin fillestar, trajnimin dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.

- Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të hapin dhe të



drejtojnë institucione private të sistemit arsimor parauniversitar dhe institucione të arsimit profesional, kur plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi në fushën e arsimit.

46. Në zbatim të ligjit nr. 96/2017, në fushën e arsimit janë miratuar një sërë aktesh nënligjore për garantimin e së drejtës së arsimit të pakicave kombëtare, hapjen dhe funksionimin e klasave për mësimin e tyre, pajisjen me tekste shkollore etj.

47. VKM nr. 561, datë 29.9.2018, “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”; bazuar në VKM-në nr. 561, datë 29.9.2018, nisma për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, njësia arsimore vendore përkatëse dhe komuniteti i zonës, ku pritët të hapen klasa të pakicave kombëtare. Klasat në gjuhën e pakicave kombëtare hapen kur numri i nxënësve të pakicave është jo më i vogël se 15 nxënës për klasë, ndërsa në raste të veçanta kur numri i nxënësve të pakicave është më i vogël se 15 nxënës për klasë, funksionimi i klasave me nxënës të pakicave bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

48. VKM nr. 562, datë 29.9.2018, parashikon masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë.

49. Bazuar në VKM-në nr. 227, datë 17.4.2019, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve publike parauniversitare ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”, përgatiten, shtypen, botohen dhe shpërndahen tekstet shkollore në gjuhën amtare të pakicave kombëtare. Ky vendim dhe udhëzimi i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 1.7.2020, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të

arsimit parauniversitar”, përcaktojnë që nxënësve të arsimit bazë të pakicave kombëtare, u sigurohen tekste shkollore në gjuhën amtare falas.

50. VKM nr. 1155, datë 24.12.2020, “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”. Ky vendim ka për qëllim t’u garantojë personave, që u përkasin pakicave kombëtare, të drejtën për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare në institucione arsimore parauniversitare, të caktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, sipas kurrikulave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

51. VKM nr. 1155, datë 24.12.2020, parashikon kriteret, për:

- numri i personave që i përkasin pakicës kombëtare, i cili duhet të jetë jo më pak se 20 për qind e numrit të përgjithshëm të banorëve të njësisë administrative, si nënndarje e bashkisë;

- periudha e regjistrimit si banor në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas periudhave të regjistrimit të popullsisë, konfirmuar me vërtetim të lëshuar sipas të dhënave nga regjistrat themeltarë të gjendjes civile dhe/ose Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010. Kjo periudhë të lidhet me periudhat kur është kryer zyrtarisht regjistrimi i popullsisë, fakt që mund të vërtetohet nga regjistrat e gjendjes civile;

- kërkesa shkresore, paraqitur nga prindër apo kujdestarë të fëmijëve që i përkasin pakicës kombëtare, pranë bashkisë/njësisë administrative, ku shprehet vullneti në mënyrë shkresore dhe bazuar në të drejtën e vetë identifikimit, të mjaftueshme për formimin e klasës;

- për krijimin e klasave të pakicave kombëtare, për të lehtësuar dhe mundësuar mësimin e këtyre nxënësve, propozohet që numri i nxënësve për klasë të jetë 15, numër i dallueshëm ky nga krijimi i klasave të tjera të sistemit arsimor parauniversitar;

- njësitë e vetëqeverisjes vendore i kanë të drejtën e nismës për hapjen e klasave në gjuhën



e pakicave kombëtare në përputhje me parashikimet në ligjore për krijimin dhe funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare.

52. VKM nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar” dhe VKM nr. 682, datë 29.7.2015, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar, parashikojnë masa konkrete për garantimin e së drejtës për arsimimin e pakicave kombëtare. Prej vitit shkollor 2020–2021, nxënësit në arsimin bazë, që u përkasin pakicave kombëtare, si dhe nxënësit në arsimin parauniversitar që u përkasin pakicës rome dhe pakicës egjiptiane përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin në masën 100% të çmimit të teksteve shkollore. Është miratuar udhëzimi i përbashkët nr. 18, datë 1.7.2020, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”.

53. Në zbatim të ligjit nr. 96/2017, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpropozim me Ministrinë e Kulturës kanë propozuar VKM-në nr. 463, datë 3.7.2019, “Për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur e zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre”. Në institucionet arsimore parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, ka plane të veçanta për promovimin e kulturës, gjuhës dhe identitetit të pakicave kombëtare.

54. Në sistemin arsimor parauniversitar publik funksionojnë institucione arsimore parauniversitare ku mësojnë fëmijët e pakicës kombëtare greke dhe ata të pakicës kombëtare maqedonase. Në kuadër të riorganizimit të njësive arsimore vendore, që u bë në vitin

2019, iu kushtua rëndësi që institucionet arsimore ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, të mbulohen nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) të veçanta. Institucionet arsimore parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicës kombëtare greke, mbështeten nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si: ZVAP Gjirokastër–Libohovë, ZVAP Sarandë–Konispol–Delvinë dhe institucionet arsimore, ku mësojnë nxënës të pakicës kombëtare maqedonase, mbështeten nga ZVA Korçë–Pustec. Zyra Vendore Arsimore Finiq–Dropull, për Bashkinë e Dropullit dhe për Bashkinë e Finiqit” është miratuar me urdhrin nr. 176, datë 1.7.2020, “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 234, datë 19.4.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ‘Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar’” (i ndryshuar).

55. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) ka hartuar planin mësimor për pakicat kombëtare, i cili është miratuar edhe nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në institucionet arsimore parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, si në të gjithë sistemin arsimor shqiptar zbatohet kurrikula e re, e bazuar në kompetenca. Programet mësimore të pakicave kombëtare janë të publikuara në faqen e ASCAP-it. Programet mësimore janë njësoj si në shkollat e tjera të sistemit arsimor parauniversitar. Programet mësimore për pakicat kombëtare janë hartuar nga ASCAP-ja, konkretisht, 45 programe mësimore lëndore, ku përfshihen edhe programet specifike:

- Gjuha amtare greke;
- Gjuha amtare maqedonase;
- Historia e Greqisë;
- Gjeografia e Greqisë;
- Historia e Maqedonisë së Veriut;
- Gjeografia e Maqedonisë së Veriut.

56. Agjencia ASCAP, për zbatimin e kurrikulës së re, ka trajnuar mësuesit e sistemit arsimor parauniversitar, përfshirë edhe mësuesit e pakicave kombëtare për çështjet e mëposhtme:

- Kurrikula e bazuar në kompetenca;
- Planifikimi i kurrikulës;



- Metodologjia e mësimdhënies së kurrikulës së bazuar në kompetenca;

- Vlerësimi i nxënësit me kurrikulën e re.

57. Mësuesit e pakicave kombëtare janë trajnuar çdo vit nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për mësimdhënien e kurrikulës me kompetenca. Në kuadër të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë janë ngritur rrjetet profesionale për çdo lëndë për arsimin parauniversitar. Disa nga këto rrjete lëndore drejtohen nga mësuesit e pakicave kombëtare.

58. Në zbatim të kurrikulës me kompetenca për të gjithë arsimin parauniversitar u hartuan programe të reja lëndore sipas kësaj kurrikule. Nxënësit pakicave kombëtare në arsimin bazë zhvillojnë në gjuhën e tyre amtare lëndë, si: Gjuhë amtare, Histori amtare, Gjeografi amtare, Dituri natyre, Matematikë 1–5, Biologji, Art pamor, Muzikë, Qytetari etj. Përveç programeve të përbashkëta, për nxënësit e pakicave kombëtare u hartuan 22 programe specifike për gjuhën, historinë dhe gjeografinë amtare greke dhe maqedonase. Këto programe u hartuan nga grupe pune me pjesëmarrjen e pedagogëve nga Departamenti i Gjuhës Greke dhe Qytetërimit Grek në Gjirokastër dhe Tiranë, si dhe nga mësues të gjuhës greke dhe të gjuhës maqedonase.

59. Institucionet arsimore parauniversitare publike ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare janë në bashkitë: Gjirokastër, Dropull, Sarandë, Delvinë, Finiq, Pustec¹¹. Numri i nxënësve të pakicave kombëtare greke dhe maqedonase, që kanë ndjekur shkollën, sipas viteve shkollore përkatëse në arsimin publik, janë:

- viti shkollor 2016–2017 – gjithsej 763 nxënës dhe 101 mësues;
- viti shkollor 2017–2018 – gjithsej 685 nxënës dhe 94 mësues;
- viti shkollor 2018–2019 – gjithsej 611 nxënës dhe 96 mësues;
- viti shkollor 2019–2020 – gjithsej 565 nxënës dhe 87 mësues.

60. Në kurrikulat shkollore janë përfshirë: kultura, historia dhe traditat e pakicave

kombëtare. Parashikohet hartimi i materialeve ndihmëse (udhëzues, programe trajnimi, module mësimore) për mësuesit, në mënyrë që të trajtojnë në mënyrë më efektive kulturën, traditat dhe historinë e pakicave në praktikën e tyre në klasë/shkollë.

Në fushën e kulturës

61. Ligji nr. 96/2017 “Mbi pakicat kombëtare” (neni 12) “Ruajtja e identitetit kulturor të pakicave kombëtare”, parashikon se:

- personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre gjuhësor, kulturor, fetar dhe trashëgiminë e tyre kulturore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

- personat, që u përkasin pakicave kombëtare, gëzojnë, në përputhje me përcaktimet e nenit 2, të këtij ligji, të drejtën e kreutimit të ngjarjeve që lidhen me promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor;

- strategjitë, programet dhe planet e veprimit për të krijuar kushtet e nevojshme që pakicat kombëtare të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre të dallueshëm miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrave përgjegjës për arsimin dhe kulturën;

- ndalohen politikat apo praktikën që synojnë asimilimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare kundër vullnetit të tyre, a cenuar masat e marra në përputhje me politikën e integritetit të përgjithshëm të pakicave kombëtare.

62. Në zbatim të ligjit nr. 96/2017, janë miratuar:

- VKM nr. 462, datë 3.7.2019, “Për miratimin e masave dhe të politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në RSH-së”, parashikon, ndër të tjera:

- Personave, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, u garantohet pjesëmarrje e barabartë në jetën publike, ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit.

- Personat, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, gëzojnë, në veçanti, të drejta lidhur

¹¹ Informacion mbi arsimimin e nxënësve të pakicave rome dhe egiptiane jepet në vijim.



me çështjet për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e kulturës, të traditave dhe identitetit të pakicës, së cilës ata i përkasin.

- VKM nr. 463, datë 3.7.2019, “Për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre”. Personat që u përkasin pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre të dallueshëm në RSH-së, konkretisht:

- Ministria përgjegjëse në fushën e kulturës dhe ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë kanë detyrimin për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve e të planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat, që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementet themelore të identitetit të tyre.

- Në programin kombëtar “Edukimi përmes kulturës” parashikohen dhe krijohen kushtet e nevojshme për ruajtjen, promovimin, mbrojtjen, katalogimin e digjitalizimin për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës e të identitetit të personave, që u përkasin pakicave kombëtare dhe ndalimin e praktikave, asimiluese.

- Planifikimi i veprimtarive të veçanta për institucionet publike të arsimit parauniversitar, me qëllim ruajtjen, promovimin, zhvillimin e kulturave, identitetin kulturor të dallueshëm dhe të gjuhëve të pakicave kombëtare.

- Mbështetja e të rinjve e organizatave rinore për organizimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe promovuese për ruajtjen e zhvillimin e kulturave, të identitetit dhe të gjuhëve të pakicave kombëtare, trashëgimisë kulturore të tyre.

- Promovimi i programeve, projekteve për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturave, gjuhëve dhe elementeve kryesore të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare, zhvillimin e aktiviteteve në konsultim me ta dhe përfaqësuesit e tyre, bazuar në nevojat e

grupeve të ndryshme dhe në përputhje me procedura transparente.

63. Objektivi i Ministrisë së Kulturës është sigurimi i një aksesit më të madh dhe pjesëmarrje aktive në kulturë, duke zhvilluar dhe zbatuar projekte që mbrojnë dhe promovojnë identitetin kulturor dhe gjuhët e pakicave kombëtare. Aktivitetet në përmbushje të këtij objekti janë:

- Mbështetja financiare nga MK-ja e rrjetit të aktiviteteve të organizuara nga shoqatat kulturore të pakicave kombëtare apo që përfshijnë kulturën e grupeve të ndryshme kulturore.

- Publikimi i literaturës së shkruar në gjuhën e pakicave, me ose pa përkthim në gjuhën shqipe.

- Rritja e përfaqësimit të grupeve nga pakicat kombëtare në festivalet artistike kombëtare e ndërkombëtare të organizuara nga MK-ja.

- Dhënia e asistencës profesionale dhe këshillimit për standardet e dokumentimit të diversitetit dhe trashëgimisë jomateriale të pakicave (trajnime, seminare).

64. Për projektet e paraqitura nga pakicat kombëtare parashikohet për herë të parë, përcaktimi me përqindje për projektet nga pakicat kombëtare, konkretisht:

- “Nga numri i përgjithshëm i projekteve që do të financohen, 5% e tyre të mbështeten me burime financiare, logjistike dhe/ose materiale për shoqatat kulturore/individët, të cilët kanë aplikuar dhe që u përkasin pakicave kombëtare”.

- Ministria e Kulturës, në projektet me thirrje, që organizon çdo vit, mbështet financiarisht, bazuar edhe në nivelin cilësor, projektet e personave që u përkasin pakicave kombëtare në drejtim të mbrojtjes së identitetit kulturor, etnik e gjuhësor dhe trashëgiminë kulturore të tyre.

- Kriteret dhe procedurat e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të pakicave kombëtare në projekte të ndryshme bëhen në përputhje me ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, dhe udhëzimin e përvitshëm që nxjerr Ministria e Kulturës, “Për thirrjet për projektpropozime”.



65. Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025¹², pas dëgjësive me të gjitha grupet e interesit. Kjo Strategji ka si qëllim “Nxitjen dhe përfaqësimin e vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimin e praktikave më të mira. Si objektiv specifik parashikohet “Promovimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore”. Për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare në vend do të përcaktohet mbështetja financiare e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe studimore të kësaj trashëgimie me synim mbrojtjen dhe katalogimin e digjitalizimin për ruajtje të kulturës e identitetit të pakicave kombëtare dhe ndalimin e praktikave, që synojnë asimilimin e kulturës dhe të identitetit të tyre të dallueshëm. Ky aktivitet do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin e Pakicave Kombëtare.

66. “Edukimi përmes kulturës” parashikon dhe krijon kushtet e nevojshme për ruajtjen, promovimin, mbrojtjen, katalogimin e digjitalizimin për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës e të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare si pasuri, vlerë dhe pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare.

Në fushën e informacionit – aksesit në media

67. Ligji nr. 96/2017, “Mbi pakicat kombëtare” (neni 14) “Liria e shprehjes, e mendimit dhe e drejta e informimit”, parashikon:

- Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u garantohet dhe gëzojnë të drejtën të shprehin mendime dhe opinione, si dhe të marrin e të shpërndajnë informacione në gjuhën e pakicave, pa diskriminim dhe pa ndërhyrjen e autoriteteve publike.

- Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të kenë median e tyre të shkruar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë për median e shkruar dhe elektronike.

- Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të përdorin

shërbimet e mediave audio dhe audiovizive, pa diskriminim, në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mediat audiovizive në RSH-së.

- Licencimi i shërbimeve të radiopërhapjes dhe televizionit bëhet pa diskriminim dhe në përputhje me kriteret e legjislacionit për mediat audiovizive. Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, gëzojnë të drejtën e informimit në gjuhën e tyre amtare.

68. Ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në RSH-së”, sanksionon ndalimin e programeve që përmbajnë ose nxisin diskriminimin racor ose lloje të tjera diskriminimi. Ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinore, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi”. Transmetimet audiovizive respektojnë të drejtën e barazisë dhe mosdiskriminimit për çdo shkak të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar”.

69. Prej vitit 2017, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) realizon çdo 6 muaj monitorimin dhe vlerësimin e ndërtimit të paketës programore të transmetuesit publik, RTSH. Në njërin prej kanaleve, konkretisht të RTSH 2, që është kanal me format të përgjithshëm, transmetohen edhe programe të përditshme informative dhe argëtuese për pakicat kombëtare (në gjuhën bullgare, greke, arumune, rome, maqedonase, serbe dhe malazeze). Bazuar në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në RSH-së, përmbajtja e programeve është konform kontratës së shërbimit të RTSH-së, konceptuar dhe hartuar prej saj dhe miratuar në vitin 2017 nga AMA.

70. Radio-Televizioni Shqiptar (RTSH), si i vetmi transmetues publik në Shqipëri, e ka zgjeruar gamën e programeve në gjuhën e pakicave kombëtare nga viti 2016. RTSH-ja ofron shumëllojshmëri programesh në gjuhën e pakicave kombëtare, si nëpërmjet kanalit të RTSH 2 ashtu dhe nëpërmjet Radio Tirana. Prej dhjetorit 2016, RTSH-ja ka filluar transmetimin për publikun nëpërmjet një kanali të dedikuar për pakicat në strukturën programore të RTSH-së. Kanali RTSH 2 është i vetmi kanal që transmeton larmishmëri programesh informative dhe kulturore në

¹² Miratuar me VKM-në nr. 903, datë 24.12.2019.



gjuhën e pakicave kombëtare, lajme, aktivitete të ndryshme kulturore, si këngë e valle në gjuhën e pakicave kombëtare. Çdo javë korrespondentët, të cilat janë pranë zonave ku banojnë kryesisht pakicat kombëtare, trajtojnë tematika të ndryshme nëpërmjet kronikave që realizojnë në terren. RTSH 2 transmeton seriale në gjuhën e pakicave kombëtare. Gjithashtu, bëhet i mundur regjistrimi i aktiviteteve të pakicave kombëtare, si aktivitete kulturore, që transmetohen në RTSH 2.

71. Lidhur me transmetimet radiofonike për pakicat kombëtare, “Radio Tirana” ka realizuar gjatë periudhës 2016–2020, një cikël të përjavshëm mbi mënyrën e jetesës, punësimin, integrimin dhe shembuj për t’u ndjekur. Objektivi i ciklit ishte ofrimi i informacionit në gjuhët e pakicave kombëtare, ku personat e pakicave kombëtare dhe të rinjtë u angazhuan si bashkëpunëtorë të programit.

72. Sipas informacionit të paraqitur nga AMA deri tani shërbimet audio të komunitetit ose radiot e komunitetit janë vetëm nga bashkësitë fetare, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 97/2013. Pranë AMA-s nuk ka pasur asnjë kërkesë, asnjë interesim deri më tani për aplikim të licencës për radio komuniteti nga ana e pakicave kombëtare.

II. INFORMACION MBI ÇËSHTJET DHE REKOMANDIMET E PARAQITURA NGA KOMITETI I EKSPERTËVE (Komiteti CERD)

Gjetjet dhe rekomandimet 7, 8. Statistikat; Censusi dhe parimi i vetidentifikimit

73. Në kuadër të punës përgatitore për Censin e Popullsisë dhe Banesave, që parashikohet të mbahet në vitin 2022, INSTAT-i ka përgatitur projektligjin e ri të CENS-i. Gjatë hartimit të Pyetësorit të Cens, INSTAT-i ka kryer disa tryeza konsultative me grupet e interesit, përfshirë edhe përfaqësuesit e pakicave kombëtare. Gjatë tryezave është diskutuar përmbajtja e pyetësorit, si dhe janë mbledhur të gjitha komentet/sugjerimet e pakicave kombëtare, lidhur me hartimin e pyetjes, përmirësimin e procesit të mbledhjes së të dhënave, diskutimi i problemeve të hasura në censin e kaluar, me qëllim përmirësimin në censin e ardhshëm. INSTAT-i, gjatë muajit

nëntor 2020, ka organizuar *workshop*-in për pyetësorin e CENS-it, me qëllim rishikimin e pyetësorit me ekspertë ndërkombëtarë për të siguruar përputhshmërinë e përmbajtjes së tij me rekomandimet ndërkombëtare.

74. Në datën 26 nëntor 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 140/2020, “Për censin e popullsisë dhe banesave”. Censi do të organizohet dhe kryhet nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Censit dhe me mbështetjen e Komisioneve të Censit që do të ngrihen në çdo Bashki të vendit. Në këtë ligj është përfshirë specifikisht parimi i vetidentifikimit të lirë të përkatësisë etnike, në përputhje me nenin 3 të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, rekomandimet e organeve monitoruese të Këshillit të Evropës, rekomandimet në kuadrin e dialogut me Bashkimin Evropian, standardet ndërkombëtare.

75. Ligji nr. 140/2020, “Për censin e popullsisë dhe banesave” rregullon organizimin dhe realizimin e censit të popullsisë dhe të banesave në territorin e RSH-së. Censi i Popullsisë dhe Banesave është planifikuar të kryhet në vitin 2022 (periudha 1 tetor – 15 nëntor). Censi do të ofrojë informacion për të gjitha temat thelbësore, si: banorët e zakonshëm rezident të Shqipërisë dhe karakteristikat e tyre gjeografike, demografike, ekonomike, arsimore, migratore, njësitë ekonomike familjare dhe karakteristikat e banesave, si dhe temat jothelbësore, si: aftësia e kufizuar, etnia, gjuha, feja ose bujqësia. Tematikat mbi të cilat është ndërtuar pyetësori i Censit për marrjen e të dhënave, i referohen rregullores së zbatimit të KE-së nr. 2017/543 dhe rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara. Censi do të krijojë informacionin bazë statistikor mbi popullsinë, ndërtesat dhe banesat për të gjithë territorin e Shqipërisë, i cili është thelbësor për ndërtimin e institucioneve, zhvillimin e qëndrueshëm, demokracinë dhe mirëqeverisjen në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.

76. Ligji siguron krijimin e bazës ligjore të konsoliduar për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe banesave, duke marrë në konsideratë



standardet e reja ndërkombëtare të vendosura për censet e ardhshme të popullsisë dhe banesave, terminologjitë, procedurat dhe institucionet e përfshira. Gjithashtu, ai do të mundësojë përputhshmërinë me terminologjitë dhe përkufizimet e legjislacionit të BE-së, si dhe do të mundësojë përmbushjen e rekomandimeve të Konferencës së Stacioneve Evropiane (CES 2020) për censet e popullsisë dhe banesave.

77. Parashikimet ligjore mbi vetidentifikimin në ligjin nr. 140/2020, “Për censin e popullsisë dhe banesave”: neni 4/2 “Pyetësi i censit”, parashikon se: “Pyetësi i censit përmban edhe pyetje për identitetin etnik, gjuhën dhe fenë, përgjigjet e të cilave bazohen në të drejtën e vetidentifikimit të individit. Këto pyetje përmbajnë për të anketuarin alternativën për t’iu përgjigjur “Unë preferoj të mos përgjigjem”. Neni 21/2 “Kundërvajtjet”, parashikon se: “Çdo deklaram ose zgjedhja e alternativës ‘Unë preferoj të mos përgjigjem’”, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij ligji, nuk përbën kundërvajtje administrative. Ky ligj në nenin 25, parashikon shprehimisht se: “ligji nr. 8669, datë 26.10.2000, ‘Për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave’, i ndryshuar”¹³, shfuqizohet”.

78. Censi i Popullsisë dhe Banesave 2022 do të ndjekë metodën universale të numërimit të drejtpërdrejtë, bazuar në operacionet në terren me përpilimin e pyetësorëve nga anketuesit, duke përdorur metoda të reja për mbledhjen e të dhënave. Censi i Popullsisë dhe Banesave 2022 do të marrë në konsideratë kërkesat e përdoruesve vendës, rekomandimet ndërkombëtare, në veçanti, rekomandimet dhe standardet e adresuara në vendet evropiane, të Kombeve të Bashkuara dhe nga Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian (EUROSTAT), si dhe duke përfshirë cilësinë e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

79. Tematikat mbi të cilat është ndërtuar pyetësi i Censit për marrjen e të dhënave, i referohen standardeve të BE-së dhe rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara. Censi si operacion statistikor, që do të

realizohet nga INSTAT-i, synon të ofrojë të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për analiza private e publike të vendimmarrjes, për kërkime shkencore dhe, në përgjithësi, për përmirësimin e njohjes e të kuptuarit nga shtetasit të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

80. Një element shumë i rëndësishëm për realizimin e aktiviteteve, është zhvillimi i një procesi të gjerë informimi dhe komunikimi në nivel qendror dhe vendor, si dhe informimi dhe komunikimi me publikun e gjerë përfshirë edhe shoqatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare dhe personat që u përkasin pakicave kombëtare, mbi dispozitat ligjore, metodologjinë e censit dhe zhvillimin e tij. Ky proces përfshin:

- informacionin për temat thelbësore, si dhe temat jothelbësore (ku përfshihet edhe identiteti etnik (përkatësia etnike, përkatësia fetare);

- organizimi i tryezave informuese dhe fushatave efektive për komunikim dhe ndërgjegjësim, të të gjithë qytetarëve, grupeve të interesit dhe grupet e synuara, edhe me përfshirjen e shoqatave pakicave kombëtare dhe personat që u përkasin pakicave kombëtare;

- trajnimi i stafit që do të zhvillojë procesin në terren lidhur edhe me pyetjet mbi temat thelbësore dhe jothelbësore (si identiteti etnik, gjuha dhe feja), përgjigjet e të cilave bazohen në të drejtën e vetidentifikimit të individit;

- mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura gjatë censit, përfshirë edhe të dhënat mbi identitetin etnik, komunikimi dhe transparenca në lidhje me rezultatet e Censit dhe aksesin në informacionin e Censit.

Gjetjet dhe rekomandimi 9. Zbatimi i Konventës në legjislacionin e brendshëm

81. Konventa CERD është e zbatueshme drejtpërdrejt në legjislacionin shqiptar. Në bazë të nenit 122 të Kushtetutës, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të RSH-së. Neni 116 i Kushtetutës, i cili përcakton hierarkinë e akteve normative me fuqi në territorin e RSH-së, i vendos marrëveshjet ndërkombëtare të

¹³ I ndryshuar me ligjin nr. 10 442, datë 7.7.2011.



ratifikuara pas Kushtetutës dhe mbi ligjet e vendit. Në këtë mënyrë, në rast konflikti ndërmjet një ligji dhe një marrëveshjeje ndërkombëtare, kjo e fundit ka gjithmonë epërsi.

Trajnimet e personelit ligjzbatues

82. Legjislacioni në zbatim të reformës në drejtësi i ka dhënë karakter detyrues formimit vazhdues të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH-së”, parashikohet që magjistrati ka të drejtën dhe detyrimin për të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues, të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin e Prokurorisë, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. Formimi vazhdues organizohet nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli i Prokurorisë.

83. Institucionet qendrore dhe të pavarura, si: Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Shkolla e Magjistraturës etj., kanë zhvilluar trajnime mbi njohjen dhe zbatimin e Konventës CERD dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare apo kuadrit ligjor mbi të drejtat e njeriut, sipas fushave¹⁴.

Gjetjet dhe rekomandimet 11, 12. Zbatimi i legjislacionit të brendshëm. Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare

84. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH-së” dhe kuadri nënligjor në zbatim të tij parashikojnë dispozita për zbatimin e të drejtave specifike të pakicave kombëtare: vetidentifikimi, mosdiskriminimi, të drejtat arsimore, kulturore, ruajtja dhe zhvillimi i identitetit të tyre, përfaqësimi në jetën ekonomike, sociale, publike etj., krijimin e kushteve dhe mundësive për ushtrimin e të drejtave specifike lidhur me përdorimin e gjuhës së pakicave në marrëdhëniet me autoritetet, përdorimin e emrave, mbiemrave, treguesit topografikë në gjuhën e pakicave kombëtare, mekanizmin institucional për

përfaqësimin e pakicave dhe forcimin e rolit dhe kompetencave të Komitetit Shtetëror të Pakicave Kombëtare; krijimin e Fondit për Pakicat Kombëtare për mbështetjen e nismave dhe projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar të pakicave kombëtare.

85. Miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji veçanërisht për sa i takon mbledhjes së të dhënave, arsimit, përdorimit të gjuhës në marrëdhëniet me autoritetet administrative, bazohet në kriteret objektive dhe kriterin subjektiv (parimi i vetidentifikimit), siç parashikohet edhe nga ligji nr. 96/2017 “Mbi pakicat kombëtare” dhe kriteret e parashikuara nga Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është e lidhur me kriterin objektiv përkatës të identitetit të personit (neni 3 i Konventës Kuadër).

86. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, gjatë periudhës 2018 – dhjetor 2020 janë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore të paketës së akteve nënligjore (8 akte nënligjore nga 12 të parashikuara), katër vendime në fushën e arsimit, dy vendime mbi pjesëmarrjen në jetën publike, sociale, kulturore, dy vendime mbi krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare, konkretisht:

- VKM nr. 561, datë 29.9.2018, “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”.

- VKM nr. 562, datë 29.9.2018, “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”.

- VKM nr. 726, datë 12.12.2018 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare”.

- VKM nr. 227, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve

¹⁴ Informacion i detajuar jepet në anekset pjesë përbërëse të Raportit.



arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”.

- VKM nr. 286, datë 10.5.2019, “Për miratimin e procedurave të zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Pakicave Kombëtare”.

- VKM nr. 462, datë 3.7.2019, “Për miratimin e masave dhe të politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Republikën e Shqipërisë”.

- VKM nr. 463, datë 3.7.2019 “Mbi përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre”.

- VKM nr. 1155 datë 24.12.2020, “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”.

87. Aktualisht janë në proces hartimi dhe konsultimi përfundimtar 4 projektvendime (Komiteti *ad hoc* për njohjen e pakicave, përdorimi i gjuhës në marrëdhëniet me autoritetet vendore, mbledhja e të dhënave dhe miratimi i Fondit të Pakicave Kombëtare), konkretisht:

1) Projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare (pakicave të reja, krahas pakicave të njohura me ligjin nr. 96/2017)”.

2) Projektvendimi “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”.

3) Projektvendimi “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen/verifikimin e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare”. Ky projektvendim ka si qëllim garantimin e parimit të vetidentifikimit të

personave që u përkasin pakicave dhe verifikimi i të dhënave mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare, lidhet me kriteret objektive të identitetit të pakicave kombëtare dhe shërben për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga ligji.

4) Projektvendimi “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e Fondit për pakicat kombëtare”.

Gjetjet dhe rekomandimet 13, 14. Kuadri institucional

14.a Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

88. Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), si një institucion publik dhe i pavarur “siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar¹⁵, është një garanci lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut pa diskriminim, në fushat si arsim, punësim, të mira dhe shërbime. Krahas zyrës qendrore, Komisioneri e ushtron veprimtarinë e tij edhe nëpërmjet zyrave rajonale në Korçë, Shkodër, Fier.

89. Funksionimi dhe detyrat kryesore të këtij institucioni rregullohen nga ky ligj. Kompetencat ligjore: 1. Shqyrtimi i ankesave të subjekteve dhe të kryerja e hetimeve administrative me iniciativë, pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; 2. Nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje; monitorimi dhe kryerja e sondazheve në lidhje me diskriminimin, publikimi i raporteve dhe të bërrja e rekomandimeve për çfarëdo lloji çështje që lidhet me diskriminimin; 3. Bërrja e rekomandimeve duke propozuar miratimin e

¹⁵ Me ligjin nr. 124/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’”, miratuar më 15.10.2020 dhe hyrë në fuqi më 18.11.2020.



legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues; 4. Ngritja e padisë, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive dhe vendosja në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

90. Rekomandimet e paraqitura nga KMD-ja kanë pasur si qëllim zbatimin e parimeve të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi:

- për projektligjin, “Për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore;

- për projektligjin, “Për programet sociale të strehimit”;

- mbi projektligjin, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”;

- rekomandim mbi strehimin e familjeve rome dhe egjiptiane, në zonën e Selitës, Tiranë;

- rekomandime mbi aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”;

- rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë. Marrjen e masave për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, të grupeve të disavantazhuara, siç janë: fëmijët, me aftësi të kufizuara, romë, egjiptianë, fëmijët me aftësi të kufizuara nga familjet e varfra;

- rekomandim për miratimin e një fondi shtesë të skemës së ndihmës ekonomike;

- rekomandim në lidhje me mbështetjen financiare, “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

- Në janar 2021 në kuadër të zgjedhjeve parlamentare, është adresuar rekomandimi i përbashkët i KMD-së dhe KQZ-së, “Për parandalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore”.

91. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) nga viti 2018 – aktualisht ka trajtuar rastet e mëposhtme, lidhur me pakicat kombëtare¹⁶:

- gjatë vitit 2018, janë trajtuar 63 çështje (59 ankesa dhe 4 çështje *ex-officio*);

- gjatë vitit 2018, Komisioneri është shprehur me 64 vendime: 41 vendime themeli, 20 vendime mospranimi; dhe 1 vendim pezullim shqyrtimi, 2 vendime ndërprerje të procedurave.

- gjatë vitit 2019, janë trajtuar 35 çështje (33 ankesa dhe 2 çështje *ex-officio*);

- gjatë vitit 2019, KMD-ja është shprehur me 33 vendime: 26 vendime themeli, 4 vendime mospranimi dhe 3 vendime ndërprerje të procedurave;

- gjatë vitit 2020, janë trajtuar 16 çështje (15 ankesa dhe 1 çështje *ex-officio*), me subjekte: 4 meshkuj; 4 femra, 4 grup personash dhe 3 organizata të shoqërisë civile (OJF);

- gjatë periudhës janar–nëntor 2020, Komisioneri KMD është shprehur me 14 vendime: 12 vendime themeli dhe 2 vendime mospranimi;

- gjatë vitit 2020, KMD-ja ka trajtuar 22 çështje (21 ankesa dhe 1 çështje *ex-officio*), me subjekte: 6 meshkuj; 5 femra; 5 grup personash dhe 5 Organizata të Shoqërisë Civile (OJF);

- gjatë vitit 2020, Komisioneri është shprehur me 16 vendime: 14 vendime themeli dhe 2 vendime mospranimi;

- gjatë periudhës janar–prill 2021, KMD-ja ka trajtuar 19 çështje (16 ankesa dhe 3 çështje *ex-officio*), me subjekte: 8 meshkuj; 1 femra; 3 grup personash dhe 4 organizata të shoqërisë civile (OJF);

- gjatë periudhës janar–prill 2021, Komisioneri është shprehur me 11 vendime: 8 vendime themeli dhe 3 vendime mospranimi.

92. KMD-ja ka organizuar, Ditë të Hapura me përfaqësues/përfaqësues të pakicave rome dhe egjiptiane, për sensibilizimin mbi ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, njohjen me problemet e komunitetit dhe marrjen e ankesave. Kjo nismë vijoi gjatë vitit 2020 me organizatat që veprojnë në terren. Gjatë vitit 2020 janë organizuar disa fushata ndërgjegjëse me spote të shkurtra, si dhe sensibilizim në platformat *online*. Janë hartuar broshura informuese dhe janë zhvilluar takime virtuale të vazhdueshme me aktiviste/aktivistë të shoqërisë civile për iniciativë të përbashkëta në organizimin e paradave dhe ekspozitave

¹⁶ Informacion i detajuar mbi veprimtarinë e KMD-së, rastet e trajtuara jepen në vijim në shtojcat, pjesë përbërëse të Raportit.



ndërgjegjësuere. Në dhjetor 2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka publikuar “Raportin e Monitorimit me Fokus të Veçantë Fëmijët në Arsim”¹⁷. Në funksion të realizimit të këtij procesi monitorues, u përgatit një pyetësor mbi përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsim për vitin shkollor 2018–2019 dhe 2019–2020. Monitorimi i KMD-së, tregoi se fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët romë dhe egjiptianë vazhdojnë të përballen me sfida në sistemim arsimor shqiptar e, për rrjedhojë, të mos kenë një arsim të mirëfilltë gjithëpërfshirës. Komisioneri nëpërmjet monitorimit adresoi disa rekomandime institucioneve përgjegjëse me qëllim përmirësimin e situatës.

14/b. Avokati i Popullit

93. Neni 2, i ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, përcakton se “... Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat legjitime të individit nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta ose mosveprimet e organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj”.

94. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, u krijua institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (organ barazie), ligji i të cilit përcakton si objekt kryesor të veprimtarisë së tij, dispozita të mbrojtjes efektive kundër diskriminimit për secilin individ, si dhe mbrojtjen e tyre nga çdo formë sjelljeje që promovon diskriminimin (neni 21/1).

95. Nga një interpretim i ngushtë i dispozitave ligjore mund të thuhet se pavarësisht kompetencës më të gjerë të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, duke specifikuar kompetencën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të siguruar mbrojtje efektive kundër diskriminimit për çdo individ, kjo çon në faktin se kjo kompetencë i përket së pari Komisionerit si organ barazie dhe jo Avokatit të Popullit. Në një interpretim të gjerë të

dispozitave ligjore mund të thuhet se ndërkohë që ligji organik i Avokatit të Popullit përfshin si kompetencë të përgjithshme të drejtën për mbrojtje nga diskriminimi dhe barazinë para ligjit, për rrjedhojë, nuk ka asnjë pengesë ligjore për këtë të fundit që të trajtojë këto çështje.

96. Avokati i Popullit adreson çështjet ku ngrihen pretendime për shkelje të të drejtave të tjera të njeriut. Ekziston në mënyrë efektive një ndarje e punës midis dy institucioneve, të Avokatit të Popullit dhe atij të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kjo ndarje nuk është një çështje e përcaktuar mirë brenda ligjit, por është një çështje e praktikës së mirë, e krijuar ndërmjet këtyre dy institucioneve dhe e formalizuar nëpërmjet një memorandum bashkëpunimi të nënshkruar ndërmjet palëve, më datë 28.5.2018. Objekti i këtij memorandum është institucionalizimi i marrëdhënieve midis palëve me qëllim zgjidhjen e konfliktit të konkurrit të kompetencave, që mund të ekzistojnë ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për shkak të përmbajtjes së ligjeve të cilat rregullojnë veprimtarinë e tyre në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

97. Juridiksioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi përfshin jo vetëm sferën publike, por edhe atë private, dhe natyra e akteve të lëshuara prej tij nuk është vetëm rekomanduese. Bazuar në nenin 24/c, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, parashikohet edhe “e drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative”, shprehimisht: Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre, shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë: a) t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve; b) t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive; c) të

¹⁷ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/12/RAPORTI-MONITORIMIT-ME-FOKUS-TE-VECANTE-FEMIJET-NE-ARSIM.pdf>
Faqe | 10048



vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla.

98. Ky model e ka përforcuar mbrojtjen e të drejtave të shtetasve edhe për faktin e thjeshtë të rritjes së kapaciteteve, gjë e cila mund të mos kishte ndodhur, nëse mbrojtja tërësore do të kryhej nga një institucion i vetëm. Në çdo rast, modeli aktual duket që po funksionon dhe të dyja institucionet kanë ndërmarrë nisma për të përdorur burimet e përbashkëta njerëzore në zyrat e tyre rajonale.

99. Sipas institucionit të Avokatit të Popullit, niveli i zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e administratës publike përbën një shqetësim i vazhdueshëm për institucionin e Avokatit të Popullit. Përtej hapave dhe nismave pozitive të konstatuara ndër vite, mbetet shumë për t'u bërë në këtë drejtim, jo vetëm nga organet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor (sidomos sa i përket zbatimit të rekomandimeve), por dhe nga Kuvendi i Shqipërisë si organi legjislativ ku paraqiten dhe diskutohen raportet e hartuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

100. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar vendimin nr. 49/2017, “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, në të cilën janë përfshirë edhe sugjerimet e Avokatit të Popullit. Institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar dhe monitoron nivelin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara organeve të administratës publike nëpërmjet përgatitjes së informacioneve të përditësuara, të cilat bëhen pjesë e raportimeve periodike apo vjetore.

101. Institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur një rol aktiv gjatë gjithë procesit të hartimit të projektligjit mbi pakicat kombëtare. Gjatë procesit të konsultimit të projektligjit, “Për censin e popullsisë dhe të banesave”, Avokati i Popullit ka dhënë rekomandimet lidhur me: “zhvillimin e një censi të ri të popullsisë, mbi bazën e kriterëve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, ku pakicat, do të gjenin veten për t'u shprehur objektivisht dhe pa rezerva për ekzistencën e tyre”.

102. Avokati i Popullit ka trajtuar problematikat e pakicës kombëtare romë dhe pakicës kombëtare egjiptiane, të cilët hasin ende shumë pengesa për përfshirjen dhe integrimin në sistemin social: strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike, arsimimin, punësimin, formimin profesional, kujdesin shëndetësor. Nga ana e këtij institucioni, institucioneve përgjegjëse u janë dërguar një sërë rekomandimesh në kuadër të përmirësimit të kushteve të jetesës për integrimin e romëve dhe egjiptianëve¹⁸.

103. Sipas Avokatit të Popullit, çështje e ndjeshme lidhur me problematikat që shqetësojnë komunitetet e pakicave romë dhe egjiptiane në vend, është dëbimi me forcë, nga vendqëndrimet e tyre komunitare të pozicionuara në periferitë e qyteteve kryesore, ku edhe kanë ndërtuar kryesisht baraka. Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, janë adresuar disa lehtësira në fushën e strehimit, për individët dhe familjet romë dhe egjiptiane, si dhe ka një parashikim të përgjithshëm për dëbimet me forcë, por sipas këtij institucioni nuk janë të mjaftueshme. Lidhur me këtë konstatim të Avokatit të Popullit, sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” është miratuar VKM-së nr. 361, datë 29.5.2019, “Mbi përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi apo strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj dhe të bashkëpunimit institucional”.

104. Avokati i Popullit bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, rekomandoi zgjerimin e kategorisë së subjekteve përfituese të ligjit të ri për ndihmën juridike me viktimat e diskriminimit. Alokimi i mjaftueshëm i fondeve shtetërore, rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit, rritja e aksesueshmërisë pranë klinikave ligjore, janë disa nga masat kryesore që nevojiten për garantimin e ndihmës juridike falas për grupet në nevojë.

¹⁸ Informacion i detajuar jepet në shtojcën, pjesë përbërëse e Raportit.

**14/c. Komiteti për Pakicat Kombëtare**

105. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve¹⁹, si institucioni përfaqësues i pakicave kombëtare ka qënë shumë i përfshirë dhe ka dhënë kontribut gjatë hartimit të projektligjit mbi pakicat kombëtare dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ligji nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare (nenet 18-22) përmban disa dispozita mbi krijimin e Komitetit për Pakicat Kombëtare, i cili krijohet, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, krijohet Komiteti për Pakicat Kombëtare, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit. Në këtë nen parashikohet: organizimi, funksionimi dhe niveli i pagave i anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare dhe personelit administrative. Struktura e Komitetit për Pakicat Kombëtare që miratohet me urdhër të Kryeministrit.

106. Në nenin 19, të këtij ligji, parashikohen kompetencat e Komitetit për Pakicat Kombëtare Komiteti për Pakicat Kombëtare ka këto kompetenca:

a) rekomandon dhe jep opinionin e tij në lidhje me hartimin e legjislacionit, politikave dhe programeve që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave kombëtare;

b) propozon rekomandime për Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe organet e pushtetit vendor për trajtimin e çështjeve që lidhen me pakicat kombëtare;

c) përgatit dhe dorëzon raporte periodike për Kuvendin për gjendjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë;

ç) bashkëpunon dhe koordinon me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor raportimin dhe monitorimin për zbatimin e kuadrit ligjor dhe politikave shtetërore në lidhje me pakicat kombëtare;

d) organizon aktivitete, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e promovimin e

të drejtave të pakicave kombëtare dhe forcimin e dialogut me shoqatat e pakicave kombëtare;

e) kontribuon në përgatitjen e raportit kombëtar për zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

f) ndërmerr aktivitete, të cilat kanë si synim përmbushjen e angazhimeve dhe detyrimeve ndërkombëtare;

g) jep opinione në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare;

h) jep opinion, lidhur me kërkesat për njohjen e pakicave;

i) financon, nëpërmjet fondit për pakicat kombëtare, nismat dhe projektet që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe ruajtjen e promovimin e identitetit kombëtar, gjuhësor e kulturor të pakicave kombëtare.

107. Në nenin 20 të këtij ligji parashikohet se Komiteti për Pakicat Kombëtare²⁰ përbëhet nga përfaqësuesit e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij ligji, pra përfaqësues të 9 pakicave kombëtare të njohura me ligjin nr. 96/2017²¹.

Në zbatim të këtyre dispozitave janë miratuar dy akte nënligjore:

- VKM nr. 726, datë 12.12.2018, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare”.

- VKM nr. 286, datë 10.5.2019, “Për miratimin e procedurave të zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Pakicave Kombëtare”.

108. Në nenin 21, të këtij ligji, parashikohet krijimi i Fondit për Pakicat Kombëtare me qëllim mbështetjen e nismave dhe projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar të pakicave kombëtare. 2. Fondi financohet nga Buxheti i Shtetit dhe administrohet nga Komiteti për Pakicat Kombëtare. 3. Kriteret për

²⁰ Informacion i detajuar mbi Komitetin e Pakicave Kombëtare jepet në shtojcat, pjesë përbërëse e Raportit.

²¹ Pakicat kombëtare të parashikuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij ligji janë: greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

¹⁹ Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2017 emërtesa e Komiteti Shtetëror të Minoriteteve është Komiteti për Pakicat Kombëtare.



mbështetjen e nismave dhe projekteve, kriteret e përzgjedhjes për financimin e tyre dhe administrimi i fondit për pakicat kombëtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

109. Projektvendimi mbi Fondin për Pakicat Kombëtare, i cili është në proces hartimi dhe konsultimi do të synojë promovimin dhe mbrojtjen e të së drejtave të pakicave kombëtare. Fondi do të përdoret për mbështetjen e nismave dhe të projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional e fetar.

Gjetjet dhe rekomandimet 15, 16. Gjuha e urrejtjes

110. Ndryshimet e reja në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikojnë si formë të re të diskriminimit edhe gjuhën e urrejtjes. Ndryshimet ligjore mundësojnë detyrimin e medias kombëtare për të publikuar vendimet e Komisionerit KMD që kanë gjetur diskriminim përmes gjuhës së urrejtjes.

111. Për periudhën raportuese, janë zbatuar rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë ndërmarrë hapa konkrete për mbrojtjen e pakicave kombëtare, masa në luftën kundër gjuhës së urrejtjes, duke zbatuar rekomandimet e këtyre institucioneve, mbi parandalimin e fyerjes nga ana e punonjësve të Policisë apo gjuhën e urrejtjes për grupe të caktuara, ku përfshihen edhe persona që i përkasin pakicës rome dhe pakicës egjiptiane.

112. Avokati i Popullit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë angazhimit institucional për luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe masave që shteti dhe gjithë shoqëria shqiptare duhet të ndërmarrë ndaj këtij fenomeni. Aleanca kundër Gjuhës së Urrejtjes u krijua më 20 dhjetor 2019, në Tiranë, si një nismë e Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Këshillit Shqiptar të Medias për të luftuar fenomenin e “gjuhës së urrejtjes” në të gjitha dimensionet që ai shfaqet në shoqërinë Shqiptare. Krijimi i Aleancës kundër Gjuhës së Urrejtjes, është një shembull i mirë

që nuk duhet të jetë i vetëm dhe i mjaftueshëm në këtë përpjekje që kërkon angazhim gjithëpërfshirës.

113. Aleanca pa Urrejtje dhe institucionet themeluese të saj: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti Audiovizual i Medias dhe Këshilli Shqiptar i Medias do të punojnë së bashku për promovimin dhe advokimin në luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në Shqipëri. Aleanca pa Urrejtje konsiston në një qasje të përbashkët në promovimin e diversitetit dhe më konkretisht, do të:

- zhvillojë komunikimin dhe materiale informuese për të ndërgjegjësuar dhe promovuar diversitetin dhe lirinë e shprehjes, si: broshura, raporte, fushata etj., për të arritur audiencat e saj dhe publikun e gjerë;

- nxisë bashkëpunimin me organizata dhe agjenci partnere të cilat luajnë kanë një rol në luftën kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, si: Ministria e Edukimit, Rinisë dhe Sporteve, furnizuesit e shërbimit të internetit (ISP), organizatat e gazetarëve, organizatat e shoqërisë civile, organizatat për mbrojtjen e konsumatorit etj.;

- mbështesë partnerët në identifikimin e mekanizmeve efektive për të luftuar gjuhën e urrejtjes bazuar në praktikën dhe standardet evropiane.

- identifikojë mekanizmat për përmirësimin e ndarjes së informacionit dhe trajnimin e stafit.

114. Aleanca pa Urrejtje do të zhvillojë një agjendë të përbashkët dhe do të ndajë një plan të veprimeve ku do të përcaktohen ndërhyrjet për t’u përmbushur në vazhdim. Aleanca mbështetet nga dy projektet e programit të përbashkët të BE-së dhe të Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022”, respektivisht projekti “Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri” dhe projekti “Liria e Shprehjes dhe e Medias (JUFREX)”.

Gjetjet dhe rekomandimet 19, 20. Romët dhe egjiptianët

115. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020, i miratuar me VKM-në nr. 1072, datë 23.12.2015, është i mbështetur, në parimin



themelor të mosdiskriminimit. Ky Plan ka pasur në fokus dy pakicat përkatëse dhe parashikon aktivitete për nxitjen e integritimit të romëve dhe egjiptianëve me fondet e parashikuara nga buxheti i shtetit, por duke identifikuar edhe hendekun financiar për periudhën 2016–2020, si dhe mundësinë e financimit nëpërmjet koordinimit me ndihmën e huaj.

116. Ky Plan Veprimi ka përfshirë një buxhet të caktuar për zbatimin e çdo veprimtarie. Në varësi të llojit të veprimtarisë, Plani i Veprimit specifikon: a) financimin nga qeveria, b) financimin nga donatorët, c) kombinimin e financimit nga qeveria dhe financimit nga donatorët. Sipas kostimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Integritimin e Romëve dhe Egjiptianëve, pjesë të këtij dokumenti, rezulton se rreth 60% e fondeve të nevojshme për zbatimin e masave do të mbulohen nga buxheti i shtetit, duke përmblusur në këtë mënyrë edhe rekomandimet e Bashkimit Evropian.

117. Nga rekomandimet e Seminarit të Katërt të Dialogut mbi Politikën për Përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve, sektorët prioritarë rezultojnë: i) regjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi; ii) arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor; iii) punësimi, aftësimi dhe formimi profesional; iv) kujdesi shëndetësor; v) strehimi; vi) përkujdesja sociale; dhe vii) antigjipsizmi. Procesi është formalizuar me ngritjen e grupit të punës me urdhër nr. 521, datë 23.9.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për hartimin e planit kombëtar të veprimit për integritimin e romëve dhe egjiptianëve, 2021–2025.

118. Viti 2020 shënoi finalizimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Integritimit të Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020. Janë përgatitur 4 raporte monitorime për vitet 2016, 2017, 2018, 2019, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), nën seksionin *Roma Integration*. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është duke koordinuar procesin e hartimit të Planit të ri të Veprimit për Integritimin e Romëve.

119. Gjatë muajit dhjetor 2020 u organizuan shtatë takime konsultative mbi buxhetimin e

përgjegjshëm rom në kuadër të programit të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës ROMACTED me bashkitë partnere dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. Këto aktivitete patën si qëllim lehtësimin e procesit të buxhetimit, përfshirjen e nevojave dhe projekteve prioritare të parashikuara në planet vendore për integritimin e pakicave romë dhe egjiptiane në buxhetin e vitit 2021.

120. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale po ndjek procesin e hartimit të Planit të ri për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve 2021–2025. Procesi është formalizuar me krijimin e grupit të punës me urdhrin nr. 521, datë 23.9.2020 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në dhjetor të 2020-s janë organizuar takime *online* për të gjitha fushat, si: arsimi, mbrojtja sociale, regjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi, kujdesi shëndetësor, strehimi social dhe antiracizmi ndaj romëve dhe egjiptianëve.

121. Dokumentet kryesore të përdorura gjatë hartimit të planit, janë: 1) Deklarata e Poznanit, e nënshkruar vitin e kaluar nga kryeministrat e Ballkanit Perëndimor; 2) Kuadri strategjik i BE-së 2020–2030 për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen; 3) Rekomandimet e Seminarit të Katërt Shqipëri–BE. Si fushë strategjike për herë të parë është përfshirë fusha e “antiracizmit ndaj romëve dhe egjiptianëve”, me qëllim adresimin e tij në politikën publike, si dhe përmes ndryshimeve strukturore, për të garantuar një shoqëri jodiskriminuese.

122. Në nivel vendor janë miratuar në disa bashki të vendit planet vendore të zhvillimit të pakicës romë dhe egjiptiane, të cilat adresojnë fusha prioritare për përfshirjen dhe integritimin e këtyre pakicave, si në: punësimin, strehimin, shëndetësinë, ofrimin e shërbimeve, mbrojtjen sociale dhe regjistrimin civil. Konkretisht në Bashkinë e Tiranës me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 4, datë 31.1.2018 është miratuar Plani Lokal i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2017–2020. Bazuar në Planin Lokal dhe Planin Kombëtar për Zhvillimin dhe Integritimin e Pakicës Rome dhe Egjiptiane,



strukturat e shërbimeve sociale, pranë bashkive, kanë mbështetur dhe ofruar shërbime për individët dhe familjet rome dhe egjiptiane.

123. Gjithashtu, me mbështetjen e Këshillit të Evropës janë hartuar dhe miratuar 7 plane vendore, të cilat kanë në fokus integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane. Këto dokumente vendore përfaqësojnë modele të mira ku çështjet rome adresohen në mënyrë ekskluzive, por edhe të përfshira nën një kuadër më të përgjithshëm vendor të kohezionit social midis grupeve të tjera sociale, si Plani i Veprimit për Përfshirjen Sociale. Planet e miratuara nga këshillat bashkiakë, janë:

- Bashkia Roskovec: Plani Social 2019–2022;

- Bashkia Fier: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicës Rome dhe Egjiptiane 2019–2022;

- Bashkia Përmet: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicës Egjiptiane 2019–2022;

- Bashkia Pogradec: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022;

- Bashkia Vlorë: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022;

- Bashkia Elbasan: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022;

- Bashkia Korçë: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022.

Arsimimi

124. Në vitin 2018 u miratua urdhri nr. 754, datë 9.11.2018, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e programit të gjuhës rome, shkalla III–IV, klasat VI–IX”. Ky program vlen për zhvillimin e mësimi të gjuhës rome në arsimin e mesëm të ulët si lëndë me zgjedhje. Programi i gjuhës rome, shkalla III–IV, klasat VI–IX, u hartua dhe u miratua në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020. Mësimi i gjuhës rome dhe zhvillimi i mësimi të gjuhës rome do të bëhen në përputhje me aktet nënligjore për mësimin në gjuhën e pakicave kombëtare. Prej disa vitesh, gjuha rome mësohet në shkollën 9-

vjeçare “Hamit Mullisi” Elbasan, në kuadrin e shkollës qendër komunitare. Atë e ndjekin jo më pak se 30 nxënës çdo vit. Aktualisht mungojnë mësues të diplomuar për gjuhën rome. Udhëzimet e Ministrisë (MASR) për regjistrimin me përparësi në kopshte të fëmijëve romë dhe për ofrimin e arsimit bazë dhe të gjimnazit me kohë të pjesshme, janë mbështetje e ndjeshme për këta fëmijë.

125. Në zbatim të pikës 1/c/xi të VKM-së nr. 269, datë 29.3.2017, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët, të cilët janë pranuar në programe të studimeve profesionale, programe të ciklit të parë të studimeve ose programe të integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, ndër të tjerë, studentët, të cilët u përkasin shtresave sociale në nevojë, si studentët romë dhe ata egjiptianë.

126. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, parashikohet që studentët romë dhe egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve, sipas kategorive të mëposhtme, paguajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve të miratuar nga institucionet publike të arsimit të lartë.

127. Janë nënshkruar marrëveshjet ndërministrare për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollos, si dhe për fëmijët në situatë rruge etj. Në shkollat e arsimit bazë po zbatohet nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë”. Në çdo institucion arsimor të përfshirë në këtë nismë realizohen 3 orë studimi në ditë për çdo klasë të krijuar. Mësuesit e ngarkuar kryejnë dhe rolin e mediatorit në shkollat ku ka nxënës



romë dhe egjiptianë, për rritjen e nivelit të të nxënës prej tyre. Nxënësit e pakicës romë dhe nxënësit e pakicës egjiptiane janë integruar dhe në të gjitha veprimtaritë që organizojnë “Shkollat qendër komunitare”, ku ndjekim mësimet.

128. Aksesit në arsimim: pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve në arsimin parauniversitar në vitin shkollor 2018–2019 është përmirësuar me 6%.

- Në vitin shkollor 2018–2019 u regjistruan 15923 nxënës romë dhe egjiptianë, 915 më shumë, në krahasim me 15008 që u regjistruan në vitin shkollor 2017–2018.

- Në vitin shkollor 2019–2020, 14525 nxënës romë dhe egjiptianë.

Gjetjet dhe rekomandimet 23, 24, pavarësia e gjyqësorit. Këshilli i Lartë Gjyqësor

129. Ndryshimet kushtetuese të gushtit 2016 i hapën rrugë reformës të sistemit të drejtësisë. Korniza e re kushtetuese dhe ligjore për reformimin e sistemit të drejtësisë, ndër të tjera parashikoi organizimin dhe funksionimin e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, përkatësisht të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe Shkollës së Magjistraturës. Kjo paketë ligjore mundësoi edhe ngritjen e një strukture të re kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këshilli u krijua për t'i mbikëqyrur këto ndryshime dhe për të garantuar një funksionim më të mirë të gjyqësorit në Shqipëri.

130. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet prej 11 anëtarë (5 anëtarë jogjyqtarë të zgjedhur nga Kuvendi dhe 6 anëtarë gjyqtarë të zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve). Disa nga funksionet kryesore të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë miratimi dhe zbatimi i planit strategjik për sistemin e gjyqësor; miratimi i standardeve të etikës gjyqësore, rregullave të sjelljes të gjyqtarëve. Këshilli emëron gjyqtarët dhe është përgjegjës për zhvillimin e karrierës dhe disiplinën. Ai i propozon Presidentit të Republikës, kandidatët për Gjykatën e Lartë.

Rekomandimi 26. Regjistrimi civil

131. Ligji nr. 69/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, parashikon procedurën e regjistrimit për rastet e paregjistruara, kur akti i lindjes lëshuar nga shteti tjetër ku ka ndodhur lindja, ka të dhëna të paplota/të pasakta.

132. Në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020, parashikohej lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të regjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe egjiptianët. Dy objektivat e parashikuara këtu janë:

- ofrimi i ndihmës ligjore për pasqyrimin e të dhënave reale në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të komunitetit rom dhe atij egjiptian me qëllim zgjidhjen e problematikave që i pengojnë në aksesin e tyre të plotë në shërbimin e gjendjes civile;

- fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi, si dhe referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e rasteve të trafikuar.

133. Prej vitit 2016, në zyrat e gjendjes civile në bashkitë/njësitë administrative në vend, janë kryer veprime për regjistrimin e fëmijëve të lindur gjatë kësaj periudhe, sipas deklaramit të prindërve për fakte juridike që kanë ndodhur në territorin e RSH-së, si dhe janë të regjistruar/pasqyruar faktet juridike të ndodhura jashtë vendit, nga shtetas shqiptarë. Janë regjistruar 192 raste të fëmijëve romë dhe egjiptianë, si regjistrime të cilat nuk janë kryer në kohën kur ka ndodhur fakti juridik i lindjes, por janë mbajtur më vonë, në sajë të procedurave administrative në fuqi.

Gjetjet dhe rekomandimet 27, 28. Strehimi

134. Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social” përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Ky ligj mbështetet edhe në parimet e mëposhtme:



- Parimi i mosdiskriminimit pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasojë diskriminuese.

- Parimi i respektimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve.

135. Me hyrjen në fuqi të ligjit është mundësuar shtimi i programeve të strehimit: 1) Banesë me kosto të ulët. 2) Banesa sociale me qira. 3) Program i zhvillimit të zonave me qëllim strehimi. 4) Programi i përmirësimit të kushteve të banesës, 5) Programi për krijimin e banesave të përkohshme dhe 6). Programi i banesave të specializuara. Ligji ka parashikuar edhe një sërë instrumentesh financiare në mbështetje të familjeve me të ardhura të ulëta e të mesme, si: subvencionimi i qirasë, subvencionimi i interesave të kredisë për strehim, grant i menjëhershëm për blerjen e një banese me kosto të ulët dhe grantet konkurruese për përmirësimin e kushteve të banimit. Një hap i rëndësishëm në miratimin e këtij ligji është arritur me përcaktimin e procedurave të zhvendosjes, duke përcaktuar mënyrën, kohën dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvendosje.

136. Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social” (neni 2), parashikon:

- “Programe sociale strehimi” janë programe që shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve që nuk kanë banesë dhe banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji, që nuk kanë mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë, si dhe ato familje/individë, banesa e të cilëve është nën normën ligjore të strehimit dhe që nuk kanë të ardhura që të sigurojnë pagesën për një qira minimale në tregun e lirë.

- “Dëbim” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtimet formale, informale ose strukturat që

nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, pa një proces të rregullt ligjor, në mungesë të konsultimit dhe ofrimit të strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe pa siguruar një mbrojtje ligjore efektive.

- “Zhvendosje” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, me ose kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtimet formale ose strukturat që nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, mbështetur në konsultim me subjektet e prekura, në ofrimin e strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe në garantimin e mbrojtjes ligjore efektive.

137. Ky ligj parashikon procedurën e zhvendosjes në rast se qëndrimi në një vendbanim ose strehim bëhet i pamundur, për shkak të investimeve me interes publik, prishje të objektit për shkak të përjashtimit nga procesi i legalizimit ose raste të tjera, të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera. Ligji parashikon procedurën që ndiqet nga njësi e vetëqeverisjes vendore:

- njoftimin me shkrim të individit/familjes për arsyet e zhvendosjes 30 ditë përpara nxjerrjes së aktit administrativ për zhvendosjen nga banesa;

- informimin e individit/familjes për mundësitë alternative të strehimit;

- nxjerr aktin administrativ për zhvendosjen nga banesa 45 ditë përpara zhvendosjes, duke njoftuar edhe formën e miratuar për strehim alternativ;

- zhvendosja, nuk zbatohet pa siguruar më parë sistemimin me strehim të përshtatshëm të individëve/familjeve që zhvendosen dhe nuk përfitojnë shpronësim;

- kundër vendimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për zhvendosje nga banesa, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente;

- individët/familjet që preken nga zhvendosja përfitojnë ndihmë juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

- dispozitat tranzitore të ligjit parashikojnë që për dy vjet nga hyrja në fuqi e ligjit, jo më pak se 5% e përfituesve nga programet e



strehimit i përkasin pakicës rome dhe pakicës egjiptiane.

138. Pas miratimit të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, janë miratuar 22 akte nënligjore në zbatim të këtij ligji, të cilat mundësojnë edhe zbatimin e tij nga pushteti vendor, duke plotësuar kështu paketën e akteve nënligjore në masën 90%²².

139. Lidhur me zhvendosjen dhe dëbimin, VKM-ja nr. 361, datë 29.5.2019, “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj dhe të bashkëpunimit institucional”, i cili parashikon në përputhje me udhëzimet e Kombeve të Bashkuara, procedurat e dëbimit, afatet kohore dhe bashkëpunimin institucional për rastet e zhvendosjes. Kjo VKM trajton të gjithë shtetasit shqiptarë, pavarësisht nëse ata janë pronarë të shtëpisë ku janë vendosur apo jo. VKM-ja parashikon se qytetarët nuk do të detyrohen të largohen nga shtëpia e tyre, deri në ofrimin e një zgjidhje të përshtatshme për ta, sipas programit të strehimit social.

140. Gjatë vitit 2019, afërsisht 118 milionë lekë janë ndarë nga buxheti i shtetit, nga të cilat 65 milionë lekë janë akorduar për subvencionin e qirasë të 674 familjeve që kanë aplikuar sipas ligjit mbi strehimin. Rreth 15,7% i përkasin përfituesve që u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane; 5 milionë lekë për programin e subvencionit të shumës së njëpasnjëshme të 24 familjeve, ku 100% e përfituesve janë familje rome dhe egjiptiane dhe 48 milionë lekë janë dhënë për subvencionin 1-mujor të qirasë së familjeve që janë prekur nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.

141. Gjatë vitit 2020, për zbatimin e projekteve të investimeve, janë vënë në dispozicion rreth 354 milionë lekë nga buxheti i shtetit, nga të cilat 92 milionë lekë për projektet në vazhdim nga 2019 dhe 262 milionë lekë për zbatimin e fazës së parë të projekteve të reja. Pjesa tjetër e fondeve janë parashikuar nga fondet e buxhetit të shtetit të vitit 2021. Projektet e investimeve, përfshijnë investime për: a) përmirësimin e kushteve të

banesave ekzistuese, nga të cilat kanë përfituar 561 familje; b) përshtatjen e ndërtesave shtetërore në objekte banimi, nga të cilat janë përftuar 99 njësi banimi që i shtohen fondit publik të banesave sociale.

142. Familjet e pakicave rome dhe egjiptiane përbëjnë rreth 42% të numrit të përgjithshëm të përfituesve. Në funksion të instrumentit financiar për subvencionimin e qirasë së banesave në treg, janë ndarë nga buxheti i shtetit rreth 3,003 milionë lekë, nga të cilat 87 milionë lekë janë akorduar për subvencionin e qirasë për 1,235 familjeve që kanë aplikuar sipas ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”. Rreth 16% e totali të përfituesve i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane dhe 2,945 milionë lekë për subvencionimin e qirasë, për rreth 13,900 familje të mbetura të pastreha si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019.

Gjetjet dhe rekomandimi 28, 29. Trafikimi i personave

143. Legjislacioni penal shqiptar penalizon trafikimin e personave. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale KPP (i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) përmirësojnë ndjeshëm të drejtat dhe pozitën e viktimës së veprave penale, duke përfshirë edhe parashikime të posaçme për viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore. Më konkretisht, është prezantuar detyrimi për pjesëmarrjen si palë në proces të viktimës së veprës penale, duke garantuar aksesin e saj në procesin penal, janë shtuar nene të tjera, specifikisht për viktimat e trafikimit, në të cilat janë parashikuar si figura të posaçme viktimat e mitur dhe viktimat e abuzuar seksualisht apo subjekt i trafikimit përkatësisht neni 58, 58/a dhe 58/b, 59, 60 dhe 61 i KPP-së.

144. KPP-ja (neni 58), parashikon se: viktimat e veprës penale ka të drejtë:

- të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
- të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
- të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit

²² Informacion i detajuar mbi aktet nënligjore jepet në shtojcat e Raportit.



për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;

- të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;

- d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;

- dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues; g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal.

145. Në ligjin nr. 97/2016, “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” përmirësohet qasjen e viktimave në informacion përmes vendosjes së një koordinatori/koordinatoreje për marrëdhëniet me publikun në secilën prokurori, përgjegjës/përgjegjëse për informimin e viktimave. Në këtë ligj (neni 68) është parashikuar detyrimi i prokurorisë për të garantuar shërbime të nevojshme për trajtimin e subjekteve që gëzojnë status të posaçëm, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe për këtë në çdo prokurori duhet të ketë në përbërje të saj të paktën një koordinator të diplomuar në psikologji, sociologji ose fusha të tjera të posaçme.

146. Organi i prokurorisë i ka kushtuar një vëmendje të posaçme të drejtave të viktimës së trafikimit, ku janë marrë parasysh elementet, që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve të përshtatshme për marrjen në pyetje të viktimës së trafikimit, duke siguruar praninë e punonjësit social apo psikologut, akomodimin e viktimës në qendrat pritëse ku përfitojnë strehim, ushqim dhe shërbime të tjera falas etj. Nuk janë penalizuar viktimat e trafikimit për krime që ato janë bërë si pasojë e trafikimit (falsifikim dokumentesh, ushtrim prostitucioni etj.), pasi nuk mund të penalizohet viktimat për vepra të kryera si rezultat i të qenit viktimë e trafikimit. Nga ana tjetër, ato kanë të drejtë të gjejnë mbështetjen e prokurorisë për futjen në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, nëse ndihen të kërcënuar.

147. Ligji nr. 70/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, ‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të

organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës”, parashikon se dispozitat e tij zbatohen për pasuritë e personave që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbi të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, për kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet e Kodit Penal të “Trafikimit të personave të rritur” dhe “Trafikimit të të miturve”. Ky ligj përcakton krijimin e një fondi të posaçëm për parandalimin e krimit të organizuar. Fondi i veçantë është caktuar për qëllime sociale, duke përfshirë rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të trafikimit (neni 37/2-c). Neni 37/3-b parashikon që nga ky fond përfitojnë edhe OJQ-të, duke përfshirë edhe strehëzat.

148. Në kuadër të parandalimit dhe goditjes së fenomenit të trafikimit të personave, veprimet antitrafikim janë fokusuar kryesisht në përmirësimin e kuadrit ligjor, rivitalizimin dhe forcimin e strukturave kombëtare; në identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit në nivel qendror dhe vendor; kontrollin e trafikimit të brendshëm, kryesisht të fëmijëve dhe grave; përmirësimin e standardeve të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave; intensifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për parandalimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe atë të personelit që punon me shërbimet e ndihmës.

Masat në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

149. Me urdhrin e Kryeministrit nr. 179, datë 19.6.2014, “Për ngritjen e Komitetit Shtetëror kundër Trafikimit të Personave” u rivitalizua Komiteti Shtetëror Antitrafikim, duke u zgjeruar me anëtarë të rinj, me qëllim koordinimin e veprimeve antitrafikim, për t’iu përgjigjur sfidave të reja në luftën kundër trafikimit të personave nëpërmjet sigurimit të kapaciteteve të nevojshme, angazhimit dhe vullnetit për të luftuar energjikisht trafikimin e personave. Komiteti Shtetëror kundër Trafikimit të Personave është organi përgjegjës për koordinimin e marrëdhënieve të institucioneve kombëtare e ndërkombëtare në fushën e luftës kundër trafikimit të personave.



Komiteti drejtohet nga ministri i Brendshëm dhe, anëtarë të tij.

150. Strategjia e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit 2014–2017, miratuar me VKM-në nr. 814, datë 26.11.2014. Dokumenti shpreh qasjen ndaj fenomenit të trafikimit për të krijuar një platformë të mirorientuar synimesh e objektivash strategjike në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare, si dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

151. Me qëllim përmbushjen me efektivitet të detyrimeve, që strukturat shtetërore dhe joshtetërore në nivel lokal, kanë në kuadër të luftës kundër trafikimit të personave, si dhe krijimin e një lidhjeje sa më efikase midis strukturave ekzistuese, në janar 2017, u miratua urdhri i ri i Kryeministrit, “Për ngritjen e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark”. Komitetet Rajonale Antitrafik (KRAT), drejtohen nga Prefekti i Qarkut dhe janë struktura kryesore qendrore në nivel lokal për identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit, evidentimin e problemeve parësore në nivel rajonal, si dhe vlerësimin e gjendjes dhe përcaktimin e nevojave specifike të qarkut.

152. Me VKM-në nr. 770, datë 26.12.2018, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018–2020”, u miratua Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018–2020. Ky plan shpreh angazhimin e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, të aktorëve antitrafikim që punojnë në strukturat publike dhe jopublike, për të minimizuar fenomenin e trafikimit të personave. Aktivitetet e parashikuara synuan:

- përmirësimin e funksionimit të një sistemi gjithëpërfshirës nëpërmjet forcimit të mekanizmit të identifikimit, mbrojtjes dhe riintegritetit të viktimave të trafikimit;

- rritjen e ndërgjegjësisimit dhe informimit publik lidhur me legjislacionin kombëtar e Konventat Ndërkombëtare antitrafikim, me të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët, fëmijët në situatë rruge etj.), si dhe pasojat e tij.

153. Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit (PSV), miratuar me VKM-në nr. 499, datë 29.8.2018. PSV-të janë dokumenti bazë për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Qëllimi është mbrojtja, përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo të mitur, shqiptarë, të huaj apo persona pa shtetësi, për të gjitha llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.

154. Ndër masat e tjera evidentohen: funksionimi efikas i “Mekanizmit Kombëtar të Referimit”, si dhe shtrirja e tij në nivel qarku, bashkie dhe komune (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për marrjen e masave parandaluese dhe identifikimin e personave të trafikuar) në përputhje me standardet dhe PSV-të.

- Në kuadër të parandalimit dhe goditjes së fenomenit të trafikimit të personave, nga ana e strukturave kundër trafikëve të paligjshme është punuar për rritjen e numrit të hetimeve proaktive, rritjen e identifikimit të hershëm të viktimave të trafikimi dhe viktimave të mundshme të Trafikimit, si dhe marrjen e masave mbrojtëse e trajtimin e tyre, sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit.

- Përmirësimi i bazës së të dhënave për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit për regjistrimin, ndjekjen dhe monitorimin e rasteve.

- Rritja e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të punonjësve të policisë së strukturave vendore antitrafik, nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme, në veçanti rreth zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, si dhe mbi teknikat proaktive hetimit të veprave penale të trafikimit të personave.

- Për sa u përket rasteve fëmijë-viktima trafikimi ose viktima të mundshme trafikimi, të



identifikuara në rrezik të lartë dhe menjëhershëm, janë të ngritura dhe funksionojnë dy qendra kombëtare të cilat ofrojnë shërbimin emergjent deri në vendimin e grupit teknik ndërsektorial nëse fëmija do vendoset në përkujdesje alternative apo do të kthehet në familje.

Gjetjet dhe rekomandimet 31, 32. Azilkërkuesit

155. Ligji nr. 121/2014, “Për azilin në RSH-së”, i cili ka qenë në fuqi deri në hyrjen e ligjit të ri për azilin, në shkurt 2021²³ parashikonte: të drejtën për azil apo mbrojtje plotësuese dhe të përkohshme; të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, refugjatëve e të personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese; përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese; të drejtën për bashkim familjar, si dhe përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave nën mbrojtje plotësuese në RSH-së.

156. Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së” është përafuar me standardet ndërkombëtare dhe direktivat e BE-së mbi trajtimin dhe menaxhimin e duhur të refugjatëve dhe migrantëve që hyjnë në territorin shqiptar, si dhe për integrimin e tyre. Ligji garanton që personat që kërkojnë azil të kenë qasje në procedurën e azilit, rregullon kushtet për përpunimin e kërkesave të tyre dhe ofron garanci shtesë për trajtimin e kategorive të ndjeshme midis azilkërkuesve – siç janë të miturit e pashoqëruar. Ligji përfshin një procedurë të përsheptuar për të vlerësuar kërkesat e azilit në mënyrë të shpejtë, kur plotësohen kushtet.

157. Ky ligj zbatohet për të gjithë shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët kanë deklaruar qëllimin për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e RSH-së, për aq kohë sa atyre u lejohet të qëndrojnë në territorin e RSH-së si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe për anëtarët e familjes së tyre. Ligji parashikon se “azili” është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që RSH-së u jep refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese.

158. Në nenin 3, të ligjit nr. 10/2021, “Përkufizime”, ndër të tjera, parashikohen:

- “Mbrojtja plotësuese” është formë mbrojtjeje që i jepet shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, që nuk i përmbush kriteret për të fituar statusin e refugjatit dhe ka arsye serioze e të bazuara të mendohet se në rast të kthimit të tij në vendin e origjinës apo në rastin e personit pa shtetësi në vendbanimin e tij të zakonshëm të mëparshëm, ai rrezikon realisht të përballet me cenime të rënda dhe nuk ka mundësi apo për shkak të rrezikut të tillë nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi.

- “Mbrojtje e përkohshme” është një procedurë e veçantë mbrojtjeje, e cila u siguron mbrojtje të menjëhershme dhe të përkohshme personave të shpërngulur në rastet e flukseve masive, të cilët nuk mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës, në veçanti, nëse ekziston rreziku që sistemi i azilit të jetë i paaftë të procedojë me këtë fluks, pa krijuar efekte të pafavorshme në funksionimin e tij efektiv, në interes të këtyre personave.

- “Kushtet materiale të pritjes” janë kushtet e pritjes që përfshijnë strehimin, ushqimin dhe veshmbathjet e dhëna në natyrë ose në formën e ndihmës financiare, si dhe shpenzimet e përditshme.

159. Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së” (neni 3) parashikon shprehimisht se “moskthimi” është detyrimi i ndalimit për të dëbuar apo kthyer shtetasin e huaj ose personin pa shtetësi në çfarëdolloj mënyre në kufijtë e territoreve ku i kërcënohet jeta ose liria e tij, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjeve të tij politike. Neni 11 “Parimi i moskthimit”, parashikon:

a) kërkuesi, refugjati, personi me statusin e mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtje të përkohshme nuk dëbohet, kthehet apo ekstradohet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë: a) në një shtet ku jeta ose liria e tij kërcënohet për shkak të racës, të besimit, të kombësisë, të anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike;

b) në një shtet ku ka arsye të besueshme se mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet torturës ose ndëshkimit çnjerëzor e degradues apo çdo trajtimi tjetër të parashikuar në Konventën

²³ Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së”, miratuar nga Kuvendi, më 1.2.2021.



Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore dhe Lirive të Njeriut, të interpretuar nga Gjykata Evropiane apo në marrëveshjet/konventat ndërkombëtare ku RSH-ja është palë;

c) në një shtet ku ka arsye të besueshme se mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet zhdukjes me forcë;

ç) në shtetin e tij të origjinës, në rast se të huajve u është dhënë një nga format e mbrojtjes në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

160. Ky ligj (neni 22) parashikon të drejtën e ndihmës ligjore, për kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare, dhënien e informacionit për kriteret dhe procedurën e mbrojtjes ndërkombëtare, si dhe të drejtën për ndihmë ligjore falas, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Sipas nenit 23 “Gjuha e procedurës dhe e drejta për përkthyes”, parashikohet se: në rastet kur kërkuesi nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, i sigurohet shërbimi i përkthimit në gjuhën e shtetit të origjinës ose në një gjuhë që ai e kupton. Lidhur me qëndrimin, ligji nr. 10/2021, neni 43, parashikon se:

- kërkuesi, i cili deklaron qëllimin për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, transferohet në Qendrën e Pritjes për Azil, ku ka të drejtë të qëndrojë deri në momentin kur merret vendimi përfundimtar;

- kërkuesi mund të akomodohet në Qendrën e Pritjes për Azil, në vendin e përcaktuar nga ministria ose në një vend tjetër sipas dëshirës së tij;

- kërkuesi informohet menjëherë, jo më vonë se 15 ditë nga akomodimi për të drejtat dhe detyrimet të cilat duhet t'i përmbushë në lidhje me kushtet e pritjes. Atij i sigurohet informacion për organizatat ose personat që ofrojnë ndihmë të specializuar ligjore, si dhe këshillim për kushtet e pritjes, duke përfshirë edhe kujdesin shëndetësor;

- gjatë qëndrimit në Qendër kërkuesi mund të paraqesë një kërkesë pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët për të qëndruar jashtë saj me shpenzimet e tij, duke evidentuar paraprakisht adresën e re të banimit, si dhe numrin e kontaktit, para miratimit të

kësaj kërkesë nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët;

- pas akomodimit në Qendër, kërkuesi i nënshtrohet vizitës së nevojshme mjekësore.

161. Neni 44, parashikon se: Qendra e Pritjes për Azil është person juridik publik, në varësi administrative të ministrit. Qendra informon autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët për procedurat e hyrjes, të daljes apo të qëndrimit të kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare, të kryera sipas nenit 43, të këtij ligji. Qendra duhet të sigurojë kushtet minimale të jetesës, përfshirë: a) akomodimin; b) ushqimin; c) sigurimin shëndetësor; ç) kushtet minimale të higjienës. Në bashkëpunim me subjekte të tjera, private ose shtetërore, vendëse ose të huaja, në përputhje me të drejtat e kërkuesve e të refugjatëve, zhvillohen programe pedagogjike e edukuese, si dhe këshillim ligjor falas.

162. Azilkërkuesi/ja ka të drejtë të qëndrojë në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkues (QKPA) gjatë kohëzgjatjes së procedurës për dhënien e statusit të refugjatit/mbrojtjes ndërkombëtare. Nëse azilkërkuesit/es i është refuzuar aplikimi për azil i lejohet të qëndrojë në territor apo të akomodohet në qendër derisa të mbarojnë procedurat e ankimit apo afatet për ushtrimin e tyre. Në qoftë se azilkërkuesi/ja ka mundësi të qëndrojë jashtë qendrës pritëse dhe përballon kushtet minimale të jetesës, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët vendos largimin e azilkërkuesit brenda 30 ditëve nga Qendra. Azilkërkuesit/et pajisen me leje qëndrimi dhe kartë shëndeti. Drejtoria vendos në mënyrë konsensuale dhe kolegjiale me shumicë të votave dhe vendimi paraqitet në formë të shkruar dhe është i arsyetuar.

163. Azilkërkuesi ka të drejtë të qëndrojë në territorin e RSH- së deri në përfundimin e procedurës së filluar prej tij, gjithashtu dhe anëtarët e familjes së azilkërkuesit/es, të cilët kanë ardhur në Shqipëri së bashku me azilkërkuesin/en, kanë të drejtë të qëndrojnë. Azilkërkuesit i garantohet e drejta e moskthimit, e drejta e strehimit, e ushqimit, e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve të tjera publike për nevoja ngushtësisht vetjake, të ofruara në qendrën kombëtare pritëse për



azilkërkuesit. Azilkërkuesit e mitur akomodohen së bashku me prindërit e tyre ose pjesëtarët madhorë të familjes, përgjegjës për ata.

164. Procesi i identifikimit dhe referimit (përzgjedhja) e të huajve rregullohet me udhëzimin nr. 293/2015 dhe urdhrin nr. 611/2015, e ministrit të Brendshëm, i ndryshuar, nxjerrë në zbatim të ligjit për azilin. Këto dy akte rregullojnë procedurat për identifikimin dhe regjistrimin e kërkesave për azil, si dhe referimin e tyre tek autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët. Kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare mund të bëhen, jo vetëm në kufi, por edhe brenda territorit të vendit para policisë kufitare dhe oficerëve të policisë së migracionit. Autoriteti Kufitar Rajonal /Vendor i Migracionit është struktura përgjegjëse për zhvillimin e procesit të identifikimit dhe referimit (*Prescreening*) në pikat kufitare ose brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

165. Në rast se autoriteti përgjegjës rajonal/lokal për kufirin dhe migracionin kur identifikon migrantë të parregullt në kufi ose në territor, ai kryen të gjitha procedurat e parashikuara në procesin e *prescreening*, konkretisht: intervistimin, regjistrimin, dokumentimin dhe fotografimin e të huajit të parregullt. Nëse i huaji klasifikohet si azilkërkues, autoriteti përgjegjës rajonal/lokal për trajtimin e të huajve njofton menjëherë Drejtorinë e Azilit dhe autoritetin qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve. Autoriteti përgjegjës rajonal/lokal për kufirin dhe migracionin në rast vështirësish gjatë kryerjes së procesit paraprak për kontrollimin e azilkërkuesve, kërkon praninë e Drejtorisë së Azilit.

166. Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkues është institucion ku akomodohen dhe trajtohen persona të huaj apo pa shtetësi që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri. Qendra kombëtare e akomodimit të azilkërkuesve në RSH-së, ashtu si në të gjitha vendet e BE-së është një qendër e hapur. Si rrjedhojë e investimeve të bëra me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë ka garantuar një kapacitet pritës deri në 240 persona. Azilkërkuesve në këtë qendër ju sigurohet e

drejta e strehimit, e ushqimit, e kujdesit shëndetësor dhe shërbime të tjera jetike të domosdoshme. Kjo qendër disponon mjek, punonjës social, psikologë. Ofrohet kujdes shëndetësor në qendra shëndetësore shtetërore ose private, trajtim psikologjik dhe konsulencë juridike nga specialistët e fushës. Shërbime të tjera të cilat ofrohen nga kjo qendër janë edhe shërbimet sociale-integruese, ku konkretisht përfshihen asistencë psikosociale, respektimi të diversiteteve (racore, etnike, fetare, kulturore), organizimi i aktiviteteve. Janë siguruar ambiente të përshtatshme për fëmijë, biblioteka, sallë internet, si dhe ambiente sportive. Azilkërkuesit qëndrojnë në këto qendra deri në përfundim të procedurave të azilit dhe në rastet e vendimeve negative ata përsëri lejohen të qëndrojnë në këto ambiente deri në përfundim të procedurave të apelit.

167. Gjithashtu, janë ngritur dhe qendra tranzitore pritje për azilkërkues, përkatësisht:

- qendra sociale për migrantë të parregullt dhe azilkërkues në nevojë (grupet vulnerable), në Bashkinë e Gjirokastrës me kapacitet akomodues deri në 15 persona, me fokus të veçantë gratë/fëmijët (gjatë procesit të *prescreening*), duke mundësuar të drejtën e qëndrimit në këtë qendër deri në 72 orë, afat i cili mund të zgjatet sipas nevojave të tyre;

- qendra tranzitore për regjistrim dhe akomodim të përkohshëm të migrantëve të parregullt dhe azilkërkues në Gërhot, Gjirokastrë, ngritja e së cilës u mbështet nga Fondi i Bankës së Këshillit të Evropës për Zhvillim me kapacitet pritës deri në 60 persona;

- qendra tranzitore për regjistrim dhe akomodim të përkohshëm të migrantëve të parregullt dhe azilkërkues në Kapshticë, Korçë, ngritja e së cilës u mbështet nga IOM-i. Kapaciteti i saj akomodues është deri në 60 persona dhe gjithashtu përfshin pajisjet IT për të lejuar procedurën e kontrollit në qendër.

168. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i saj i Veprimit 2019–2022 (miratuar me VKM-në nr. 400/2019), synon rritjen e ndërgjegjësimit të migrantëve për të drejtat e tyre dhe lehtësimin e aksesit në forma të ndryshme të mbështetjes/shërbimeve. Disa nga masat kanë synuar: hartimin e një plani të i



ri emergjence (kontigjence) që Shqipëria të menaxhojë flukset e përziera, duke marrë parasysh: të mitur të pashoqëruar, viktime trafikimi, azil kërkues, individë me aftësi të kufizuara etj.; përmirësimin e infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar për të përmbushur siç duhet nevojat specifike të migrantëve (fëmijë, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara etj.); trajnimin e punonjësve të kufirit për identifikimin e kategorive vulnerabël në rastet e flukseve të përziera masive; zhvillimin e procedurave standarde të qarta për kthimin vullnetar të asistuar, përfshirë për kategoritë vulnerabël; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve; inkurajimin e pjesëmarrjes së grave në policinë kufitare etj.

SHTOJCAT

SHTOJCA NR. 1

1. Avokati i Popullit vlerëson si prioritet të aktivitetit të tij, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Institucioni i Avokatit të Popullit (AP) ka luajtur një rol aktiv gjatë gjithë procesit të hartimit të projektligjit mbi pakicat kombëtare, duke dhënë vërejtje dhe sugjerime, të cilat janë pasqyruar në një masë të mirë të tyre, në përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH-së”. Me gjithë zhvillimet pozitive që lidhen me miratimin dhe hyrjen në fuqi, të ligjit nr. 96/2017 apo edhe të miratimit dhe hyrjes në fuqi të disa prej akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, përsëri mbetet problematike pjesa e nxjerrjes në tërësi të të gjitha akteve nënligjore, të parashikuara si të nevojshme, për zbatimin e të këtij ligji.

2. Censusi i popullsisë: gjatë procesit të konsultimit të projektligjit, “Për censin e popullsisë dhe të banesave”, Avokati i Popullit ka dhënë rekomandimet lidhur me: “zhvillimin e një censusi të ri të popullsisë, mbi bazën e kriterëve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, ku pakicat, do të gjenin veten për t’u shprehur objektivisht dhe pa rezerva për ekzistencën e tyre”. Zhvillimi i një censi në këto standarde do të ndihmonte në zbatimin e disa dispozitave të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”.

3. Sipas institucionit të Avokatit të Popullit, është e nevojshme të kryhet një proces harmonizimi i të gjithë legjislacionit në tërësi, që synon të rregullojë regjimin juridik të censit, pa përjashtuar këtu projektaktet nënligjore dhe projektligjet që lidhen direkt, ose indirekt, në zbatimin e tyre, me procesin e censit dhe të dhënat që sigurohen prej tij. Kjo kërkesë bëhet edhe më sensitive, në rastin e pyetjeve për grupin etnik, fenë dhe gjuhët, përgjigjet e të cilave bazohen në deklarinimin e lirë dhe jo të detyrueshëm të individit. Gjetja e alternativave të duhura në përmbajtjen e pyetësorit të censit të hartuar nga INSTAT-i, merr një rëndësi të veçantë për objektivitetin dhe besueshmërinë e procesit.

4. Kuadri legjislativ për ndalimin e diskriminimit Me ndryshimet e fundit në ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka pasur përmirësime. Avokati i Popullit ka bërë disa rekomandime. Sipas informacionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndryshimet ligjore të propozuara nga Avokati i Popullit janë reflektuar për sa ka qenë e mundur. Duke respektuar kuadrin ligjor aktual²⁴.

5. Avokati i Popullit ka trajtuar problematikat e pakicës kombëtare rome dhe pakicës kombëtare egjiptiane, të cilët hasin ende shumë pengesa për përfshirjen dhe integrimin në sistemin social: strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike, arsimimin, punësimin, formimin profesional, kujdesin shëndetësor. Nga ana e këtij institucioni, institucioneve përgjegjëse u janë dërguar një sërë rekomandimesh në kuadër të përmirësimit të kushteve të jetesës për integrimin e romëve dhe egjiptianëve.

6. Situata socio-ekonomike e romëve dhe egjiptianëve: Avokati i Popullit prej kohësh ka trajtuar problematikat e pakicës kombëtare rome dhe pakicës kombëtare egjiptiane, të cilët hasin ende shumë pengesa për përfshirjen dhe integrimin në sistemin social: strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e

²⁴ Sipas informacionit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, një nga propozimet, i cili nuk është reflektuar është shtimi i “kombësisë”, si shkak.



ndihmës ekonomike apo edhe arsimin, punësimin, formimin profesional, kujdesin shëndetësor.

7. Avokati i Popullit (AP) bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, rekomandoi zgjerimin e kategorisë së subjekteve përfituese të ligjit të ri për ndihmën juridike me viktimat e diskriminimit. Alokimi i mjaftueshëm i fondeve shtetërore, rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit, rritja e aksesueshmërisë pranë klinikave ligjore, janë disa nga masat kryesore që nevojiten për garantimin e ndihmës juridike falas për grupet në nevojë.

8. Avokati i Popullit (AP) deklaroi se një pjesë e kërkesave për ndihmë juridike fillimisht drejtohet te ky institucion. Gjatë periudhës 2018–2019 u depozituan 68 kërkesa (18 nga gratë). Kërkesat e grave kanë objekt kryesisht çështje familjare (zgjidhje martesë, kujdestari, detyrime pensioni ushqimor) dhe civile (shkaktim dëmi, pjesëtim pasurie, njohje vjetërsie në punë). Më të pakta në numër janë çështjet penale.

9. Institucioni i Avokatit të Popullit ka paraqitur një sërë rekomandimesh, mbi përmirësimin e të drejtave të pakicave kombëtare, ku, ndër të tjera, evidentohet²⁵:

- Rekomandim për plotësimin e kuadrit ligjor, për njohjen dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare, në përputhje me përcaktimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, drejtuar Kryeministrit. Ky rekomandim është zbatuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare” apo edhe të miratimit dhe hyrjes në fuqi të disa prej akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

- Rekomandim për përsheptimin e procesit të miratimit dhe hyrjes në fuqi të akteve nënligjore që duhet të nxirren në bazë dhe për

zbatim të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, drejtuar Kryeministrit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Rekomandim “Për marrjen e masave të domosdoshme, të menjëhershme, për pakicën rome dhe pakicën egjiptiane. Për evidentimin e numrit real të individëve dhe familjeve në nevojë, pjesë e komuniteteve rome dhe egjiptiane, të vendosura brenda territorit të njësisë administrative, të administruara nga bashkitë, ka pasur një reagim të mirë ndaj këtij rekomandimi nga shumica e njësive të qeverisjes vendore.

- Rekomandim për marrjen e masave të mëtejshme, për përballimin e kostove financiare të sigurimit të barrierave mbrojtëse (maskave) ndaj përhapjes së COVID-19, për personat e pakicës rome dhe pakicës egjiptiane.

10. Sipas Avokatit të Popullit, një çështje e ndjeshme lidhur me problematikat që shqetësojnë komunitetet e pakicave rome dhe egjiptiane, është “dëbimi me forcë”, nga vendqëndrimet e tyre komunitare të pozicionuara në periferitë e qyteteve kryesore, ku edhe kanë ndërtuar kryesisht baraka. Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, janë adresuar disa lehtësira në fushën e strehimit, për individët dhe familjet rome dhe egjiptiane, si dhe ka një parashikim të përgjithshëm për dëbimet me forcë, por sipas këtij institucioni nuk janë të mjaftueshme. Lidhur me këtë konstatim të Avokatit të Popullit, sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” është miratuar VKM-ja nr. 361, datë 29.5.2019, “Mbi përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi apo strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj dhe të bashkëpunimit institucional”.

11. Kushtet e vështira të pandemisë COVID-19, në vendin tonë, kanë bërë që vëmendja e AP-së të drejtohet në mënyrë të veçantë te gjendja e pakicave rome dhe egjiptiane, duke adresuar disa rekomandime specifike për marrjen e masave të domosdoshme, të menjëhershme.

²⁵ Informacion i detajuar mbi veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit jepet në raportet vjetore:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20Vjetor%20i%20veprimtarise%20se%20institucionit%20te%20Avokatit%20te%20Popullit%20-%20viti%202020.pdf>



SHTOJCA NR. 2
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI (KMD)

1. Një ndër mekanizmat kombëtarë për mbrojtjen e pakicave dhe për garantimin e zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) si një institucion publik dhe i pavarur i cili “siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin” (neni 21, pika 1). Ndryshimet ligjore të ligjit nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, kanë rritur garancitë ligjore për shqyrtimin e situatave diskriminuese.

2. Krahas zyrës qendrore, Komisioneri e ushtron veprimtarinë e tij edhe nëpërmjet zyrave rajonale në Korçë, Shkodër, Fier. Me vendimin nr. 88, datë 23.7.2018, të Kuvendit të Shqipërisë, është vendosur ndryshimi i strukturës dhe organikës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në bazë të këtyre ndryshimeve është rritur numri i stafit të Zyrës, nga 23 punonjës që ishin me strukturën e vjetër në 34 punonjës me strukturën e re. Burimet financiare të Komisionerit, kanë pësuar një rritje të lehtë ndër vite (*kjo në përputhje me zgjerimin e strukturës së KMD-së*), por mbështetje e mëtijshme nevojitet me qëllim realizimin e kompetencave të zgjeruara të Komisionerit.

Rastet e shqyrtuara nga Komisioneri KMD, gjatë periudhës 2018–2020

3. Gjatë vitit 2018, janë trajtuar, 63 çështje (59 ankesa dhe 4 çështje *ex-officio*), me subjekte: 19 meshkuj; 20 femra, 9 grup personash dhe 11 OJF.

- Çështjet e trajtuara janë drejtuar 7 të tilla kundër subjekteve private dhe 56 kundër institucioneve publike (6 çështje kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe 50 çështje kundër institucioneve të pushtetit vendor).

- Sipas fushave: 10 arsim, 5 punësim dhe 48 shërbime.

4. Gjatë vitit 2018, Komisioneri është shprehur me 64 vendime: 41 vendime themeli, 20 vendime mospranimi; dhe 1 vendim pezullim shqyrtimi, 2 vendime ndërprerje të

procedurave. Vendimet kategorizohen si më poshtë:

- 10 vendime diskriminimi;
- 25 vendime mosdiskriminimi;
- 20 vendime mospranimi;
- 6 vendime për arritje efektiviteti;

- 1 vendim ndërprerje procedurash hetimore, pasi ankuesi është tërhequr nga ankesa;

- 1 vendim ndërprerje procedurash hetimore, pasi çështja është paraqitur për gjykim në gjykatë;

- 1 vendim pezullim shqyrtimi.

5. Gjatë vitit 2019, janë trajtuar, 35 çështje (33 ankesa dhe 2 çështje *ex-officio*), me subjekte: 9 meshkuj; 10 femra, 5 grup personash dhe 9 OJF. 7 çështje kundër subjekteve private dhe 28 ndaj institucioneve publike (7 çështje kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe 21 çështje kundër institucioneve të pushtetit vendor). Sipas fushave: 7 çështje mbi arsimin dhe 28 çështje mbi shërbimet.

6. Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me 33 vendime: 26 vendime themeli, 4 vendime mospranimi dhe 3 vendime ndërprerje të procedurave, që kategorizohen:

- 12 vendime diskriminimi (7 vendime në fushën e të mirave dhe shërbimeve janë zbatuar, 1 vendim në fushën e të mirave dhe shërbimeve është kundërshtuar në gjykatë, 2 vendime në fushën e të mirave dhe shërbimeve janë ende në proces dhe 2 vendime në fushën e arsimit janë zbatuar).

- 9 vendime mosdiskriminimi;

- 4 vendime mospranimi;

- 5 vendime për arritje efektiviteti;

- 2 vendim ndërprerje procedurash hetimore, pasi ankuesi është tërhequr nga ankesa;

- 1 vendim ndërprerje procedurash hetimore, për mungesë informacioni.

7. Gjatë vitit 2020, janë trajtuar, 16 çështje (15 ankesa dhe 1 çështje *ex-officio*), me subjekte: 4 meshkuj; 4 femra, 4 grup personash dhe 3 OJF.

- Çështjet e trajtuara, janë: 2 të tilla kundër subjekteve private dhe 14 kundër institucioneve publike (7 çështje kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe 7



çështje kundër institucioneve të pushtetit vendor).

- Sipas fushave: 2 arsim, 3 punësim dhe 11 shërbime.

8. Gjatë vitit 2020, Komisioneri KMD:

- ka trajtuar 22 çështje (21 ankesa dhe 1 çështje *ex-officio*), me subjekte: 6 meshkuj; 5 femra; 5 grup personash dhe 5 organizata të shoqërisë civile (OJF);

- çështjet e trajtuara, janë: 3 të tilla kundër subjekteve private dhe 19 kundër institucioneve publike (9 çështje kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe 10 çështje kundër institucioneve të pushtetit vendor);

- sipas fushave: 2 arsim, 3 punësim dhe 17 në shërbime.

9. Gjatë vitit 2020, Komisioneri është shprehur me 16 vendime: 14 vendime themeli dhe 2 vendime mospranimi, si më poshtë:

- 5 vendime diskriminimi (4 vendime në fushën e të mirave dhe shërbimeve janë në proces, 1 vendim në fushën e punësimit është kundërshtuar në gjykatë);

- 5 vendime mosdiskriminimi;

- 2 vendime mospranimi;

- 4 vendime arritje efektiviteti.

10. Gjatë periudhës janar–nëntor 2020, Komisioneri është shprehur me 14 vendime: 12 vendime themeli dhe 2 vendime mospranimi si më poshtë:

- 5 vendime diskriminimi (4 vendime në fushën e të mirave dhe shërbimeve janë në proces, 1 vendim në fushën e punësimit është kundërshtuar në gjykatë);

- 4 vendime mosdiskriminimi;

- 2 vendime mospranimi;

- 3 vendime për arritje efektiviteti.

11. Gjatë periudhës janar–prill 2021, KMD-ja ka trajtuar 19 çështje (16 ankesa dhe 3 çështje *ex-officio*), me subjekte: 8 meshkuj; 1 femra; 3 grup personash dhe 4 organizata të shoqërisë civile (OJF).

- Çështjet e trajtuara janë: 5 të tilla kundër subjekteve private dhe 14 kundër institucioneve publike (4 çështje kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe 10 çështje kundër institucioneve të pushtetit vendor).

- Sipas fushave: 19 në shërbime.

12. Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 11 vendime: 8 vendime themeli dhe 3 vendime mospranimi, si më poshtë:

- 2 vendime diskriminimi (2 vendime në fushën e të mirave dhe shërbimeve janë në proces);

- 2 vendime mosdiskriminimi;

- 3 vendime mospranimi;

- 4 vendime arritje efektiviteti.

13. Raste të trajtuara – tipologjia e problematikave:

- Problematika e furnizimit me energji elektrike për anëtare të pakicave romë dhe egjiptiane. Komisioneri urdhëroi Entin Rregullator të Energjisë Elektrike të marrë masa për ndryshimin e Rregullores duke çliruar nga barra e pagesës së tarifës së lidhjes së re, aplikantët që trajtohen me statusin e “klientit në nevojë”, të cilët ndodhen në pamundësi financiare.

- Problematika e furnizimit me ujë të pijshëm, mungesa e kanalizimeve apo ndriçimit në zona ku pjesa më e madhe e banorëve i përkasin pakicave romë apo egjiptiane është trajtuar në disa raste nga Komisioneri në qytete të ndryshme, si: Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë. Në rastin e banorëve në Shkodër dhe në Korçë, autoritetet kanë zbatuar vendimet e Komisionerit duke zgjidhur problematikat e konstatuara.

- Problematika e përdorimit të terminologjisë së papërshtatshme për etiketimin e zonave të caktuara të cilët banohen nga anëtarë të pakicave romë ose egjiptiane, në dokumentacion zyrtar të përdorur nga ofruesi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike në qytetin e Shkodrës. Gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komisioneri operatoi i furnizimit me energji elektrike në qytetin e Shkodrës mori masa të menjëhershme mbi problematikën.

- Problematika e braktisjes së shkollës nga fëmijët romë për shkak të varfërisë. Institucionet përgjegjëse morën masat përkatëse për hapjen e klasave të arsimit bazë me kohë të pjesshme në shkollën 9-vjeçare “Agimi” Maliq, për vitin shkollor 2020–2021, duke zgjidhur problematikën e adresuar pranë Komisionerit.



- Problematika e segregimit të fëmijëve që u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane në shkolla të caktuara. Komisioneri konstatoi diskriminimin në formën e segregimit, të nxënësve romë dhe egjiptianë, që mësonin në shkollën 9-vjeçare “Liria” Shkodër dhe shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, Ajasem, Shkodër dhe urdhëroi marrjen e masave të menjëhershme për rregullimin e situatës dhe parandalimin e situatave të tilla në të ardhmen.

- Gjuha e përdorur në media, median sociale, ndaj pakicave rome, egjiptiane, nga gazetarë, persona publike madje edhe deputetë, janë konsideruar nga KMD-ja si diskriminim ndaj këtyre grupeve.

- Largimi nga puna, nga punëdhënësi institucion publik, për një grua që i përkiste pakicës rome, është gjetur diskriminuese nga Komisioneri.

14. Lidhur me arsimimin e pakicave kombëtare, Komisioneri ka konstatuar problematikën e mëposhtme, të cilat i ka adresuar tek organet kompetente.

- Problematika e regjistrimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në kopshtet publike në qytetin e Tiranës. Bazuar në rekomandimin e Komisionerit, Bashkia Tiranë mori masa për përfshirjen e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom/egjiptian, si kategori, që përfiton shërbim pa pagesë në kopshtet dhe çerdhet publike të Tiranës.

- Problematika e segregimit të fëmijëve që u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane në shkolla të caktuara është evidentuar nga Komisioneri. Problematikën me transportin e fëmijëve.

- Problematika e braktisjes së shkollës nga fëmijët romë për shkak të varfërisë. Përmes arsimit bazë të pjesshëm atyre mund t’u jepet mundësia për të përfunduar arsimin e detyrueshëm për t’u regjistruar më pas në arsimin e mesëm profesional dhe më tej.

15. *Amicus curie*/palë e tretë në gjykatë: bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2014, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër

që ka rëndësi për çështjen”. Komisioneri ka parashtruar mendimin e tij, si person i tretë, lidhur me çështjen objekt “Konstatimin e diskriminimit në formën e “Shqetësimit” dhe “Diskriminimit të tërthortë” ndaj paditësve anëtarë të pakicës rome dhe për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuese përmes ndreqjes së shkeljeve ligjore.

16. Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të Komisionerit, gjithashtu, edhe e përfaqësuesve në zyrat rajonale në qytetin e Fierit, Shkodrës dhe Korçës. Aktivitetet ndërgjegjëse kanë qëllim nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sensibilizimin dhe informimin, ofrimin e informacioneve për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, aktivitetet konsistojnë në:

- daljet publike të Komisionerit në median vizive dhe të shkruar;

- shpërndarja e materialeve ndërgjegjëse dhe organizimi i ditëve të hapura;

- botimeve i fletëpalosjeve të KMD-së dhe botimeve të tjera;

- vazhdimin e fushatave ndërgjegjëse në shkollat 9-vjeçare;

- leksione të hapura me studentët; zhvillimi i aktiviteteve për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, organizatat joqeveritare.

17. Në fushën e strehimit janë trajtuar temat:

- diskriminimi në fushën e strehimit;

- mungesa e banesave dhe kushtet në të cilat jetojnë romët dhe egjiptianët;

- mungesa e të ardhurave, kusht për të pasur një banesë;

- dëbimi i romëve dhe egjiptianëve nga banesat e tyre për shkak të ndërhyrjes në infrastrukturë;

- politikat sociale të Planit të Veprimit për Romët dhe Egjiptianët në fushën e strehimit.

18. Në fushën e punësimit janë kryer takime me grupe të ndryshme, siç janë: gratë e dhunuara, të rinjtë dhe vetë komunitetin. Temat që janë trajtuar:

- Punësimi. Situata aktuale e tyre.

- Diskriminimi që ndodh në vendin e punës nëpër institucionet dhe bizneset private.

- Punësimi informal.



- Kurset profesionale risi për t'u integruar në punë.

- Politikat e shtetit për këtë kategori dhe zbatueshmëria e tyre.

- Punësimi i të rinjve që kanë mbaruar arsimin e lartë.

19. Në fushën e arsimit janë trajtuar këto tema:

- Diskriminimi në arsimin parauniversitar;

- Braktisja e shkollës fenomen tepër shqetësues në ditët e sotme;

- Politikat sociale që ekzistojnë në fushën e arsimit parauniversitar dhe atë universitar;

- Promovimi i modeleve të suksesshme në komunitet;

- Promovimi i vlerave, kulturës, traditave të romëve dhe egjiptianeve. Rruajtja e gjuhës rome;

- Përfshirja e mësuesve romeve dhe egjiptianë në sistemin e arsimit parauniversitar;

- Arsimi mjet që të çon drejt integritetit shoqëror. Arsimimi në kohë pandemie.

20. Në vendimarrje:

- njohja me miratimin e ligjit për pakicat kombëtare;

- diskriminimi në institucionet;

- punësimi në administratë publike;

- rëndësia e votës. Përfshirja në këshillat bashkiakë dhe institucionet qendrore;

- regjistrimi i fëmijëve, fenomen që sjell problematika sociale për shfrytëzim dhe trafikim të qenieve njerëzore.

21. Në fushën e shëndetit:

- diskriminimi në fushën e shëndetit;

- marrja e shërbimeve në ambientet shëndetësore dhe spitalore; kushtet higjieno-sanitare të banesave në kohën e pandemisë.

22. KMD-ja ka rekomanduar përmirësimin dhe harmonizimin e legjislationit, për:

- ligjin për gjendjen civile në lidhje me konceptin e “kryefamiljarit” dhe detyrave të parashikuara nga ligji, për të garantuar marrjen e pëlqimit të të dy bashkëshortëve në procedurat e deklarimit të vendbanimit (2016);

- ligjin kundër dhunës në familje për harmonizimin me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe identifikimin drejtpërdrejt në ligj të mbrojtjes nga diskriminimi (2018);

- Kodin e Punës mbi: shmangien e diskriminimit të punonjëseve në rastet e

llogaritjes së shpërblimit vjetor për punonjëset me leje lindje në mënyrë të ndryshme nga dhënia e masës së shpërblimit si gjithë punonjësit e tjerë që kanë punuar gjatë gjithë vitit; mos konsiderimin si diskriminim të rasteve kur llogaritja e shpërblimit vjetor për punonjëset/punonjësit me leje prindërore, bëhet në përpjesëtim me kohën e punuar, duke u zbritur periudha kur nuk është punuar për shkak të lejes; dhënien e shpërblimeve si inkurajim, apo shpërblimeve të një natyre që nuk kushtëzohen me punën e kryer në të shkuarën, për të gjitha/ë punonjëset/punonjësit pavarësisht nëse kanë qenë me leje lindje apo leje prindërore.

23. KMD-ja dhe AP-ja kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi (maj 2018) për koordinimin dhe bashkëpunimin efektiv në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht për mosdiskriminim dhe barazi në ligj dhe para ligjit, promovimin e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individëve.

SHTOJCA NR. 3

KOMITETI PËR PAKICAT KOMBËTARE

1. Në nenin 20 të këtij ligji parashikohet se Komiteti për Pakicat Kombëtare përbëhet nga përfaqësuesit e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij ligji, pra përfaqësues të 9 pakicave kombëtare të njohura me ligjin nr. 96/2017²⁶.

- Secila prej pakicave kombëtare, ka të drejtë të ketë nga një përfaqësues në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Pakicat Kombëtare. Anëtarët e Komitetit për Pakicat Kombëtare emërohen me urdhër të Kryeministrit, mbështetur në kandidaturat e paraqitura nga shoqatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare. Mandati i anëtarit të komitetit është katërvjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje.

- Kryetari i Komitetit për Pakicat Kombëtare dhe nënkryetari emërohen me urdhër të Kryeministrit, çdo katër vjet. 4.

²⁶ Pakicat kombëtare të parashikuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij ligji janë: greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.



Përzgjedhja e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare bëhet nëpërmjet një procesi të pavarur, transparent dhe gjithëpërfshirës. Procedurat dhe rregullat për zhvillimin e këtij procesi rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga Kryeministri.

2. VKM nr. 726, datë 12.12.2018, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare” është nxjerrë në zbatim të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

3. VKM nr. 286, datë 10.5.2019, “Për miratimin e procedurave të zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Pakicave Kombëtare” parashikon:

- miratimin e procedurave të përzgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare (në vijim “KPK”), nëpërmjet një procesi të pavarur, transparent e gjithëpërfshirës;

- përzgjedhjen e kandidaturave për kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e KPK-së kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurave të hapura e publike të konkurrimit, nga Kryeministria, bazuar në pikën 4, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

4. Në zbatim të këtij vendimi, gjatë periudhës janar–shkurt 2021 janë shpallur procedurat e aplikimit për pozicionin e kryetarit dhe nënkryetarit të Komitetit për Pakicat Kombëtare. Procedurat e hapura publike të konkurrimit ndiqen nga Kryeministria, bazuar në pikën 4, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Këto procedura përfshijnë edhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët. Në datën 28 shkurt 2021, ka përfunduar afati i aplikimit dhe aktualisht po ndiqen procedurat përkatëse në bazë të ligjit nr. 96/2017 dhe VKM-së nr. 286, datë 10.5.2019. Ky njoftim është shpallur dhe publikuar në faqen zyrtare të Kryeministrisë²⁷.

5. Lidhur me funksionimin e buxhetit të Komitetit të Pakicave për vitin 2021, është financuar numri i punonjësve të shtuar në përputhje me strukturën e tyre të miratuar.

6. Projektvendimi “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e “Fondit për Pakicat Kombëtare”, do të nxirret në zbatim të nenit 21, pika 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit (duke qenë se Komiteti për Pakicat Kombëtare funksionon si organ i pavarur pranë Kryeministrit).

7. Projektvendimi do të përcaktojë një procedurë transparente, funksionale, efektive, të bazuar në legjislacionin në fuqi, lidhur me:

- përfituesit e mundshëm të këtij fondi; procedurën që do të ndiqet për përcaktimin e shumës vjetore të fondit;

- parimet në të cilat mbështetet administrimi dhe shpërndarja e fondit; procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së fituesve;

- mënyrat e monitorimit të zbatimit të drejtë dhe të dobishëm të projekteve të financuara; garantimin e transparencës dhe të barazisë gjatë gjithë procesit, duke u bazuar në rregulla objektive të paracaktuara në detaje.

8. Krijimi i këtij Fondi të posaçëm për financimin ekskluzivisht të nismave dhe projekteve, që ruajnë dhe promovojnë të drejtat e pakicave dhe karakteristikat e identitetit të tyre të dallueshëm përbën një hap të mirëpritur dhe të kërkuar nga shoqatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare. Efektet e pritshme janë rritja e sasisë dhe cilësisë së kapaciteteve të shoqatave që përfaqësojnë pakicat kombëtare, si dhe ndjenja e vlerësimit dhe përfshirjes së tyre në politikat favorizuese të shtetit shqiptar ndaj kulturës dhe vlerave të tyre.

9. Fondi për Pakicat Kombëtare parashikohet të financohet nga buxheti i shtetit dhe pas miratimit administrohet nga Komiteti për Pakicat Kombëtare në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin

²⁷ <https://kryeministria.al/newsroom/n-j-o-f-t-i-m-p-e-r-a-p-l-i-k-i-m-8/>
Faqe | 10068



buxhetor në fuqi. Fondi parashikohet si zë me vete në buxhetin vjetor të shtetit dhe duhet të jetë i mjaftueshëm për financimin e projekteve në bazë të një relacioni të argumentuar vjetor që i paraqet Komiteti i Pakicave Kombëtare dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pas konsultimit me përfaqësuesit e pakicave kombëtare.

10. Projektvendimi mbi Fondin do të përcaktojë: përfituesit e mundshëm të financimit nëpërmjet fondit; shqyrtimin e projekteve dhe përzgjedhjen e kandidatëve përfitues; fazat e procesit dhe procedurës së përzgjedhjes, dokumentacionin e nevojshëm, afatet, kriteret e përgjithshme të pranimit të kandidatëve/aplikantëve, kushtet për përfitimin e grantit; detyrat e Komisionit të Vlerësimit të Projekteve, i cili ka dhe rolin kryesor gjatë procesit të përzgjedhjes. Kriteret e përzgjedhjes do të mundësojnë transparencën e procesit, si dhe arsyet përkatëse të argumentuara në rast të mos shpalljes si fitues. Fondi financiar (buxheti) do të jepet në bazë të një relacioni të argumentuar vjetor, që do të përgatitet nga Komiteti i Pakicave Kombëtare në konsultim me përfaqësuesit e nëntë pakicave kombëtare dhe do t'i paraqitet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë²⁸.

11. Projektvendimi është hartuar nga Komiteti për Pakicat Kombëtare dhe është në proces konsultimi me institucionet e linjës. Iniciativën propozuese për miratimin në Këshillin e Ministrave ushtrohet nga Kryeministri, duke qenë se Komiteti për Pakicat Kombëtare është institucion, në varësi të Kryeministrit.

SHTOJCA NR. 4 KULTURA

1. Ministria e Kulturës vijon të mbështesë financiarisht organizime ndër më prioritetet me të njëjtin fokus, duke përmendur aktivitete, si:

- “Përmeti Multikulturor, Minoritete dhe Etni”, Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës. Në kriteret shkencore të pjesëmarrjes parashikohet pasqyrimi si pjesë të trashëgimisë kulturore shpirtërore kombëtare, të gjitha ato vlera të krijuara nga pakicat kombëtare.”

- Festivali Multikulturor Berat;

- Kremtimi i 8 Prillit, Ditës Botërore të Romëve;

- Mbështetje financiare për botime veprash letrare mbi romët në Shqipëri;

- Mbështetje financiare për organizimin e projektit “ Ditët e minoritetit Rom në Shqipëri”;

- Mbështetje financiare për koncert festiv me muzikë dhe veshje tradicionale nga pakica rome;

- Kremtimi i 5 Majit, Ditës së Shën Gjergjit (Herdelezi) – festë nga trashëgimia kulturore e pakicës rome;

- Kremtimi i Ditës Ndërkombëtare të Vllahëve;

- Organizimi i takimit botëror të vllahëve në Ditën e Shën Mërisë në Voskopojë;

- Promovime veprash letrare dhe historike mbi pakicën arumune në Shqipëri;

- Organizimi i takimeve me pakicën maqedonase në Prespë;

- Mbështetje financiare për koncertin folklorik të pakicave kombëtare në Sarandë.

- Sigurimi i një aksesit më të lartë dhe pjesëmarrje aktive në kulturë nga pakicat kombëtare mund të sigurohen duke zhvilluar dhe zbatuar projekte që mbrojnë dhe promovojnë identitetin kulturor dhe gjuhën e tyre, si:

- dhënia e asistencës profesionale dhe këshillimit për standardet e dokumentimit të diversitetit dhe trashëgimisë jomateriale (trajnime, seminare);

- mbështetja financiare nga MK-ja e rrjetit të aktiviteteve të organizuara nga shoqatat

²⁸ Sipas propozimeve të Komitetit për Pakicat Kombëtare synohet të paraqiten dy thirrje për aplikim për financim projektsh në vit (një thirrje çdo gjashtë muaj) dhe do të financohen tetëmbëdhjetë projekte në çdo thirrje. Vlera totale e financimit vjetor të kërkuar është me një vlerë të paktën për 2 thirrje dhe rreth 45 000 000 lekë Minimalisht vlera e një projekti të dedikuar për çdo pakicë në çdo thirrje do të jetë 1 000 000 lekë, atëherë $9 \times 1\,000\,000 = 9\,000\,000$ lekë.



kulturore sidomos të punës kërkimore në bashkëpunim dhe me pushtetin vendor;

- publikimi i literaturës së shkruar në gjuhët e pakicave kombëtare, së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe;

- rritja e përfaqësimit të grupeve të pakicave kombëtare në festivalet artistike kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara nga Ministria e Kulturës etj.

SHTOJCA NR. 5

INFORMACION MBI INFORMIMIN E PAKICAVE MBI ZHVILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR (FUSHATA NDËRGJEGJËSUESE, SPOTE, FLETË PALOSJE GJATË PERIUDHËS 2016–2020

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në përmbushje të misionit të tij për edukimin zgjedhor të shtetasve, ka treguar vëmendje të veçantë për hartimin dhe realizimin e programeve edukues dhe informues për çështje zgjedhore për pakicat kombëtare, me fokus të veçantë pakicën rome dhe pakicën egjiptiane. Problemet ekonomike dhe sociale të këtij komuniteti kushtëzojnë qasjen me procesin zgjedhor, ku më evidentet janë mungesa e informacionit dhe pjesëmarrja e ulët në procesin e votimit.

2. Zgjedhje vendore 2019 – KQZ-ja nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Komitetin Shtetëror të Pakicave Kombëtare. Të gjitha materialet informuese/ edukuese/ ndërgjegjësuese, u prodhuan edhe në gjuhët e nëntë pakicave kombëtare. Komiteti Shtetëror i Pakicave Kombëtare realizoi përkthimin në gjuhët e pakicave kombëtare të materialeve informuese, edukuese, ndërgjegjësuese për zgjedhjet e datës 30.6.2019, si dhe u angazhua për shpërndarjen e tyre në njësitë e vetëqeverisjes vendore me numrin më të madh të tyre.

3. Fletëpalosjet në gjuhë të pakicave kombëtare u shpërndanë në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat që u përkasin pakicave kombëtare përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, bazuar në informacionin e dërguar nga Ministria e Brendshme, Agjencia për Mbushjen e Vetëqeverisjes Vendore, e cila referonte të

dhëna për popullsinë banuese dhe pakicat kombëtare përkatëse në nivel bashkie, si dhe në nivel qarku. Posterat informues dhe edukues në gjuhë të pakicave kombëtare (5 lloje), u dërguan në KZAZ-të përkatëse për t'u shpërndarë dhe afishuar në qendrat e votimit me vendndodhje në njësitë e vetëqeverisjes vendore me numrin më të madh të pakicave kombëtare. Informacione për zhvillimin e procesit zgjedhor të datës 30.6.2019, si dhe mesazhe sensibilizuese për pjesëmarrje në votime u përcollën nga Komiteti Shtetëror i Pakicave Kombëtare, në kuadër të bashkëpunimit me KQZ-në, përmes hapësirës mediatike në gjuhë të secilës pakicë kombëtare në Radio-Televizionin Shqiptar (lajmet ditore).

4. U realizua projekti i veçantë “Vota ime vlen” për pakicën kombëtare rome dhe atë egjiptiane në bashkëpunimin me IRCA-në (Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri), në 12 qarqet e vendit. Gjithashtu, KQZ-ja, në bashkëpunim me prezencën e OSBE-së, realizoi në vendqëndrimet e komuniteteve rome dhe egjiptiane projektin informues dhe ndërgjegjësues me fokus gratë dhe të rinjtë.

5. Programi i veçantë për pakicat kombëtare, parashikon mjete dhe mënyra, jo vetëm të shkruara, por edhe përmes spoteve televizive, duke synuar që zgjedhësit që u përkasin pakicave kombëtare, edhe në gjuhën e pakicave kombëtare:

- të informohen për të drejtat dhe detyrat e zgjedhësit gjatë periudhës zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve;

- llojin e zgjedhjeve, orarin e votimit, kush gëzon të drejtën për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur;

- dokumentet e identifikimit të vlefshme për votim;

- kontrollin e emrit në ekstraktin e përbërësve zgjedhor dhe në listën e zgjedhësve, hapat që duhen ndërmarrë për korrigjimin e pasaktësive apo mungesës së emrit në lista;

- procedurat e votimit, ku në fokus do të jetë procedurat për identifikimin elektronik;

- veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;

- informimin mbi procesin zgjedhor: sistemin e zgjedhjeve për Kuvend, përmbajtjen e fletës së votimit, kandidatët për deputetë,



formulën e shpërndarjes së mandateve; administrimin e procesit zgjedhor të datës 25 prill 2021, ndërgjegjësimin, për:

- vlerën që ka vota e lirë dhe e pandikuar në zgjedhjet demokratike;

- shmangien dhe denoncimin e veprimeve që cenojnë votën e lirë dhe sistemin e zgjedhjeve demokratike;

- pjesëmarrjen në votime, si e drejtë kushtetuese dhe detyrim qytetar për shoqërinë dhe vendin.

SHTOJCA NR. 6

AKTET NËNLIGJORE MBI STREHIMIN

- VKM nr. 453, datë 3.7.2019, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”.

- VKM nr. 458, datë 3.7.2019, “Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore, që përshtaten nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me grante konkurruese nga buxheti i shtetit”.

- VKM nr. 459, datë 3.7.2019, “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njërive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”.

- VKM nr. 384, datë 12.6.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

- VKM nr. 361, datë 29.5.2019, “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj dhe të bashkëpunimit institucional”.

- VKM nr. 362, datë 29.5.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”.

- VKM nr. 522, datë 25.7.2019, “Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”.

- VKM nr. 823, datë 18.12.2019, “Për procedurat e blerjes së shtëpive në tregun e lirë që do t'i shtohen fondit publik të shtëpive me qira sociale.

- VKM nr. 179, datë 26.2.2020, “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave.

- VKM nr. 300, datë 15.4.2020, “Për procedurat e shkëmbimit të njërive të përballueshme të banesave.

- VKM nr. 301, datë 15.4.2020, “Për normat e strehimit, kushtet dhe standardet për shtëpitë sociale që blihen në tregun e lirë dhe shtëpitë me kosto të ulët”.

- Rregullorja e ministrit nr. 31, datë 18.11.2019, “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin nga fondet e buxhetit të shtetit për programet e strehimit.

- Mbështetje për strehimin e familjeve rome dhe egjiptiane, përmes projekteve të investimeve.

- Udhëzim i përbashkët nr. 22, datë 5.6.2020, “Për mënyrën e ndërveprimit të programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale të punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor”.

- VKM nr. 496, datë 24.6.2020, “Për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar të strehimit, si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë”.

- VKM nr. 579, datë 22.7.2020, “Për përcaktimin e institucioneve publike që administrojnë strehët, i kriterëve, procedurave dhe kapaciteteve të mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike, si dhe procedurat e administrimit dhe mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme, kompetencat e subjekteve përgjegjëse dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre”.

- Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 33 datë 26.8.2020, “Për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme”.

- Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 40, datë 23.10.2020, “Për



mënyrën e administrimit dhe të mirëmbajtjes së banesave të specializuara”.

- VKM nr. 898, datë 18.11.2020, “Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyer në fond banesë të paprivatizuara”.

SHTOJCA NR. 7 TRAJNIMET E PERSONELIT LIGJZBATUES

1. Në vazhdimësi janë zhvilluar trajnime të stafit policor lidhur me rregullat dhe procedurat standarde që kanë të bëjnë me mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e dhomave të sigurisë të Policisë së Shtetit; respektimin dhe garantimin e të drejtave themelore të tyre si: mbrojtja me avokat; ofrimi i shërbimit mjekësor; njohja me të drejtat e tyre; njoftimi i familjarëve për arrestimin/ndalimin dhe vendndodhjen e tyre; trajtimi ushqimor; kushtet dhe standardet e ambienteve ku mbahen e trajtohen kjo kategori personash; e drejta për të paraqitur kërkesë – ankesa për trajtimin që ju bëhet/sjelljen e qëndrimin e policisë etj. Sipas programeve vjetore të trajnimeve në Policinë e Shtetit, realizohen trajnime të specializuara në Akademinë e Sigurisë me punonjës të policisë të nivelit zbatues dhe drejtues të drejtorive vendore të Policisë.

2. Në programet vjetore të trajnimeve të Policisë së Shtetit janë planifikuar trajnime, në shërbim i punonjësve të policisë të strukturave vendore dhe trajnime të specializuara për nivelin zbatues dhe atë të parë të drejtimit, si: shërbimi i patrullës përgjithshme, shërbimi i policisë rrugore, ndihmës specialistët e policimit në komunitet, punonjës të strukturave për krimet etj., lidhur me njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të individëve gjatë shoqërimit, ndalimit, arrestimit dhe trajtimit në ambientet e Policisë së Shtetit.

3. Trajnimet lidhen me njohjen e akteve ndërkombëtare, Kushtetutën, Kodin e Procedurës Penale, ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, ligje të tjera, Manualin, “Për trajtimin dhe sigurimin e të arrestuarve/

ndaluarve në dhomat e sigurisë të njësive të policisë”; “Rregullat dhe procedurat standarde për hedhjen e administrimit e të dhënave për personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në sistemin ADAM; “Përcaktimet ligjore për shoqërimin, rastet e shoqërimit, trajtimi i të shoqëruarve dhe përcaktimet e bëra në procedurën standarde të punës.

4. Seminare dhe tryeza të rrumbullakëta të zhvilluara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me njohjen dhe zbatimin e ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Trajnime organizuar nga Këshilli i Evropës mbi “Trajtimin e përshtatshëm të të ndaluarve/arrestuarve në ambientet policore”. Janë zhvilluar seminare/tryeza të rrumbullakëta të përbashkëta me OJQ/OJF për të prezantuar dhe diskutuar raportet e monitorimeve të hartuara.

5. Nga strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe ato të drejtorive vendore të policisë janë administruar njohur dhe analizuar raportet e monitorimeve të kryera nga Avokati i Popullit. Gjithashtu, janë përgatitur e dërguar përgjigjet për Avokatin e Popullit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të bëra pas inspektimeve të kryera. Janë realizuar takime midis Avokatit të Popullit dhe drejtuesve të Lartë të Policisë së Shtetit për forcimin e bashkëpunimit, përmbushjen e detyrave nga Policia e Shtetit duke respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ndjekjen dhe trajtimin ligjor të ankesave të për shkelje të të drejtave të tyre nga policia etj. Janë zhvilluar seminare e tryeza të rrumbullakëta nga Avokati i Popullit, lidhur me kushtet dhe standardet e ofrimit të shërbimit shëndetësor ndaj të ndaluarve/arrestuarve në ambientet e policisë; prezantimin e projekt raporteve të vizitave monitoruese të kryera në strukturat e Policisë së Shtetit.

6. Trajnime Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – dhuna me bazë gjinore dhe dhuna ndaj grave.

- Përmirësimi i kuadrit ligjor në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje;

- Dhuna në familje dhe roli i autoriteteve përgjegjëse;



- Kompjuterizimi i të dhënave dhe përdorimi i sistemit *on-line* të rasteve të dhunës në familje;

- Buxheti gjinor dhe ngritja e kapaciteteve të nëpunësve gjinorë në nivel qendror dhe vendor;

- Trajnimi i nëpunësve gjinorë të ministrive;

- Standardet evropiane lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin – rëndësia e njohjes dhe zbatimit nga sistemi i drejtësisë;

- Trajnime të punonjësve të policisë, për dhunën në familje, në drejtoritë vendore të policisë;

- “Roli i Policisë së Shtetit në zbatim të ligjit, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe në mekanizmin e reagimit të koordinuar ndaj dhunës në familje”;

- “Hetimi i krimeve seksuale”, dhuna në familje, të miturit dhe krimet seksuale, si dhe specialistë të krimeve në komisaritet e policisë.

- Trajnime për njohjen dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore në adresimin e dhunës në familje.

SHTOJCA 8

INFORMACION MBI TRAJNIMET PERIODIKE TË SHKOLLËS E MAGJISTRATURËS

- Zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventave për të drejtat e njeriut. Roli gjykatës dhe i sistemit të drejtësisë. Standardet evropiane lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin, rëndësia e njohjes dhe zbatimit të tyre nga sistemi i drejtësisë. Kuadri ligjor vendës dhe praktika gjyqësore lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin.

- Kuadri institucional lidhur me çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimit.

- Trafikimi i qenieve njerëzore. Ndjekja dhe gjykimi penal i veprave të trafikimit të qenieve njerëzore në përputhje me risitë në Kodin e Procedurës Penale. Të drejtat e viktimës së trafikimit gjatë procesit penal.

- Barazia gjinore dhe dhuna me bazë gjinore, me fokus ndryshimet ligjore, shërbimet ndaj viktimës dhe rehabilitimin/punën me dhunuesit.

- Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Roli i gjykatës me fokus problematiken e praktikës gjyqësore

- Detyrimet që burojnë nga Konventa e Stambollit dhe Rekomandimet e Komitetit Grevio për sistemin e drejtësisë.

- Ndryshimet në ligjin, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe bashkërendimi institucional në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.

- Rrethi i subjekteve që gëzojnë mbrojtje nga ligji nr. 9669/2006 dhe subjekteve të mbrojtura nga neni 130/a i Kodit të Familjes;

- Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave.

- Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me fokus kryesor praninë e të pandehurit në gjykim.

- Të drejtat e migrantëve dhe azilkërkuesve. Standardet e mbrojtjes së parashikuar në konventat e ratifikuara nga Shqipëria në fushën e migracionit dhe azilit, dhe direktivave të BE-së në këtë fushë. Probleme të praktikës gjyqësore shqiptare. Vështrim krahasimor me praktikat e mira.

- Azili, të drejtat e azilkërkuesve.

SHTOJCA NR. 9

TË DHËNA STATISTIKORE PËR PERIUDHËN 2018–2020, PËR DHUNËN DHE KRIME TË TJERA TË NDODHURA NË MARRËDHËNIET FAMILJARE – MINISTRIA E BRENDSHME:

1. Gjatë vitit 2018

Janë evidentuar gjithsej 4951 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat:

- Janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori 1914 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në marrëdhëniet familjare, prej të cilave 1373 raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 608 autorë.

- Janë trajtuar me kërkesëpadi, “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 3037 raste të dhunës në familje.



- Janë evidentuar 11 vrasje në familje, me 20 viktime, prej të cilave gra/vajza janë 11 dhe nga këto 4 kanë qenë bashkëshorte.

2. Gjatë vitit 2019

- Janë evidentuar gjithsej 4629 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat;

- Janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori në 1793 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në marrëdhëniet familjare, prej të cilave 1341 raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 535 autorë.

- Janë trajtuar me kërkesëpadi, “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 2836 raste të dhunës në familje.

- Janë evidentuar 14 vrasje në familje, me 17 viktime, prej të cilave gra/vajza janë 12 dhe nga këto 8 kanë qenë bashkëshorte.

3. Gjatë vitit 2020

- Janë evidentuar gjithsej 2053 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat:

- Janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori 847 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në marrëdhëniet familjare, prej të cilave 674 raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 270 autorë.

- Janë trajtuar me kërkesëpadi, “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 1206 raste të dhunës në familje.

- Janë evidentuar 4 vrasje në familje, nga të cilat janë shkakuar 5 viktime, prej të cilave gra/vajza janë 4 dhe nga këto 3 kanë qenë bashkëshorte.

4. Tabela përmbledhëse e të dhënave për dhunën në familje.

Viti	Raste dhune në familje/ evidentuar gjithsej	Kërkesëpadi për UMM/UM	Procedime neni 130/a, K.P.	Arrestuar për 130/a	Vrasje në familje
2018	4951	3037	1373	608	11
2019	4629	2836	1341	535	14
2020 6-mujori	2053	1206	674	270	4

SHTOJCA NR. 10

TË DHËNA MBI PROCEDIMET PENALE (DHUNA) - PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 1349 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 1050 procedime;

Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 1239 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 878 procedime;

Gjatë vitit 2020 (6-mujori I) janë regjistruar 554 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 380 procedime.

SHTOJCA NR. 11

TË DHËNAT STATISTIKORE, MBI TRAFIKIMIN, PARAQITUR NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË PËR PERIUdhËN 2014 – KORRIK 2020, PARAQITEN SI MË POSHTË:

Për vitin 2018, janë evidentuar në total 38 vepra penale me 51 autorë, sipas veprave penale:

- 30 vepra penale për “Trafikimi personave të rritur”, me 42 autorë.

- 8 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 9 autorë.

Për vitin 2019, janë evidentuar në total 41 vepra penale me 62 autorë, sipas veprave penale:

- 34 vepra penale për “Trafikim i personave”, me 21 autorë.

- 7 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 8 autorë.



Për periudhën janar-korrik 2020 janë evidentuar në total 20 vepra penale me 25 autorë, sipas veprave penale:

- 16 vepra penale për “Trafikim i personave”, me 21 autorë.

- 4 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 4 autorë.

VENDIM

Nr. 390, datë 30.6.2021

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË TRETË PERIODIK KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 40, të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, aderuar me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të tretë periodik kombëtar për zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT

CIVILE DHE POLITIKE (ICCPR) Komiteti për të Drejtat e Njeriut (CCPR)

SHQYRTIMI I RAPORTEVE DËRGUAR
NGA SHTETET PALË
NË MBËSHTETJE TË NENIT 40, PIKA
1/B, TË PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR
TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE
SHQIPËRIA

RAPORTI I TRETË PERIODIK KOMBËTAR

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtimeve

Hyrje

I. Masat për zbatimin e neneve të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike Diskriminimi racor

II. Masat për zbatimin e vëzhgimeve dhe rekomandimeve përfundimtare

Shtojcat

Lista e shkurtimeve

AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
CAT	Komiteti i Konventës kundër Torturës
DPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shteti
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
KiE	Këshilli i Evropës
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MKRDHF	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
QKPA	Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkues
RSH	Republika e Shqipërisë
UM	Urdhrat e mbrojtjes



UMM	Urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes
VP	Vëzhgimet përfundimtare
VT	Viktimat e trafikimit
VTM	Viktimat e mundshme të trafikimit

I. HYRJJE

Republika e Shqipërisë ka aderuar në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike²⁹ me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991. Gjithashtu, ka aderuar në Protokollin Opsional të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (aderuar më 4 tetor 2007), si dhe Protokollin e Dytë Shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (aderuar me ligjin nr. 9726, datë 7.5.2007).

Bazuar në nenin 40, pika 1/b, të Paktit ICCPR, Shqipëria ka paraqitur pranë Komitetit për të Drejtat e Njeriut (Komiteti HRC) dy raporte kombëtare për zbatimin e dispozitave të Paktit ICCPR dhe të rekomandimeve të Komitetit HRC³⁰. Komiteti mori në shqyrtim raportin e dytë, në mbledhjet e tij të mbajtur në korrik 2013³¹ dhe miratoi vëzhgimet përfundimtare në gusht 2013³².

Raporti është hartuar në përputhje me udhëzimet specifike (*guidelines*)³³, për hartimin e raporteve periodike. Në pjesën e parë të raportit trajtohen masat e ndërmarra për zbatimin e dispozitave kryesore të Konventës. Në pjesën e dytë trajtohen masat për zbatimin e vëzhgimeve përfundimtare dhe rekomandimeve të Komitetit HRC. Raporti përmban informacion mbi periudhën 2014–2021, duke përfshirë informacionin e nevojshëm, në funksion të një raportimi të plotë. Në shtojcat, pjesë përbërëse të raportit, paraqitet informacion shtesë për zbatimin e Paktit ICCPR.

Kushtetuta e RSH-së, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, që janë pjesë e sistemit ligjor të brendshëm, dhe kuadri ligjor i brendshëm garantojnë zbatimin në praktikë të të drejtave të njeriut.

Mbështetur në ligjin nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e

Shqipërisë”, ministritë dhe institucionet kompetente informojnë periodikisht Ministrinë për Evropën dhe Punët të Jashtme (MEPJ), në kuadrin e hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në të cilat RSH-ja është palë. MEPJ-ja drejton procesin e hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve për të drejtat e njeriut, të cilat i paraqet për miratim pranë Këshillit të Ministrave (neni 25/3/4).

Bazuar në urdhrin nr. 112, datë 5.3.2014, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërministror të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, MEPJ-ja koordinon procesin e përgatitjes së raporteve kombëtare mbi zbatimin e konventave për të drejtat e njeriut. Raporti është hartuar si rezultat i koordinimit dhe përfshirjes së kontributeve të institucioneve qendrore (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të pavarura (Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi).

Raporti i Tretë Periodik Kombëtar mbi Zbatimin e Paktit ICCPR miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në shtojcat pjesë përbërëse të Raportit paraqiten informacione shtesë, sipas fushave.

I. INFORMACION MBI ZBATIMIN E NENEVE TË PAKTIT PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

Neni 2. Mosdiskriminimi: mjetet juridike efektive ndaj shkeljeve të të drejtave

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë³⁴ (e ndryshuar) përcakton qartë parimin e barazisë para ligjit dhe ndalimin e diskriminimit padrejtësisht për shkaqe, të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore (neni 18). Kushtetuta

²⁹ Këtej e tutje Pakti ICCPR.

³⁰ Këtej e tutje Komiteti HRC.

³¹ CCPR/C/SR.3003.

³² CCPR/C/ALB/CO/2.

³³ CCPR/C/2009/1.

³⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007; nr. 9904, datë 21.4.2008; nr. 88/2012, datë 18.9.2012 nr. 137/2015, datë 17.12.2015 dhe nr. 76/2016, datë 22.7.2016.



dhe kuadri ligjor, institucional dhe politikat, sipas fushave, bazohen në parimin e mosdiskriminimit për shkaqet e parashikuara edhe nga Pakti ICCP, si dhe marrjen e masave ligjore ose të masave të tjera të nevojshme për zbatimin e të drejtave civile dhe politike.

2. Kushtetuta, në kreun II, parashikon të drejtat dhe liritë vetjake, si: e drejta e jetës; liria e shprehjes; liria e shtypit, e radios dhe e televizionit; e drejta e informimit; liria e ndërgjegjes dhe e fesë; ndalimi i torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës; ndalimi i kryerjes së punës së detyruar; ndalimi i heqjes së lirisë, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj; garantimi i të drejtave gjatë ndalimit, procesit të hetimit, procesit penal, gjykimit dhe vuajtjes së dënimit; liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit; paprekshmëria e banesës; zgjedhja e vendbanimit dhe lëvizja e lirë; ndalimi i dëbimit; e drejta e pronës private;

3. Në kreun III parashikohen të drejtat civile dhe politike: e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur; liria e votës dhe fshehtësia e saj; krijimi dhe regjistrimi i organizatave ose i shoqatave për çfarëdo qëllimi të ligjshëm; liria e tubimeve paqësore.

4. Gjatë periudhës së raportimit, parimet e barazisë dhe ndalimit të çdo forme diskriminimi të parashikuara në Kushtetutën e RSH-së, siç parashikohet dhe në nenin 2/1 të Paktit ICCPR³⁵:

5. Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili ka për qëllim: a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive, ofrimin e ndihmës e mbështetjes, si dhe përcaktimin e organeve publike dhe jopublike, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë.

6. Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i cili parashikon garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Ndër parimet bazë të veprimtarisë së Policisë së Shtetit janë: a) ligjshmëria; b)

mosdiskriminimi; c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

7. Kodi i Procedurave Administrative në RSH-së (miratuar me ligjin nr. 44/2015)³⁶ parashikon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo lloj diskriminimi për shkaqet e përcaktuara.

8. Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH” ku parimi i mosdiskriminimit për një tërësi shkaqesh, renditet në parimet bazë për ofrimin e shërbimeve. Ligji parashikon ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të trafikuar, për gratë dhe vajzat shtatzëna ose prind i vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç etj.

9. Ligji nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në RSH”, që ndër të tjera synon punësimin e personave të pafavorizuar në tregun e punës, si: personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, jetimet/jetimet, gratë viktime të dhunës dhe trafikimit etj.

10. Ligjin 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSH”, që përmirëson qasjen e viktimave në informacion përmes vendosjes së një koordinatori/koordinatoreje për marrëdhëniet me publikun në secilën prokurori, përgjegjës/përgjegjëse për informimin e viktimave.

11. Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, që prezantoi konceptin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor edhe në nivel të vetëqeverisjes vendore.

12. Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku barazia dhe mosdiskriminimi përmenden që në parimet e përgjithshme të tij. Ligji përcakton se çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar “masat e mbrojtjes” për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Për herë të parë parashikohet mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge apo që punojnë/shfrytëzohen për punë, adresimi i formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve, si: bulizmi, dhuna në shkollë, në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik, siguria e fëmijëve në internet, fëmijët e pashoqëruar ose viktime të trafikimit etj.

³⁵ Kodet dhe ligjet janë paraqitur në mënyrë kronologjike, sipas viteve të miratimit.

³⁶ Hyrë në fuqi në vitin 2016.



13. Ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, që garanton parimin e mosdiskriminimit dhe parashikon një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët, promovon riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe parandalon riviktimizimin/viktimizimin dytësor të fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një vepre penale.

14. Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”³⁷, udhëhiqet nga parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit të individëve lidhur me të drejtën për ndihmë juridike, profesionalizmit në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike; ndër të tjera garanton ndihmë juridike falas për kategori të veçanta: viktima të dhunës në familje, abuzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore, të mitur/mitura në konflikt me ligjin, fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim etj.

15. Ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale”, të ndryshuar, ku parashikohen dispozita të reja ligjore, që përmirësojnë ndjeshëm pozitën e viktimës në çështjet penale, si dhe të drejta procedurale të posaçme për viktimën e mitur, të abuzuar seksualisht dhe të trafikimit të qenieve njerëzore.

16. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH”, ku garantimi i mosdiskriminimit dhe i barazisë së plotë përpara ligjit jepen që në qëllimin e tij.

17. Ligji nr. 70/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës”, përcakton krijimin e një fondi të posaçëm për parandalimin e krimit të organizuar, për të cilin përdoren si burim pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara (me vendimin e Gjykatës). Fondi i veçantë është caktuar për qëllime sociale, duke përfshirë rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të trafikimit.

18. Ligji nr. 32/2017, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, ku parashikohet që masat e posaçme të mbrojtjes të zbatohen ndaj personave që bashkëpunojnë me organet e drejtësisë.

19. Ligji nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”, i cili parashikon forcimin e masave mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave, përmes lëshimit të urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet. Për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesë ose bashkëjetesë. Ligji u ndryshua edhe në tetor 2020, duke saktësuar masat për largimin e dhunuesit nga banesa dhe kthimin me mbarimin e afatit të UMM/UM, programet specifike të rehabilitimit për dhunuesin, regjistrin e UMM/UM-ve etj.

20. Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, ka si objekt zbatimin dhe monitorimin e politikave për sigurimin e strehimit të përballueshëm dhe të përshtatshëm për kategoritë që nuk përballojnë dot kostot e strehimit në treg, gjithashtu përcakton rregulla të përgjithshme, normat standarde, dhe siguron financime për realizimin e politikave të programeve, si dhe përcaktimin e institucioneve shtetërore të ngarkuara për zbatimin e këtij ligji. Në ligj theksohet parimi i mosdiskriminimit, për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara përfitojnë shtresat vunerabël përfshirë viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna.

21. Ligji nr. 110/2018, “Për noterinë”, që fuqizon pavarësinë ekonomike të gruas dhe është garant kryesor i të drejtave pronësore të saj, duke sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive.

22. Ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”, që gjithashtu rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore.

23. Ligji nr. 69/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009,

³⁷ Hyrë në fuqi, më datë 1.6.2018.



“Për gjendjen civile”, ku parashikohet procedura e regjistrimit për rastet e paregjistruara, kur akti i lindjes lëshuar nga shteti tjetër ku ka ndodhur lindja, ka të dhëna të paplota/të pasakta.

24. Ligji nr. 13/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të huaj”, ku parashikohet mbrojtje më e mirë për viktimat e huaja të trafikimit.

25. Në përputhje me ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, miradministrimi dhe përdorimi eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e konfiskuara realizohet nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si institucion në varësi të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

26. Ligji nr. 35/2020, “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi penal i RSH-së’”, i ndryshuar, parashikon kriminalizimin e dhunës psikologjike, mbrojtjen e personave në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, si dhe ashpërsimin e dënimeve për disa figura të kësaj vepre penale.

27. Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në RSH” ku përcaktohen si përfitues/përfituese të ndihmës ekonomike ndër të tjera viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre, si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

28. Ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” që garanton kushtet për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

29. Kodi Zgjedhor (i ndryshuar)³⁸, parashikon garancitë kushtetuese për shtetasit shqiptarë të së drejtës për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur, si

dhe ndalimin e diskriminimit, sipas shkaqeve ligjore.

30. Ligji nr. 115/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e RSH-së’, të ndryshuar”, ku parashikohet sistemi zgjedhor për Kuvendin dhe përcaktohet që ligji për zgjedhjet siguron përfaqësim gjinor.

31. Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010 ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’”³⁹, ku parashikohet ndër të tjera shtimi i diskriminimit të shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, gjuhës së urrejtjes, segregimit, ngacmimi seksual etj., si dhe e drejta e KMD-së për vënin në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar papajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën etj.

32. Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së”⁴⁰, që garanton të drejtën për azil të shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, i cili ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi për shkak të frikës së bazuar për të qenë i persekutuar për arsye të racës, të besimit fetar, të kombësisë, të anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose të bindjes politike (neni 5).

Mjetet juridike efektive ndaj shkeljeve të drejtave

33. Kushtetuta parashikon se kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj. Parashikohet e drejta e rehabilitimit dhe/ose zhdëmtimit në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

34. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016⁴¹, parashikohet se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17, të Kushtetutës (kufizimi i të drejtave dhe lirive).

³⁸ Miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjet nr. 74/2012, datë 19.7.2012, nr. 31/2015, datë 2.4.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, dhe nr. 118/2020, datë 5.10.2020.

³⁹ Paraqitur në shkurt 2020 dhe miratuar në tetor 2020.

⁴⁰ Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së”, miratuar nga Kuvendi, më 1.2.2021.

⁴¹ Neni 43, ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.



35. Kodi i Procedurave Administrative i RSH-së, siguron realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor. Ky Kod zbatohet ndër të tjera kur organi publik, në ushtrimin e funksioneve publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshëm të personave, si dhe çdo rast tjetër, kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ. Kodi parashikon “organin publik”, si dhe palët që janë çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë.

Neni 3. Barazia gjinore

36. Ligji nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në Shqipëri” (neni 15/1) parashikon se përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet, kur: “a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese”.

37. Nisur nga rëndësia që ka zbatimimi i masave pozitive për të eliminuar diskriminimin dhe për të përsheptuar barazinë reale, me ligjin nr. 139/2015, “Për vetë qeverisjen vendore” u është vënë detyrim kryetarëve/eve të bashkisë që në emërimet e zëvendës kryetarëve/eve të bashkisë dhe emërimet e administratorëve/eve të njësive administrative të zbatojnë dhe respektojnë barazinë gjinore.

38. Kodi Zgjedhor (i ndryshuar), garanton respektimin e parimit të barazisë gjinore dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë dhe aktive në jetën politike dhe publike të gjinisë së nënpërfaqësuar si instrument themelor në konsolidimin e sistemit demokratik.

39. Në prill të vitit 2015 janë miratuar ndryshime ligjore të Kodit Zgjedhor duke vendosur kuotën 50% burra dhe 50% gra në listat e kandidatëve/eve për këshilltarët/et në zgjedhjet vendore. Ndryshimet reflektuan ndarjen e re administrative territoriale dhe

trajtohen një rekomandim të OSBE/ODIHR-it, për të promovuar kandidatet gra duke rritur kuotat gjinore në listat e kandidatëve(eve) për këshillat bashkiakë në 50 për qind, duke ndërruar gjininë në çdo emër të dytë. Përveç kësaj, në rast të hapjes së një vendi të lirë në këshill, zëvendësimi duhet të bëhet me kandidatin/en pasues/e të së njëjtës gjini të renditur më lart në listë.

40. Me ligjin nr. 101/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor”, parashikohet respektimi i parimit të barazisë gjinore, sipas përcaktimeve që i jep këtij parimi legjislativ në fuqi në RSH-së. Detyrimi për respektimin e parimit të barazisë gjinore u përket subjekteve zgjedhore, administratës zgjedhore dhe gjykatës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtë të ndërhyjë për pushimin e cenimit të këtij parimi dhe, në rast mosveprimi, të ndërhyjë kryesisht për rivendosjen e tij. Ligji zgjedhor nxit barazinë gjinore për organet e zgjedhura dhe administratën zgjedhore përmes: vendosjes së kuotave gjinore për gjininë e nënpërfaqësuar në jo më pak se 30% të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë dhe të organeve të njësive bazë të qeverisjes vendore; vendosjes së kuotave gjinore për gjininë e nënpërfaqësuar në jo më pak se 30% të përbërjes së të gjitha niveleve të administratës zgjedhore.

41. Ligji nr. 136, datë 5.12.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i RSH-së” (i ndryshuar), përcakton disa elemente mbi sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve, ndalimin e diskriminimit, marrëdhëniet e punës, si dhe mbrojtjen e veçantë të grave. Disa nga parashikimet me ndikim të drejtpërdrejtë mbi gratë janë: përmirësimi i konceptit të shqetësimit seksual në vendin e punës; barra e provës; garanci shtesë për të siguruar rikthimin në punë të gruas pas mbarimit të lejes së lindjes; mosdiskriminimin në shpërblim të barabartë për meshkujt dhe femrat.

Neni 6. E drejta e jetës

42. Kodi Penal⁴², i ndryshuar, me një sërë ligjesh në kreun II parashikon vepra penale kundër jetës, si: vrasja me dashje; vrasja me

⁴² Miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995



paramendim; vrasja për gjakmarrje; vrasja në rrethana të tjera cilësuese; vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare; vrasja e foshnjës; vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike; vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme; kanosja serioze për hakmarrje ose për gjakmarrje; nxitja për gjakmarrje; kanosja; kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik etj.

Neni 7. Tortura, trajtimet mizore, çnjerëzore e poshtëruese

43. Kushtetuta e RSH-së dhe legjislacioni shqiptar, parashikojnë një sërë dispozitash, të cilat garantojnë se askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, si dhe lidhur me parandalimin e akteve të torturës apo keqtrajtimeve. Përcaktimi në Kodin Penal të RSH-së (me ndryshimet përkatëse), i torturës si vepër penale dhe dënimin përkatës përbën një masë kryesore në parandalimin e akteve të torturës (neni 86). Gjithashtu Kodi Penal e përcakton torturën apo çdo akt tjetër çnjerëzor, si dhe rastet kur këto veprime kanë sjellë pasoja të rënda, si vepër penale me dënimin përkatës (neni 87).

44. Kodi i Procedurës Penale (i ndryshuar) përcakton se: 1. Liria e personit mund të kufizohet me masa sigurimi vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj. 2. Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit poshtërues. 3. Të dënuarve me burgim u sigurohet trajtimi njerëzor dhe rehabilitimi moral.

45. Në vitin 2020, me ligjin nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"⁴³, në nenin 3 "Përkufizime", parashikohet se: "Torturë" është çdo veprim me anë të të cilit të burgosurit i shkaktohen qëllimisht dhembje ose vuajtje të rënda fizike ose mendore, kur këto dhembje ose vuajtje shkaktohen nga personeli i institucionit ose një person tjetër, që vepron në përmbushje të detyrës zyrtare ose me nxitjen apo pëlqimin e tij, i kryer për një nga qëllimet e parashikuara në Konventën kundër Torturës dhe trajtimit ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese. Ligji synon garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe

të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

46. Prej vitit 2008, në bazë të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" (i ndryshuar⁴⁴), institucioni i Avokatit të Popullit ushtron funksionet e "Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues".

Neni 8. Ndalimi i punës së detyruar

47. Kodi i Punës ndalon çdo lloj punë të detyruar në të gjitha format e saj. Kodi i Punës përcakton si punë të detyruar ose të detyrueshme çdo punë ose shërbim që i kërkohet individit kundër vullnetit të tij, duke e kërcënuar me një dënim të çfarëdoshëm.

48. Ndalohet përdorimi i punës së detyruar, si:

- a) masë shtrënguese ose sanksion ndaj personave që kanë ose që shprehin bindje në kundërshtim me rendin politik, ekonomik, shoqëror në fuqi;
- b) metodë mobilizimi ose përdorimi të fuqisë punëtore për qëllime të zhvillimit ekonomik;
- c) masë për disiplinën në punë;
- ç) dënim për pjesëmarrje në grevë;
- d) masë diskriminimi racor, shoqëror, kombëtar ose fetar.

Neni 9. E drejta e lirisë dhe sigurisë së personit nga arrestimi arbitrar dhe burgosja

49. Në bazë të nenit 27 të Kushtetutës, "Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Ndër të tjera parashikohet se liria e personit mund të kufizohet, kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj. Personi duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohe kundër vendimit të gjyqtarit. Në të gjitha rastet e tjera, personi, që i hiqet liria në rrugë

⁴³ I miratuar nga Kuvendi në datën 25.6.2020.

⁴⁴ Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".



jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, që vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase (neni 28/4). Çdo person, të cilit i është hequr liria, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij (neni 28/5).

50. Sipas nenit 28, personit të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet dhe ky person duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij⁴⁵.

51. Kushtetuta (neni 30) përcaktohet se “Kushdo konsiderohet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Sipas nenit 31, “gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë; a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij; b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe; ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas kur nuk ka mjete të mjaftueshme; d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, që mund të sqarojnë faktet”.

52. KPP-ja (neni 5) parashikon kufizimet e lirisë së personit vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj; ndalimin e torturës, dënimit apo trajtimit poshtërues; trajtimi njerëzor dhe rehabilitimi moral i të dënuarve me burgim. KKP-ja i ndryshuar⁴⁵, parashikon se:

- i pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat në rastet e parashikuara nga ky Kod (neni 6);

- në të gjitha fazat e procedimit përdoret gjuha shqipe. Personat që nuk dinë shqip përdorin gjuhën e tyre dhe, me anën e përkthyesit, kanë të drejtë të flasin e të marrin dijeni për provat e aktet, si dhe për zhvillimin e procedimit (neni 8);

- faktet në procesin penal provohen me çdo provë, me kusht që ato të mos cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. 2. Organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij (neni 8/a);

- rregulla të përgjithshme për marrjen në pyetje: 1. I pandehuri, edhe kur është me masë sigurimi izoluese ose kur i është hequr liria për çdo lloj shkakut tjetër, merret në pyetje i lirë, përveç rasteve kur duhen marrë masa për të parandaluar rrezikun e ikjes ose të dhunës. 2. Nuk mund të përdoren, as me pëlqimin e të pandehurit, metoda ose teknika për të ndikuar mbi lirinë e vullnetit ose për të ndryshuar aftësinë e kujtesës e të vlerësimit të fakteve KPP i ndryshuar (neni 38).

53. Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” (neni 16/25): “Shoqërimi” është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji.

54. Janë parashikuar rastet kur personi shoqërohet, koha e mbajtjes si i shoqëruar, të drejtat që kanë kjo kategori personash gjatë qëndrimit në ambientet e policisë (dhe jo vetëm), si dhe detyrimet për personelin policor, si:

- trajtimi i të shoqëruarve të bëhet në kushte të ndryshme dhe jo të njëjlojta si personat e ndaluar/arrestuar;

- në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë;

- i shoqëruari ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit;

- të njoftohet i shoqëruari se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë;

- i shoqëruari ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin;

- personat e shoqëruar kanë të drejtë që t'i drejtohen gjykatës në çdo kohë;

- dokumentimi nga punonjësi i policisë në procesverbal për veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e

⁴⁵ Me ligjin nr. 35/2017.



procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

55. Gjatë periudhës së mbajtjes dhe trajtimit të personave deri në 10 orë, nga ana e policisë gjyqësore/specialistët dhe ndihmësspecialistët e policisë kryhen veprime policore dhe procedurale për verifikimin e sqarimin e rrethanave të çështjes/arsyes për të cilën është shoqëruar personi dhe në përfundim të saj vendoset nëse personi do të arrestohet/ndalohet apo ndiqet në gjendje të lirë. Koha e qëndrimit/mbajtjes si të shoqëruar për personat e ndaluar/arrestuar llogaritet në kohën e ndalimit/arrestimit dhe për këtë në procesverbalet përkatëse si kohë të ndalimit/arrestimit pasqyrohet ora e shoqërimit (ora faktike kur i është privuar liria) dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Neni 12. E drejta e lëvizjes dhe e vendbanimit

56. Kushtetuta (neni 38) garanton të drejtën e zgjedhjes së vendbanimit, lëvizjes lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit, si dhe daljen lirisht jashtë shtetit. Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, ‘Për gjendjen civile’, të ndryshuar” (nenet 14–17), parashikon: të drejtën e deklarimit dhe regjistrimit të vendbanimit; regjistrimin dhe ndryshimin e vendbanimit; sipas ligjit, deklarimin e vendbanimit apo të banesës për pjesëtarët e një familjeje ka të drejtë ta bëjë kryefamiljari ose, në pamundësi të tij, çdo person madhor i familjes. Shtetasi i mitur, apo që i është hequr zotësia për të vepruar, ka vendbanim të njëjtë, sipas rastit, me atë të kryefamiljarit, prindit me të cilin jeton apo të kujdestarit të tij.

Neni 13. Ndalimi i dëbimit

57. Kushtetuta parashikon mbrojtjen dhe trajtimin e të huajve dhe garantimin e të drejtave të tyre, si dhe parimin e moskthimit të një personi në një vend tjetër ku ai do t’i nënshtrohej torturës. Të drejtat, liritë themelore dhe detyrimet për shtetasit shqiptarë vlejnë edhe për të huajt, personat pa shtetësi me përjashtim të rasteve kur ushtrimi i tyre lidhet në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare (neni 16).

58. Ligji nr. 108/2013, “Për të huajt” (i ndryshuar me ligjin nr. 74/2016, datë 14.7.2016 dhe ligjin nr. 13/2020), rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së

të huajve në/nga Republika e Shqipërisë. Subjekt i këtij ligji janë të huajt, të cilët hyjnë ose synojnë të hyjnë në RSH-së, me qëllim qëndrimin, kalimin transit, punësimin, studimin, si dhe daljen e tyre nga RSH-së. Ky ligj garanton të drejtat dhe detyrimet e të huajve që punojnë dhe jetojnë në Shqipëri.

59. Ligji nr. 121/2014, “Për azilin në RSH-së”, i cili ka qenë në fuqi deri në hyrjen e ligjit të ri për azilin, në shkurt 2021⁴⁶ parashikonte: të drejtën për azil apo mbrojtje plotësuese dhe të përkohshme; të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, refugjatëve e të personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese; përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese; të drejtën për bashkim familjar, si dhe përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave nën mbrojtje plotësuese në RSH-së. Ky ligj parashikonte detyrimin për të mos kthyer dhe larguar jashtë territorit të vet, personat që kanë përfituar apo kërkuar të drejtën e azilit apo të mbrojtjes së përkohshme.

60. Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së” është përafëruar me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së mbi trajtimin dhe menaxhimin e duhur të refugjatëve dhe migrantëve që hyjnë në territorin shqiptar, si dhe për integrimin e tyre. Ligji garanton që personat që kërkojnë azil të kenë qasje në procedurën e azilit, rregullon kushtet për përpunimin e kërkesave të tyre dhe ofron garanci shtesë për trajtimin e kategorive të ndjeshme midis azilkërkuesve – siç janë të miturit e pashoqëruar. Ligji, përfshin një procedurë të përsheptuar për të vlerësuar kërkesat e azilit në mënyrë të shpejtë, kur plotësohen kushtet.

61. Sipas ligjit (neni 11/2), “I huaji, kërkesa e të cilit është refuzuar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët”, nuk dëbohet ose nuk nxirret jashtë territorit të RSH-së përpara ushtrimit apo dhënies së mundësive ligjore për ushtrimin e të drejtave procedurale dhe garancive të parashikuara në këtë ligj, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe. Përjashtimisht, kërkuesi mund të kthehet, kur: a) ka arsye të bazuara për ta konsideruar atë si një

⁴⁶ Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së”, miratuar nga Kuvendi, më 1.2.2021.



rrezik për sigurinë kombëtare të RSH-së; b) është dënuar me vendim të formës së prerë, veçanërisht për një krim i cili përbën rrezik për sigurinë e RSH-së.

Nenet 14, 16, 17. Barazia para ligjit, mbrojtja para ligjit

62. Kodi i Procedurës Penale i RSH-së (i ndryshuar) parashikon se legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve. Me ndryshimet në vitin 2017⁴⁷ dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit, si dhe të pandehurit e mitur (nenet 1, 2). Neni 11 i KP-së, parashikon se, Gjykata është organi që realizon dhënien e drejtësisë dhe askush nuk mund të deklarohet fajtor dhe të dënohet për kryerjen e një veprave penale pa vendim gjykatë.

63. Kodi i Procedurës Penale (i ndryshuar) parashikon dispozita të detajuara mbi: procedurat, afatet e përfundimit të hetimeve: kushtet e procedimit; gjykimin; akuzat; marrja e vendimit; vendimi i dënimit.

64. Kodi i Procedurës Penale⁴⁸ (neni 34/a “Të drejtat e të pandehurit”), parashikon:

- personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë: a) të njoftohet në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave; b) të përdorë gjuhën që flet ose kupton ose të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një përkthyes dhe interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar; c) të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara; ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; d) të ketë një mbrojtës të siguar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në

fuqi për ndihmë juridike; dh) të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson; e) të këtë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen; ë) të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi; f) të paraqesë prova që i shërbejnë mbrojtjes së tij; g) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve të tjerë gjatë gjykimit; gj) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod;

- të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe.

65. KPP-ja (i ndryshuar) parashikon të drejtat e personit të arrestuar ose të ndaluar (neni 34/b). I arrestuari ose i ndaluari ka të drejtë: a) të takojë mbrojtësin e tij; b) të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij; c) të kërkojë që një anëtar i familjes ose një person tjetër i afërt të njoftohet menjëherë për arrestimin e tij. Në rast se i arrestuari ose i ndaluari është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet përfaqësia konsullore ose diplomatike e vendit të tij dhe në rast se është person pa shtetësi apo refugjat, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet një organizatë ndërkombëtare; ç) të marrë përkujdesjen e nevojshme mjekësore. Organi procedues e njofton menjëherë personin e arrestuar ose të ndaluar për të drejtat e parashikuara, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar. Personi ka të drejtë ta mbajë letrën e të drejtave.

66. KPP-ja i ndryshuar parashikon rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit. KPP-ja parashikon dispozita mbi: hetimet paraprake; kushtet e procedimit; veprimtaria me iniciativë e policisë gjyqësore; veprimtaria e prokurorit; sigurimi i provës; afatet e përfundimit të hetimeve.

67. E drejta e ankimit dhe të shqyrtimit të shpejtë dhe të paanshëm të çështjes së tyre: Kodi i Procedurës Penale parashikon dispozita mbi

⁴⁷ Me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.

⁴⁸ Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.



ankimet; rastet dhe mjetet e ankimit. E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht. Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre. Kodi parashikon:

- ankimin e prokurorit në gjykatën më të lartë, sipas rasteve të parashikuara nga ky Kod;

- ankimin e viktimës akuzuese vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, si për efekte penale, ashtu dhe për ato civile;

- ankimi i të pandehurit vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Kujdestari i të pandehurit mund të bëjë çdo ankim që i takon të pandehurit.

68. Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” (neni 109/3) parashikon të drejtat e personave të shoqëruar, si: njoftimi në gjuhën që ata kuptojnë për shkaqet e shoqërimit; njoftimi se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë, të drejtën që të mbahen të ambiente të përshtatshme dhe me kushte të ndryshme nga ambientet ku mbahen të ndaluarit/arrestuarit, të drejtën për të njoftuar një pjesëtar të familjes apo person tjetër, të drejtën për të komunikuar menjëherë me një person të besuar dhe avokatin. E drejta që t’i drejtohen gjykatës për ankesat/kërkesat që mund të kenë lidhur me shoqërimin, në çdo kohë. Rregullat dhe procedurat standarde të trajtimit të personave të ndaluar dhe të arrestuar në ambientet e policisë”, përfshijnë evidentimin dhe trajtimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në ambientet e Policisë së Shtetit.

69. Ligji nr. 81/2020 për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve parashikon se: Të burgosurit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Të burgosurit trajtohen në mënyrë të barabartë, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Neni 23. Familja

70. Kodi i Familjes⁴⁹ e parashikon martesën, si një bashkëjetesë ligjore, që mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë

të shtetit. Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës. Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirëritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose jashtë martese. Shteti dhe shoqëria duhet t’u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes.

71. Ndryshimet në vitin 2015 (neni 250 “Rishikimi i deklaramit të braktisjes së fëmijës”) parashikuan kuadrin e ri të lëshimit të deklaramit të braktisjes në disa institucione, duke synuar kështu lehtësimin e zgjidhjeve që duhen zbatuar brenda periudhave të arsyeshme kohore dhe masat e nevojshme mbrojtëse.

Neni 24. Të drejtat e fëmijës

72. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”⁵⁰ përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Ligji parashikon detyrat dhe forcon institucionet, strukturat dhe mekanizmat që do të garantojnë dhe do të sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve nga individët, familja dhe shteti. Ligji zgjeron horizontin e të drejtave të fëmijëve, ndërkohë që thekson forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, duke përfshirë edhe nivelin vendor në veçanti. Ligji parashikon ndërveprim ndërmjet shërbimeve për fëmijët dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale. Për herë të parë, parashikohet mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge apo që punojnë/shfrytëzohen për punë, adresimi i formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve, si bulizmi, dhuna në shkollë, në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik, siguria e fëmijëve në internet, fëmijët e pashoqëruar ose viktimat të trafikimit etj.

73. “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” (miratuar me ligjin nr. 37/2017)⁵¹ forcon sistemin e drejtësisë në përputhje me standarde dhe

⁴⁹ Ligji nr. 9062/2003 “Kodi i Familjes i RSH-së”.

⁵⁰ Hyrë në fuqi në qershor 2017.

⁵¹ Hyrë në fuqi më 1 janar 2018.



norma të tjera ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në kontakt me ligjin mbështetur në interesin e tyre më të lartë. Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018–2021” synon promovimin dhe mbrojtjen efektive të të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktimë, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për t’u ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore, kryesisht atyre penale, nëpërmjet zbatimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të drejtave të fëmijëve.

74. Neni 11, parashikon se: “Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit.

75. Në vitin 2017, u miratua Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020 (AKDF), e cila bazohet në tri shtylla strategjike: i) mirëqeverisja për promovimin, zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, me qëllim forcimin e kuadrit rregullator dhe institucional për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve; ii) eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve; dhe iii) sistemet dhe shërbimet e përshtatshme për fëmijët dhe adoleshentët, kryesisht zhvillimi dhe arsimi, drejtësia, shëndeti dhe ushqyerja, si dhe mbrojtja sociale. Agjenda është shumësektoriale dhe ndërsektoriale, dhe përfshin të gjitha planet e tjera të veprimit sektoriale lidhur me fëmijët.

Neni 25. E drejta e pjesëmarrjes; e drejta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur

76. Kodi Zgjedhor i ndryshuar⁵², në nenin 3 “Parime të përgjithshme”, parashikon garancitë

kushtetuese për të gjithë shtetasit shqiptarë të së drejtës për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur, duke përcaktuar:

- zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës;

- çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.”

77. Në nenin 63 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se: “Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.

- Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.

- Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie apo komune ose për këshillat vendore në KZAZ.

- Çdo shtetas shqiptar, me të drejtë vote, ka të drejtë të zgjidhet si kandidat i një partie politike, kandidat i një koalicioni partish politike apo i mbështetur nga një grup zgjedhësish.

78. Për zgjedhjet parlamentare të datës 25 prill 2021, KQZ-ja ka punuar për hartimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend.

Neni 26. Barazia para ligjit, mbrojtja kundër çdo lloj diskriminimi

79. Kodi i Procedurave Administrative parashikon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë,

⁵² Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjet nr. 74/2012, datë 19.7.2012, nr. 31/2015, datë 2.4.2015, nr. Faqe | 10086

101/2020, datë 23.7.2020, dhe nr. 118/2020, datë 5.10.2020.



gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.

80. Kodi Zgjedhor i ndryshuar, përcakton:

- zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës;

- çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeve politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.”

81. Ndryshimet e reja ligjore në ligjin nr. 124/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktojnë:

- forma të reja të diskriminimit, si: diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, gjuha e urrejtjes, veçimi, shqetësimi seksual;

- format e rënda të diskriminimit, të cilat meritojnë të ndëshkohen më rëndë dhe të parandalohen kudo ku shfaqen;

- rolin aktiv të organizatave me interesa legjitime duke u mundësuar atyre paraqitjen e ankesave pranë institucionit, ose mund të paraqesin informacion të besueshëm për nisjen e hetimeve kryesisht nga Komisioneri;

- detyrimin e autoriteteve publike për të promovuar barazinë dhe mosdiskriminimin;

- mundësinë e marrjes së ekspertëve kur shqyrtohet çështja në varësi të kompleksitetit të fushës ku po hetohet (mendim profesional). Ndryshimet sigurojnë gjithashtu, mundësinë e bashkimit të rasteve, për ekonomi procedurale, që vijnë nga subjekte të ndryshme, por që kanë të njëjtin objekt dhe i referohen të njëjtës sjellje diskriminuese të pretenduar;

- komisionerit KMD i është shtuar edhe një kompetencë e re, krahas monitorimit të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, siç

është monitorimi i zbatimit të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

82. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH-së” (neni 5 “Ushtrimi i të drejtave”), parashikon se: 1. Çdo person, që i përket një pakice kombëtare, ka të drejtën të zgjedhë lirisht që të trajtohet ose jo si i tillë, duke mos pasur asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që janë të lidhura me këtë zgjedhje. 2. Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, i ushtrojnë të drejtat dhe gëzojnë liritë e garantuara me këtë ligj, në mënyrë individuale dhe në komunitet me të tjerët, në të gjithë territorin e RSH-së.

83. Në nenin 8, të këtij ligji “Ndalimi i diskriminimit”, parashikohet se:

- ndalohet çdo diskriminim ndaj cilido personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare;

- institucionet publike, qendrore dhe vendore, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme:

- a) për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës;

- b) për të mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional;

- c) për të forcuar dialogun ndërkulturor;

- ç) për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional;

- masat e miratuara në përputhje me pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë akte diskriminimi.

Barra e provës

84. Kodi i Punës, i ndryshuar, (2015) detyron punëdhënësit/punëdhënëset për marrjen e masave për parandalimin e ngacmimit seksual dhe shqetësimeve me natyrë seksuale, si dhe penalizimit të viktimës për shkak të raportimit për incidentet e dhunës në vendin e punës. Në rastin e diskriminimit për arsye të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, punëdhënësi/punëdhënësjja detyrohet të provojë se nuk ka bërë shkelje të parimit të trajtimit të



barabartë. Në rastin e ngacmimit seksual, ligji e kalon barrën e provës te punëdhënësi/punëdhënësjë ose personi që pretendohet të ketë bërë ngacmimin.

85. Kodi i Procedurave Administrative (2016) parashikon se në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj (neni 82/2).

86. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi i ndryshuar, miratuar më 15 tetor 2020, përcakton se “Në rastet kur pala ankuese paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim” (neni 33, pika 7/1).

Neni 27. Të drejtat e pakicave kombëtare

87. Ligji nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” parashikon garancitë ligjore garantimin e të drejtave të pakicave kombëtare si (të drejta individuale), të drejtat dhe liritë themelore, si drejtat civile, politike, sociale etj., që Kushtetuta dhe kuadri ligjor dhe nënligjor sipas fushave parashikojnë për të gjithë shtetasit shqiptarë. Garantimi i të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare bazohet në kriteret e përcaktuara nga konventat ndërkombëtare: kriteret objektive, të cilat kanë të bëjnë me ekzistencën e karakteristikave etnike, kulturore, fetare, gjuhësore të veçanta dhe të qëndrueshme, nga pjesa tjetër e popullsisë të këtij grupi, shfaqjen e vullnetit për të ruajtur kulturën, traditat, fenë, gjuhën e tyre, si dhe kriterin që nënkupton zgjedhjen personale për të qenë ose jo pjesë-pjesë e pakicës kombëtare. Ligji nr. 96/2017 plotëson kuadrin ligjor dhe institucional për pakicat kombëtare në Shqipëri, si dhe shërben për qartësimin e politikave ndaj pakicave, duke adresuar rekomandimet e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër.

88. Ligji nr. 96/2017 adreson një sërë çështjesh që lidhen me: përkufizimin, kriteret ligjore të njohjes, shmangien e dallimeve midis

pakicave kombëtare dhe atyre etno-gjuhësore, si dhe përmban parashikime ligjore për garantimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe mekanizmat e përfaqësimit. Ky ligj parashikon përkufizimin e një pakice kombëtare, duke eliminuar diferencimin e dy kategorive të pakicave (pakicave kombëtare dhe etnike-gjuhësore) dhe njohjen formale të pakicave si pakica kombëtare. Për qëllimet e këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë: pakica greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

89. Garantimi i të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare bazohet në kriteret e përcaktuara nga konventat ndërkombëtare: kriteret objektive lidhur me ekzistencën e karakteristikave etnike, kulturore, fetare, gjuhësore të veçanta dhe të qëndrueshme, nga pjesa tjetër e popullsisë të këtij grupi, shfaqjen e vullnetit për të ruajtur kulturën, traditat, fenë, gjuhën e tyre, si dhe kriterin që nënkupton zgjedhjen personale për të qenë ose jo pjesë e pakicës kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është pandashmërisht e lidhur me kriterin objektiv të identitetit të personit dhe nuk nënkupton thjesht një të drejtë për një individ që të zgjedhë arbitrarisht që t'i përkasë një pakice kombëtare.

90. Ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij synojnë të garantojnë gëzimin dhe ushtrimin e plotë të së drejtave individuale të personave që i përkasin pakicave kombëtare, për të mbrojtur identitetin e veçantë të pakicave kombëtare, mosdiskriminimin dhe barazinë para ligjit. Kuadri ligjor dhe nënligjor bën të mundur marrjen e masave konkrete për të mbrojtur të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare, si: e drejta për të shprehur lirisht përkatësinë e tyre, për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre, elemente të veçanta që karakterizojnë jetën e komunitetit të tyre, mësimin e gjuhës amtare, veprimtarinë kulturore, ushtrimin e kultit fetar etj.

91. Nxjerrja e akteve nënligjore për pakicat bazohet në dispozitat e ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH-së” dhe detyrimet që rrjedhin nga Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”. Ky ligj dhe kuadri nënligjor në zbatim të tij parashikojnë dispozita për zbatimin



e të drejtave specifike të pakicave kombëtare: vetë-identifikimi, mosdiskriminimi, të drejtat arsimore, kulturore, ruajtja dhe zhvillimi i identitetit të tyre, përfaqësimi në jetën ekonomike, sociale, publike etj., krijimin e kushteve dhe mundësive për ushtrimin e të drejtave specifike lidhur me përdorimin e gjuhës së pakicave në marrëdhëniet me autoritetet, përdorimin e emrave, mbiemrave, treguesit topografikë në gjuhën e pakicave kombëtare, mekanizmin institucional për përfaqësimin e pakicave dhe forcimin e rolit dhe kompetencave të Komitetit Shtetëror të Pakicave Kombëtare; Krijimin e Fondit për Pakicat Kombëtare për mbështetjen e nismave dhe projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar të pakicave kombëtare. Miratimi akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji veçanërisht për sa i takon mbledhjes së të dhënave, arsimit, përdorimit të gjuhës në marrëdhëniet me autoritetet administrative, bazohet në kriteret objektive dhe kriterin subjektiv (parimi i vetë-identifikimit), siç parashikohet edhe nga ligji nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare dhe kriteret e parashikuara nga Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është e lidhur me kriterin objektiv përkatës të identitetit të personit (neni 3 i Konventës Kuadër).

92. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, gjatë periudhës 2018 – dhjetor 2020 janë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore të paketës së akteve nënligjore (8 akte nënligjore nga 12 të parashikuara), katër vendime në fushën e arsimit, dy vendime mbi pjesëmarrjen në jetën publike, sociale, kulturore, dy vendime mbi krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare⁵³, konkretisht:

- VKM nr. 561, datë 29.9.2018, “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të

mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”;

- VKM nr. 562, datë 29.9.2018, “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”;

- VKM nr. 726, datë 12.12.2018, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare”;

- VKM nr. 227, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”;

- VKM nr. 286, datë 10.5.2019, “Për miratimin e procedurave të zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Pakicave Kombëtare”;

- VKM nr. 462, datë 3.7.2019, “Për miratimin e masave dhe të politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Republikën e Shqipërisë”;

- VKM nr. 463, datë 3.7.2019, “Mbi përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre;

- VKM nr. 1155, datë 24.12.2020, “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”.

93. Aktualisht janë në proces hartimi dhe konsultimi përfundimtar 4 projektvendime (Komiteti *ad hoc* për njohjen e pakicave, përdorimi i gjuhës në marrëdhëniet me autoritetet vendore, mbledhja e të dhënave dhe miratimi i Fondit të Pakicave Kombëtare), konkretisht:

- projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen

⁵³ Informacion i detajuar mbi përmbajtjen e akteve nënligjore jepet në vijim, në pjesën e tretë të Raportit dhe anekset.



e pakicës kombëtare (pakicave të reja, krahas pakicave të njohura me ligjin nr. 96/2017)”;

- projektvendimi “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”;

- projektvendimi “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen/ verifikimin e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare”. Ky projektvendim ka si qëllim garantimin e parimit të vetidentifikimit të personave, që u përkasin pakicave dhe verifikimi i të dhënave mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare, lidhet me kriteret objektive të identitetit të pakicave kombëtare dhe shërben për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga ligji;

- projektvendimi “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e “Fondit për Pakicat Kombëtare”.

94. Në datën 26 nëntor 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 140/2020, “Për censin e popullsisë dhe banesave”. Bazuar në ligjin nr. 140/2020, të miratuar në muajin nëntor 2020, censi do të organizohet dhe kryhet nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Censit dhe me mbështetjen e Komisioneve të Censit që do të ngrihen në çdo Bashki të vendit. Në këtë ligj është përfshirë specifikisht parimi i vetidentifikimit të lirë të përkatësisë etnike, në përputhje me nenin 3, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, rekomandimet e organeve monitoruese të Këshillit të Evropës dhe rekomandimet në kuadrin e dialogut me Bashkimin Evropian.

II. MASAT PËR ZBATIMIN E GJETJEVE DHE REKOMANDIMEVE TË KOMITETIT HRC, SIPAS NENEVE TË PAKTIT ICCPR

Neni 2

Rekomandimi 6. Burime të nevojshme për funksionimin e Avokatit të Popullit

95. Institucioni i Avokatit të Popullit (AP) në përputhje standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm, ka një mandat i gjerë si institucion kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. AP mbështetet financiarisht nga buxheti i shtetit, por nevojitet edhe mbështetje në një masë të përshtatshme që t'i mundësojë realizimin në mënyrë të plotë të mandatit të tij kushtetues. Për këtë arsye, në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar nga institucionet përkatëse, rritja e buxhetit të institucionit përmes një infrastrukture njerëzore dhe financiare që të mundësojë realizimin e objektivave të tij. Rritja e mbështetjes financiare, lidhet me: misionin e tij si një institucion kombëtar në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut; mandatin e gjerë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, si një institucion kombëtar, i cili gëzon dhe statusin “A”.

Nenet 2, 3 dhe 26

Rekomandimi 7/a. Përfaqësimi i grave në Kuvend, qeverisje dhe administratën publike

96. Kuvendi i Shqipërisë i dalë nga zgjedhjet e 25 Qershorit 2017, ka numrin më të madh të grave deputete në 28 vitet e fundit. Gratë përfaqësohen në Kuvend me 41 deputete nga 140 në total ose 29.3%. Në legjislaturën 2013–2017 përfaqësimi i grave deputete ishte 23,5%.

97. Aktualisht, Kabineti Qeveritar ka 8 gra ministre nga 14 gjithsej ose 57% të tij, duke qenë një nga shtetet evropiane me një përfaqësim të lartë gjinor në qeverisjen qendrore. Kabineti Qeveritar i vitit 2013 kishte 8 ministre nga 18 ministra ose 42%)⁵⁴.

98. Në zgjedhjet vendore të qershorit 2015 rezultonin 9 gra (14.7%) të zgjedhura si kryetare bashkie (nga 61 bashki gjithsej), si dhe një rritje e përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë në

⁵⁴ Raporti i Monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e saj të Veprimit 2016–2020, janar–dhjetor 2018, përgatitur nga MSHMS-ja.



masën 34%, (krahasuar me 12% që ishte në zgjedhjet vendore të vitit 2011)⁵⁵. Sipas vlerësimit të bërë nga INSTAT-i në dhjetor 2017, përqindja e grave ndërmjet këshilltarëve të bashkive është 36,9%⁵⁶.

99. Numri i grave kryetare të bashkive në nivelin vendor pas zgjedhjeve të qershorit 2019 është 8 nga 61 bashki ose 13.1% (më 2015 përqindja e grave kryetare ishte 15%). Sipas raportit të OSBE–ODIHR-it, 44% e vendeve në këshillat bashkiakë u fituan nga gratë, nga 35% e numrit të grave në këshillat bashkiakë pas zgjedhjeve të vitit 2015.

100. Në ushtrimin e kontrollit parlamentar, ka pasur zhvillime për ngritjen e një Komisioni Parlamentar si Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas (në vitin 2017), për të monitoruar legjislacionin për barazinë gjinore dhe rishikimin e rregullave dhe procedurave parlamentare, për të rritur pjesëmarrjen e grave; mekanizmat e monitorimit, kontrollit dhe llogaridhënies; mbledhjen, analizimin dhe raportimin e thjeshtuar të të dhënave, mbështetjen e këshilltarëve/eve të zgjedhur/a në nivel vendor; krijimin e aleancave vendore e aleancës kombëtare, ngritjes së kapaciteteve dhe rrjetëzimit. etj. Programi i veprimit “Për një Kuvend me Ndjeshmëri Gjinore”, ka pasur fokusin te kuadri ligjor, përfaqësimi gjinor, organet e barazisë gjinore, planifikimet strategjike me ndjeshmëri gjinore etj.

101. Të dhëna mbi përfaqësimin e grave:

- 15% e grave/vajzave në Forcat e Armatosura, nga të cilat 13.08% personel ushtarak në Forcat e Armatosura, 16% në përfaqësitë ushtarake jashtë vendit dhe 4% në misionet ushtarake/paqeruajtëse;

- 14.2% e grave/vajzave në Policinë e Shtetit, nga të cilat 9.7% janë: punonjëse policie, 0% drejtues madhor, 20% drejtues i lartë, 0% drejtues i parë, 8% drejtues.

102. Të dhëna mbi përfaqësimin e grave në shërbimin e jashtëm (viti 2020).

Në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, janë të punësuar 113 gra në raport me numrin total 190, rreth 59%.

- Në Përfaqësitë diplomatike aktualisht janë 76 gra dhe vajza diplomate, në raport me numrin total të stafit diplomatik prej 155, rreth 49%.

- Në poste drejtuese në ministri aktualisht janë 31 gra në raport me numrin total prej 62 gra, rreth 50%.

- Në poste drejtuese në ambasada dhe misionet e përhershme aktualisht janë 15 gra ose 29% në raport me numrin total prej 51 përfaqësi diplomatike. Ambasadorja pranë Misionit të RSH-së në BE është grua, janë 3 ambasadore pranë Misioneve të Përhershme, pranë organizatave ndërkombëtare (Nju-Jork, Gjenevë, Strasburg) dhe 13 ambasadore në ambasadat e RSH-së.

103. Menaxhimi i shërbimit civil bazohet në ligjin e shërbimit civil nr. 152/2013 dhe mbi parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe neutralitetit politik, që garanton stabilitetin e nëpunësve civilë dhe vazhdimësinë e shërbimit civil. Në ligjin për barazinë gjinore nr. 9970/2008 përcaktohet përfaqësimi i secilës gjini, jo më pak se 30% të institucionit në nivelin e lartë të menaxhimit, organit të caktuar dhe partisë politike. Të dhënat statistikore për treguesin “Përqindja e grave të punësuar në shërbimin civil, në nivelin e lartë të drejtimit:

Viti	Përqindja/femra
01.2020 – 08.2020	40.3%
2019	41.3%
2018	44.2%
2017	40%
2016	38.8%
2015	34.8%
2014	41.3%

104. Trendi pozitiv në respektimin e balancës gjinore të të emëruarve në shërbimin civil vihet re, jo vetëm në emërimet e drejtuesve të lartë, por edhe për të gjitha pozitat në shërbimin civil (ekzekutiv, menaxhim i ulët, menaxhim i mesëm, menaxhim i lartë). Tabela e mëposhtme paraqet përqindjen e grave të emëruara, sipas pozicioneve, sipas viteve:

⁵⁵ Raporti i Monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e saj të Veprimit 2016–2020, janar–dhjetor 2015, përgatitur nga MSHMS-ja.

⁵⁶ INSTAT-i “Burrrat dhe gratë në Shqipëri, 2018”.



Viti	Përqindja/ femra
2019	49%
2018	54%
2017	58%
2016	60%
2015	56.4%
2014	60%

Rekomandimi 7/b. Pagë e barabartë për punë të barabartë

105. Me ndryshimet në Kodin e Punës në vitin 2015⁵⁷, përcaktohen disa elementë të rëndësishëm mbi sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve, ndalimin e diskriminimit, marrëdhëniet e punës, si dhe mbrojtjen e veçantë të grave. Disa nga parashikimet me ndikim të drejtpërdrejtë mbi gratë janë: përmirësimi i konceptit të shqetësimit seksual në vendin e punës; barra e provës; garanci shtesë për të siguruar rikthimin në punë të gruas pas mbarimit të lejes së lindjes. Këto ndryshime parashikojnë mosdiskriminim në shpërblim të barabartë për meshkujt dhe femrat.

106. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) dhe plani i saj i veprimit 2014–2020 (rishikuar deri në vitin 2022), duke parashikuar edhe prioritetet strategjike. U rishikuan treguesit deri në vitin 2022, të cilët bazohen në një bazë të dhënash, në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT-in. Treguesit e shërbimeve të monitorimit dhe programet e ofruara nga Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) përfshijnë tregues të barazisë gjinore, të pasqyruar në programin statistikor. Treguesit në sistemin e informacionit në tregun e punës, të bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Shërbimit të Punësimit, përmbajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë.

107. Paga mesatare bruto për një të punësuar sipas gjinisë, ndër vite ka pësuar ndryshime. INSTAT-i prej vitit 2017 kryen analizën e hendeut në paga (*Pay Gap*). Referuar botimit “Burrat dhe gratë në Shqipëri 2018”, INSTAT-i rezulton se për vitin 2017 hendeu gjinor në pjesëmarrjen në forcat e punës është 18,1% krahasuar me 17,8% në vitin 2016. Hendeu gjinor (HGJ) në paga për vitin 2017 ishte 10,5% nga 6,3% në vitin 2016. Sipas INSTAT-it për

vitin 2020⁵⁸, krahasuar me vitin 2018, paga mesatare mujore bruto u rrit me 3,5%. HGJ-ja në paga është 10,1%. Pra, burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 10,1% më të lartë sesa gratë. Krahasuar me vitin 2018, në vitin 2019 vihet re një ulje e hendeut gjinor në paga me 0,6 pikë përqindje. Në këtë vit, sektori ekonomik, në të cilin hendeu gjinor në paga është më i lartë, është sektori i prodhimit, ku vlera arrin në 24,6%. Ndërsa sektori ekonomik ku HGJ arrin vlerën më të ulët, prej 0,7%, është sektori i ndërtimit. Sipas grup profesioneve kryesore, hendeu gjinor në paga (HGJ) arrin vlerën më të lartë për zejtarët, dhe punonjësit e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me 24,2%. Vlerën më të ulët HGJ-ja e arrin për Forcat e Armatosura, me 3,0%, pra burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 3,0% më të lartë sesa gratë.

Nenet 2, 26. Rekomandimi 8. Steriotipat dhe paragjykimet, LGBTI

108. Plani Kombëtar i Veprimit Personat LGBTI 2016–2020 u miratua në maj 2016⁵⁹. Objektivat e këtij Plani janë: 1) Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe rritja e ndërgjegjësimit për mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI, në përputhje me standardet ndërkombëtare. 2) Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit ndaj komunitetit LGBTI. 3) Përmirësimi i aksesit në shërbimet e punësimit, edukimit, shëndetësisë, strehimit dhe sporteve për personat LGBTI, duke garantuar mundësi dhe të drejta të barabarta.

109. Me urdhrin e Kryeministrit nr. 147, datë 28.9.2016, u ngrit Grupit Kombëtar për Zbatim dhe Koordinimit (GKZK), të Planit Kombëtar LGBTI, për të vlerësuar kuadrin ligjor, për të siguruar ndërtimin e kapaciteteve për punonjësit gjinorë dhe nëpunësit civilë, si dhe konsultimet me aktorët e interesuar.

110. Aktivitete ndërgjegjëse:

- Ngritja e kapaciteteve të punonjësve civilë mbi të drejtat e komunitetit LGBTI dhe mbrojtjen e tyre ligjore.

⁵⁸

<http://www.instat.gov.al/media/7376/burrat-dhe-gra-2020.pdf>

⁵⁹ VKM nr. 390, datë 25.5.2016, “Për një shtesë në VKM nr. 87, datë 3.2.2016 ‘Për miratimin e Dokumentit të Përfshirjes Sociale’”.

⁵⁷ Ligji nr. 136, datë 5.12.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, ‘Kodi i Punës i RSH-së’, i ndryshuar”.



- Janë zhvilluar një sërë trajnimesh mbi: shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor nga perspektiva e të drejtave të njeriut të fokusuara në komunitetin LGBTI.

- Në zbatim të projektit “*Horizontal Facility*”, të Këshillit të Evropës janë zhvilluar trajnimet nëpunësve gjinorë pranë njësive të qeverisjes vendore, mbi ndërgjegjësimin për të drejtat e këtij komuniteti.

- Ndërgjegjësimi i publikut nëpërmjet fushatave të përvitshme në kuadër të Ditës së Homofobisë po synon gjithmonë e më shumë ta bëjë diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes të papranueshme.

- Institucionet shtetërore, në bashkëpunim me OJF-të e fushës dhe Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur nga donatorët dhe ambasadat realizojnë tashmë çdo vit aktivitete, të cilat kanë marrë dhe vëmendjen e publikut, si dhe pasqyrimin gjerësisht në media.

111. Qendra e parë rezidenciale në Shqipëri “Streha” ofron strehim të sigurt dhe integrim. “Streha” nisi aktivitetet e saj, që prej dhjetorit të 2014-s. Qendra “Streha” është një shërbim për të rinjtë LGBTI, që përballen me dhunë, diskriminim dhe nevojë për strehim për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor. Ofron një paketë të plotë shërbimesh, sipas “Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore”, licencuar që prej vitit 2016. Qendra, filloi të financohet nga Fondi Social, për herë të parë në maj 2019, nëpërmjet fondeve të buxhetit të shtetit.

112. Që prej muajit maj 2018, linja ALO 116-111, ofron shërbimin e telefonisë falas për adoleshentët LGBTI, për këshillimin dhe denoncimin e të gjitha rasteve të dhunës në shkollë apo në familje, nëpërmjet Linjës Kombëtare për Adoloshentët LGBTI. Edhe kjo linjë po financohet nga MSHMS-ja prej vitit 2019.

Nenet 2, 6, 12, 24. Rekomandimi 10. Parandalimi dhe lufta ndaj gjakmarrjes

- 113. Me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, janë bërë ndryshime në Kodin Penal duke cilësuar vrasjet për hakmarrje dhe vrasjet për gjakmarrje:

- Nenin 78 “Vrasja me paramendim”: “Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet, vrasja e

kryer për interes apo hakmarrje dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm”.

- Neni 78/a “Vrasja për gjakmarrje”: “Vrasja me dashje për gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm”.

114. Prej vitit 2012, është hartuar Plani i Veprimit “Për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale ndaj veprave penale të vrasjeve të kryera për motive të gjakmarrjes dhe hakmarrjes”, i cili është përmirësuar në vitet 2014 dhe 2018⁶⁰. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Shtetit, është ngritur Shtabi i drejtimit kundër krimeve me motive hakmarrje dhe gjakmarrje, i cili ka për detyrë të drejtë, kontrollojë, koordinojë veprimtarinë e strukturave vartëse për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të krimit të vrasjes të kryer për hakmarrje apo gjakmarrje.

115. Objektivat e këtij Plani Veprimi:

- goditja e fenomenit të gjakmarrjes dhe hakmarrjes duke bashkëpunuar ngushtë me pushtetin vendor dhe organizatat jofitimprurëse për zgjidhjen me pajtim të konflikteve;

- forcimi i bashkëpunimit me organin e prokurorisë për hetimin e shpejtë të këtyre veprave penale dhe vënien para drejtësisë të autorëve të tyre;

- organizimi i masave të gjithanshme për kapjen e autorëve të vrasjeve në tërësi dhe të atyre për gjakmarrje në veçanti si një masë e madhe parandaluese për vazhdimin e gjakmarrjes;

- forcimi i bashkëpunimit me njësitet përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare, për edukimin e brezit të ri me frymën e tolerancës dhe parandalimin e krimit.

116. Të dhënat statistikore të administruara nga strukturat e Policisë së Shtetit, për veprën penale “Vrasja për gjakmarrje”, parashikuar nga neni 78/a, i Kodit Penal:

⁶⁰ Plani nr. 1277 datë 24.10.2012, “Për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale ndaj veprave penale të vrasjeve të kryera për motive të gjakmarrjes dhe hakmarrjes”, i ndryshuar me Planin e Veprimit nr. 419, datë 31.3.2014, dhe planin e veprimit nr. 2057, datë 19.12.2018.



Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Numri i rasteve	7	3	4	0	1	1	1	0	1

117. Nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit, gjatë periudhës 2013 – 2020, janë organizuar në vazhdimësi takime sensibilizuese në lidhje me fenomenin e gjakmarrjes, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga pushteti vendor, si dhe OJF të ndryshme. Është krijuar një bazë të dhënash për regjistrimin e të gjitha familjeve të prekura nga fenomeni i gjakmarrjes, si dhe janë hartuar Procedurat Standarde të Punës “Për evidentimin e regjistrimin në bazën e të dhënave të personave të përfshirë në veprave penale me motiv gjakmarrjen”.

118. Referuar të dhënave të administruara nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit, rezulton se, aktualisht në vendin tonë ka 75 familje me 159 persona të ngjuar (me vetëkufizim liric), nga të cilët 25 janë fëmijë. Nga këto 15 familje me 56 persona janë larguar jashtë shtetit.

119. Në vitin 2013 u miratua nga ministri i Arsimit dhe Shkencës udhëzimi nr. 36, datë 13.8.2013, “Për procedurat për arsimimin e fëmijëve të ngjuar”, ku parashikohen në mënyrë të detajuar, procedurat që ndiqen për të realizuar të drejtën e arsimit për fëmijët e ngjuar, planin mësimor dhe programet lëndore që përdoren për këta fëmijë, kohëzgjatja e mësimin, procedurat që ndjekin mësuesit që angazhohen në mësimin e tyre, sigurimin e shërbimit psikosocial për këta fëmijë etj.

Rekomandimi 11. Parandalimi dhe dhuna ndaj grave – nenet 3, 7 dhe 24

120. Ligji nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikon forcimin e masave mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave, përmes lëshimit të urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet. Për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesë ose bashkëjetesë. Ligji u ndryshua edhe në tetor 2020, duke saktësuar masat për largimin e dhunuesit nga banesa dhe kthimin me mbarimin e afatit të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të

menjëhershme të mbrojtjes UM/UMM, programet specifike të rehabilitimit për dhunuesin, regjistrin e UMM/UM-ve etj.

121. Ndryshimet dhe shtesat e vazhdueshme në Kodin Penal⁶¹ e parashikojnë dhunën në familje si vepër penale me sanksionet përkatëse (neni 130/a)⁶²:

- Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, psikologjike, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt, krushqi e afërt ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet.

- Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet.

- Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim deri në pesë vjet.

- Gjithashtu është cilësuar se në rast se këto vepra do të kryhen në mënyrë të përsëritur ose në praninë e fëmijëve, dënimi ashpërsohet nga një deri në pesë vjet burgim.

122. Në vitin 2013, u ndryshua neni 102 “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”: neni 102: Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura: Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për

⁶¹ Në vitet 2012, 2013 dhe 2020.

⁶² Informacion i detajuar jepet në vijim.



shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

123. Institucioni i prokurorisë ka synuar në vazhdimësi të sigurojë qasje dhe mbështetje të viktimave, veçanërisht ato të dhunës seksuale, trafikimit apo dhunës në familje. Në muajin janar 2016, në Prokurorinë e Përgjithshme u krijua Zyra e Ndhmësit të Viktimave e parashikuar dhe në ligjin nr. 97/2016, “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSH-së”. Në këtë ligj (neni 68) është parashikuar detyrimi i prokurorisë për të garantuar shërbime të nevojshme për trajtimin e subjekteve që gëzojnë status të posaçëm, sipas kodit të procedurës penale dhe për këtë në çdo prokurori duhet të ketë në përbërje të saj të paktën një koordinator të diplomuar në psikologji, sociologji ose fusha të tjera të posaçme.

124. Aktualisht, në zbatim të këtij ligji në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme ushtrojnë funksionet koordinatorët e viktimave, të cilëve pas marrjes së detyrës iu siguroa edhe trajnimi fillestar. Nga ana tjetër, në përputhje dhe në zbatim të parashikimeve ligjore, Prokurori i Përgjithshëm me datë 25.10.2018 ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm, nr. 5/2018 që synon të sigurojë kuptimin dhe zbatimin në mënyrë të unifikuar të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që lidhen me viktimat e veprave penale dhe nga ana tjetër të përcaktojnë politikat e prokurorisë në lidhje me trajnimet e tyre. Udhëzimi shoqërohet edhe nga disa shtojca që janë modele të unifikuara aktesh të nevojshme në zbatim të udhëzimit dhe punës së prokurorëve. Po kështu u miratua edhe një broshurë informative për viktimat e krimit, që është shpërndarë në prokuroritë e shkallës së parë dhe është publikuar dhe në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

125. Ligj nr. 47, datë 23.7.2018⁶³, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, ‘Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’, të ndryshuar”, synon:

- parandalimin dhe reduktimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;

- përmirësimin e masave mbrojtëse të parashikuara në ligj në kuadrin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrit të mbrojtjes, duke pasur parasysh sidomos përmirësimin e masave mbrojtëse për fëmijët;

- rritjen e ndihmës së kualifikuar gjyqësore falas;

- përcaktimi i afateve të qarta procedurale, për regjistrimin e kërkesës për urdhër mbrojtje (UM) dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM), si dhe për ankimet ndaj vendimeve gjyqësore;

- përcaktimi më i qartë i organeve përgjegjëse për kryerjen e detyrave dhe i përgjegjësisë së zyrtarëve;

- parashikimi shprehimisht i detyrimit të organeve shtetërore për të ofruar falas, çdo shërbim ekspertize për rastet e dhunës në familje;

- rritja e pjesëmarrjes së dhunuesve në shërbimet specifike të rehabilitimit me fokus të veçantë dhunuesit e alkoolizuar, droguar ose me çrregullime të shëndetit mendor, të dhëna qartësisht në vendimet e gjykatave për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.

126. Në zbatim të ligjit nr. 47, janë miratuar:

- udhëzimi nr. 816, datë 27.11.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”;

- dokumenti i standardeve të shërbimit për “Qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”, me fokus kryesor shërbimin emergjent, me një ndalesë, në mënyrë të integruar, 24/7 dhe afatshkurtër (24 orë deri në 72 orë), për viktimat/ të mbijetuarit/rat e dhunës seksuale, si dhe për anëtarët e tjerë të familjeve të tyre, u përgatit me qëllim funksionimin sa më eficient të këtyre qendrave;

- udhëzimi i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Brendshëm nr. 912, datë 27.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”;

- udhëzimi i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Brendshëm nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”.

127. Mekanizmat e koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje ofrojnë qasje të

⁶³ Hyrë në fuqi, më 18.8.2018.



integruar të shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës dhe siguron mbrojtje dhe mbështetje për to në nivel vendor dhe shtrirje të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe ngritjes së shërbimeve të reja specifike. Nën koordinimin e MSHMS-së dhe me mbështetjen e UNDP-së, janë ngritur dhe funksionojnë 57 mekanizma të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje, nga 61 bashki të vendit. Ka vazhduar ngritja e kapaciteteve të koordinatorëve vendore kundër dhunës në familje dhe të ekipeve teknike multidisiplinare.

128. Qeveria mbështet një strehëz të specializuar kombëtare, si dhe mbështet tri strehëza të specializuara të drejtuara nga OJF-të. Qendrat që trajtojnë viktimat e trafikimit ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit VT/VMT, të huaj ose vendas, fëmijë, burra ose gra. Këto strehëza kanë trajnuar stafin për të siguruar sigurinë e viktimave. Qendra Kombëtare e Pritjes për Viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit ofron një gamë të gjerë ndihme, si veshje ushqimore, ndihmë mjekësore, ndihmë juridike, ndihmë psikologjike, kujdes shëndetësor, rehabilitim dhe programe profesionale. Shërbimi është 24 orë në ditë dhe vendoset në një strukturë të lartë sigurie. Mbrojtja sociale sigurohet bashkërisht nga objektet shtetërore dhe institucionet joqeveritare të cilat mbulojnë një gamë më të gjerë të nevojave dhe balancojnë kapacitetet e njëri-tjetrit.

129. Qendra për menaxhimin e krizës të rasteve të dhunës seksuale “Lilium” u inagurua në 3 dhjetor 2018, në ambientet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë, plotësisht me fonde të buxhetit të shtetit. Qendra është e para në Shqipëri, që ofron modelin socio-shëndetësor, me një ekip multidisiplinar, me mjekë ligjorë, gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, punonjës të policisë, prokurorisë, avokatë dhe infermierë, të cilët do të japin shërbim të specializuar sipas standardeve 24 orë çdo ditë të javës. Është një shërbim afatshkurtër 24–72 orë, shërbim i integruar për të gjithë, pavarësisht moshës, gjinisë, etnisë, racës, orientimit seksual apo aftësisë së kufizuar. Janë trajtuar në këtë qendër 58 persona. Janë organizuar fushatat e ndërgjegjësimit kundër dhunës ndaj grave. Funksionon Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116–117, prej vitit 2017.

Rekomandimi 12. Nenet 2, 7 dhe 10. Ndalimi i torturës dhe keqtrajtimit. Penalizimi në Kodin Penal. Raste të hetimit dhe dënimeve. Trajnimet për personelin ligjzbatues; hetimi, dënimi i autorëve dhe kompensimi i viktimave.

130. Policia e Shtetit në vazhdimësi ka marrë masa për ndalimin e torturës, keqtrajtimit, që mund të shkaktohen nga personeli policor gjatë veprimeve që kryhen me personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në ambientet e policisë, si dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore vetëm në bazë të ligjit duke respektuar të drejtat e njeriut.

131. Për këtë qëllim janë përgatitur dhe dërguar për njohje dhe zbatim gjithë strukturave të Policisë së Shtetit (qendrore dhe vendore) urdhra, letërporosi, tërheqje vëmendje/qarkore, përshtime, përgjithësime të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe drejtorëve të departamenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si:

- tërheqje vëmendje nr. 972, datë 5.2.2014, “Për zbatimin me përpikëri të akteve ligjore, nënligjore dhe procedurave standarde të punës lidhur me arrestimin/ndalimin, kontrollin fizik dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar”;

- tërheqje vëmendje nr. 1947, datë 12.3.2014, “Për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive në përputhje të plotë me aktet ligjore, nënligjore dhe procedurat standarde të punës, duke respektuar e garantuar të drejtat e personave të privuar nga liria”;

- tërheqje vëmendje e DPPSH-së me nr. 4577/1, datë 10.9.2014, “Për shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e Policisë së Shtetit”;

- qarkore mbi ligjin nr. 108/2014 dhe zbatimin e kërkesave të neneve 109, 112, të ligjit për shoqërimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, evidentimin e të dhënave në regjistrat përkatës;

- tërheqje vëmendje nr. 4963, datë 5.8.2015, “Për kryerjen e detyrave dhe të përgjegjësive policore vetëm në bazë të ligjit duke respektuar të drejtat e njeriut”;

- tërheqje vëmendje nr. 2687, datë 10.6.2016, “Mbi përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësive ligjore të policisë, për marrjen dhe trajtimin e kallëzimeve të shtetasve dhe trajtimin e të shoqëruarve”;

- tërheqje vëmendje nr. 4678/1, datë 8.8.2016, “Për një kuptim dhe zbatim sa më të drejtë të



rregullave dhe masave të sigurisë për të arrestuarit që trajtohen në institucionet mjekësore dhe për përdorimin e forcës gjatë arrestimeve”;

- letërporosi nr. 784, datë 18.8.2016, “Për parandalimin e ngjarjeve të rënda që mund të kryhen nga persona që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor”;

- tërheqje vëmendje nr. 3931, datë 19.5.2017, “Për eliminimin, parandalimin e keqtrajtmeve/dhunës fizike ndaj personave të privuar nga liria dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të punonjësve të policisë përgjegjës”;

- tërheqje vëmendje (maj 2018) “Për zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde për regjistrimin dhe administrimin elektronik të të dhënave për personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar”;

- tërheqje vëmendje nr. 4353, datë 30.5.2018, “Mbi respektimin e të drejtave të personave gjatë shoqërimit, intervistimit dhe trajtimi i tyre në ambientet e policisë”;

- tërheqje vëmendje nr. 7213/1, 26.9.2018, “Për zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde që kanë të bëjnë me shoqërimin dhe trajtimin e të shoqëruarve në ambientet e policisë”;

- tërheqje vëmendje nr. 3582, datë 2.5.2019, “Për zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, në ambientet e njërive vendore të policisë”;

- tërheqje vëmendje e DPP-së së Shtetit nr. 5669/2, datë 15.8.2019, “Për respektimin e të drejtave të njeriut gjatë përdorimit të forcës në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisë ligjore nga Policia e Shtetit”;

- letërporosi nr. 5126, datë 15.8.2019, “Për respektimin e të drejtave të komuniteteve/pakicave kombëtare, parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve diskriminuese që cenojnë dinjtetin e tyre”;

- letërporosi e DPP-së së Shtetit nr. 6104/3, datë 2.9.2019, “Për njohjen e raportit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të CPT-së për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit”;

- letërporosi nr. 278/1, datë 15.1.2020, “Për zbatimin me korrektësi të ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, në veçanti të të drejtave të fëmijëve, gjatë kryerjes së veprimeve policore dhe

procedurale nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit”;

- tërheqje vëmendje nr. 1449/2, datë 2.3.2020, “Për zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde për sigurimin dhe trajtimin e të arrestuarve/ndaluarve dhe shoqëruarve në ambientet e njërive policore”.

132. Prokuroria e Përgjithshme, si organ i pavarur, trajton dhe ndjek me prioritet rastet e pretendimeve për torturë dhe keqtrajtime nga policët apo kryerjen e veprimeve arbitrare nga strukturat e tjera ligjzbatuese.

133. Për parandalimin e keqtrajtit në burgje, me urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve prej muajit maj të vitit 2019 është miratuar platforma për inspektimin e përgjithshëm të Institucioneve të ekzekutimeve të vendimeve penale. Nëpërmjet kësaj platforme udhëzohen institucionet, si edhe stafet e inspektimeve për kryerjen gjithëpërfshirëse të inspektimeve, si dhe duke pasur qëllim parësor vlerësimin e përmbushjes së standardeve të të drejtave dhe trajtimit të burgosurve, planifikimit dhe realizimit të objektivave të sigurisë dhe rehabilitimit, menaxhimit të burimeve njerëzore, trajnimit dhe motivimit të stafit.

134. Hetimet mbi keqtrajtimet nga personeli i burgjeve realizohen nga mekanizmat e brendshme të inspektimit, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje (SHKBB) – strukturë në varësi të ministrit të Drejtësisë, i cili bën hetime në rastet e shkeljes së ligjshmërisë dhe të ushtrimit të dhunës. Përveç mekanizmave të brendshme të inspektimit ku hetimet mbi keqtrajtimet nga personeli i burgjeve, pretendimet për keqtrajtim nga personeli i burgjeve verifikohen nga Avokati i Popullit përmes Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës, si dhe nga organizata të shoqërisë civile në vend. Rastet e pretenduara për keqtrajtim nga administrata e burgjeve adresohen pranë organit të Prokurorisë, i cili vendos për fillimin e hetimeve të mëtejshme për verifikimin e rastit/eve. Për periudhën 2014–korrik 2020 janë marrë dhe trajtuar 8091 ankesa/denoncime për punonjësit e strukturave, objekt i veprimtarisë së shërbimit për çështjet e brendshme dhe ankesat, ku rastet e denoncimeve/ankesave për keqtrajtim/ushtim dhune gjatë shoqërimit apo ndalimit/arrestimit në dhomat e paraburgimit në ambientet e strukturave



të Policisë së Shtetit zënë vetëm 1.6% të totalit (127 ankesa).

135. Sistemi i burgjeve monitorohet në mënyrë të vazhdueshme veçse nga instancat e prokurorisë dhe të shtetërore edhe nga institucione të pavarura, siç janë:

- Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT);
- Avokati i Popullit;
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit;
- Komisioneri kundër Diskriminimit.

136. Në secilin prej raporteve të këtyre organizmave është evidentuar progresi i kryer në sistemin e burgjeve në drejtim të zbatimit të kërkesave ligjore për të drejtat e trajtimit dhe të burgosurve, i cili konsiston në:

- ofrimin e aksesit të shpejtë në të gjitha institucionet e planifikuara për t'u vizituar nga Komiteti CPT, përfshirë edhe institucionet që nuk ishin njoftuar paraprakisht;
- aksesin për të zhvilluar intervista private me personat e privuar nga liria;
- aksesin në të gjithë informacionin e kërkuar.

137. Institucioni i Avokatit të Popullit, në kuadër të inspektimeve periodike në IEVP ka përcjellë raportet për konkluzionet e inspektimeve në secilën IEVP prej të cilëve evidenton progres krahasuar me raportin pararendës. Veç këtyre, Avokati i Popullit kryen edhe inspektime në distancë përmes kërimit të marrjes të të dhënave apo dhe vizitave në vend për raste të veçanta (mbi bazë të ankesave që Ju drejtohen atyre) apo për çështje në tërësi (si p.sh. marrja në analizë e rasteve të vdekjeve në burgje etj.). Gjithashtu, inspektime e verifikime janë kryer edhe nga Komisioneri kundër Diskriminimit. Edhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka ushtruar inspektime në vend e distancë (përmes kërkesës për të dhëna për raste të veçanta), si dhe ka pasur bashkëpunim me DPB-në. DPB-ja për çdo rekomandim nga këto institucione ka reaguar pozitivisht dhe në frymë bashkëpunimi duke dhënë sqarime, por edhe duke hartuar plane veprimi për përmirësime të vazhdueshme. Një strukturë përgjegjëse është caktuar me urdhër të drejtorit të përgjithshëm në DPB, për ndjekjen e realizimit të gjitha rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

138. Trajnimet e personelit ligjzbatues: në vazhdimësi janë zhvilluar trajnime të stafit policor lidhur me rregullat dhe procedurat standarde që kanë të bëjnë me mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e

dhomave të sigurisë të Policisë së Shtetit; respektimin dhe garantimin e të drejtave themelore të tyre, si: mbrojtja me avokat; ofrimi i shërbimit mjekësor; njohja me të drejtat e tyre; njoftimi i familjarëve për arrestimin/ndalimin dhe vendndodhjen e tyre; trajtimi ushqimor; kushtet dhe standardet e ambienteve ku mbahen e trajtohen kjo kategori personash; e drejta për të paraqitur kërkesë – ankesa për trajtimin që ju bëhet/sjelljen e qëndrimin e policisë etj. Sipas programeve vjetore të trajnimeve në Policinë e Shtetit, realizohen trajnime të specializuara në Akademinë e Sigurisë me punonjës të policisë të nivelit zbatues dhe drejtues të drejtorive vendore të Policisë.

139. Është miratuar dhe vënë në zbatim: “Manuali i rregullave dhe procedurave standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe ndaluar, në njësitë policore”, miratuar me urdhrin nr. 763, datë 27.9.2011, të drejtorit të Policisë së Shtetit. Pas rishikimit dhe riformatimit, me urdhrin nr. 440/3, datë 27.4.2017, të DPP-së së Shtetit, është miratuar procedura standarde: “Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Janë miratuar “Rregullat teknike të shoqërimit në polici” (me urdhrin nr. 308, datë 31.3.2016).

140. Në programet vjetore të trajnimeve të Policisë së Shtetit janë planifikuar trajnime në shërbim i punonjësve të policisë të strukturave vendore dhe trajnime të specializuara për nivelin zbatues dhe atë të parë të drejtimit, si: shërbimi i patrullës përgjithshme, shërbimi i policisë rrugore, ndihmësspecialistët e policimit në komunitet, punonjës të strukturave për krimet etj., lidhur me njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të individëve gjatë shoqërimit, ndalimit, arrestimit dhe trajtimit në ambientet e Policisë së Shtetit. Trajnime të specializuara, të zhvilluara për njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit dhe zbatimi i kërkesave të manualit nr. 763, datë 27.9.2011”.

141. Trajnimet lidhen me njohjen e akteve ndërkombëtare, Kushtetutën, Kodin e Procedurës Penale, ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, ligje të tjera, Manualin “Për trajtimin dhe sigurimin



e të arrestuarve/ndaluarve në dhomat e sigurisë të njësisë të policisë”; “Rregullat dhe procedurat standarde për hedhjen e administrimin e të dhënave për personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në sistemin ADAM”; “Përcaktimet ligjore për shoqërimin, rastet e shoqërimit, trajtimi i të shoqëruarve dhe përcaktimet e bëra në procedurën standarde të punës”. Trajnime me të gjithë personelin policor të strukturave vendore dhe qendrore të policisë lidhur me njohjen e kërkesave të rregullores së Policisë së Shtetit dhe Kodit të Etikës së Policisë.

142. Trajnime nga organizatat e shoqërisë civile:

- trajnime organizuar nga Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës me tematika: “Trajtimi me dinjitet i personave në konflikt me ligjin; “Trajtimi njerëzor i personave të shoqëruar, ndaluar e arrestuar në ambientet e policisë dhe garancitë që ofron legjislacioni shqiptar për trajtimin shëndetësor dhe psikologjik të ndaluarve/arrestuarve, në ambientet e policisë”;

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit – “Parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit në komisariatet e policisë”;

- trajnime organizuar nga Këshilli i Evropës mbi “Trajtimin e përshtatshëm të të ndaluarve/arrestuarve në ambientet policore”;

- janë zhvilluar seminare/tryeza të rrumbullakëta të përbashkëta me OJQ/OJF për të prezantuar dhe diskutuar raportet e monitorimeve të hartuara;

- seminare dhe tryeza të rrumbullakëta të zhvilluara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me njohjen dhe zbatimin e ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

143. Bashkëpunimi me OJF-të:

- përgatitja dhe hedhja në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit të një “Spoti TV” të prodhuar nga për të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar;

- prodhimi dhe shumëfishimi i Deklaratës “tip” të të drejtave të personave të ndaluar/arrestuar në 9 gjuhë të huaja, me 1000 (njëmijë) kopje për çdo gjuhë;

- prodhimi i 300 (treqind) posterave për parandalimin e dhunës dhe keqtrajtimit të personave në ambientet e policisë, të cilat u janë shpërndarë njësisë vendore të policisë;

- kryerja e monitorimeve në komisariatet e policisë OJF në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit.

144. Nga ana e Avokatit të Popullit janë zhvilluar monitorime/kontrolle çdo vit pothuajse në të gjitha njësitë vendore të policisë. Nga strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe ato të drejtorive vendore të policisë janë administruar njohur dhe analizuar raportet e monitorimeve të kryera nga Avokati i Popullit. Gjithashtu, janë përgatitur e dërguar përgjigjet për Avokatin e Popullit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të bëra pas inspektimeve të kryera.

Rekomandimi 13. Nenet 6, 7, 9 dhe 10. Azilkërkuesit; mbrojtja ndërkombëtare e personave që hyjnë në mënyrë të paligjshme; ndalimi i azilkërkuesve dhe krijimi i kushteve në qendrat e azilkërkuesve

145. Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së” është përafshuar me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së mbi trajtimin dhe menaxhimin e duhur të refugjatëve dhe migrantëve që hyjnë në territorin shqiptar, si dhe për integrimin e tyre. Ligji garanton që personat që kërkojnë azil të kenë qasje në procedurën e azilit, rregullon kushtet për përpunimin e kërkesave të tyre dhe ofron garanci shtesë për trajtimin e kategorive të ndjeshme midis azilkërkuesve – siç janë të miturit e pashoqëruar. Ligji, përfshin një procedurë të përshtetshme për të vlerësuar kërkesat e azilit në mënyrë të shpejtë, kur plotësohen kushtet. Ligji parashikon se “azili” është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që RSH-së u jep refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese.

146. Ky ligj zbatohet për të gjithë shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët kanë deklaruar qëllimin për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e RSH-së, për aq kohë sa atyre u lejohet të qëndrojnë në territorin e RSH-së si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe për anëtarët e familjes së tyre. Ligji (neni 3) parashikon shprehimisht se “moskthimi” është detyrimi i ndalimit për të dëbuar apo kthyer shtetasin e huaj ose personin pa shtetësi në çfarëdolloj mënyre në kufijtë e territoreve ku i kërcënohet jeta ose liria e tij, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjeve të tij politike.

147. Parimi i moskthimit (neni 11), parashikon:

1. Kërkuesi, refugjati, personi me statusin e



mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtje të përkohshme nuk dëbohet, kthehet apo ekstradohet jashtë territorit të RSH-së: a) në një shtet ku jeta ose liria e tij kërcënohet për shkak të racës, të besimit, të kombësisë, të anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike; b) në një shtet ku ka arsye të besueshme se mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet torturës ose ndëshkimit çnjerëzor e degradues apo çdo trajtimi tjetër të parashikuar në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore dhe Lirive të Njeriut, të interpretuar nga Gjykata Evropiane apo në marrëveshjet/konventat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë; c) në një shtet ku ka arsye të besueshme se mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet zhdukjes me forcë; ç) në shtetin e tij të origjinës, në rast se të huajve u është dhënë një nga format e mbrojtjes në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

148. Në ligjin nr. 108/2013, "Për të huajt", i ndryshuar, parashikohen rastet dhe trajtimin e të huajve që janë subjekt dëbimi nga territori i Republikës së Shqipërisë. Në nenin 126 përcaktohet se me kërkesën e të huajit, ose kur përcaktohet nga një marrëveshje dypalëshe, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme njoftohet menjëherë misioni diplomatik apo konsullor i shtetit të të huajit të ndaluar në qendër, për ndalimin e tij, si dhe për zgjatjen e periudhës së ndalimit. Në rast se i huaji ka kërkuar azil ose gëzon statusin e refugjatit apo të një mbrojtjeje tjetër nga Republika e Shqipërisë, ky informacion nuk do t'i bëhet i ditur përfaqësuesit konsullor apo diplomatik të vendit të tij.

149. Në nenin 127, të këtij ligji, parashikohen të drejtat e të huajit të ndaluar në qendrën e mbyllur dhe konkretisht i huaji, i cili qëndron në një qendër të mbyllur, sipas dispozitave të këtij kreu, njihet në gjuhën që kupton, apo së paku në gjuhën angleze, me çdo veprim, i cili kryhet nga autoritetet kompetente, për mbajtjen e tij në qendër, si dhe gëzon të drejtën për një trajtim njerëzor. Sipas nenit 127/3 i huaji gëzon të drejtën për të informuar përfaqësuesin konsullor për ndalimin e tij. I huaji gëzon të drejtën për t'u ankuar në gjykatën e rrethit gjyqësor për shkeljen në qendër të të drejtave të tij themelore. Në rast se ripranohet, i huaji informohet për të drejtat dhe detyrimet, që ka në bazë të legjislacionit shqiptar, në gjuhën që kupton, apo së paku në gjuhën angleze (neni 127/5).

Rekomandimi 14. Nenet 3, 8 dhe 24. Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit (i grave dhe fëmijëve)

150. Legjislacioni penal shqiptar penalizon trafikimin e personave. Ndryshimet në vitin 2017 në "Kodin e Procedurës Penale", të ndryshuar, synojnë arritjet e standardeve më të mira të parashikuara nga instrumentet ndërkombëtare. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve janë përmirësuar ndjeshëm të drejtat dhe pozita e viktimës së veprave penale, duke përfshirë edhe parashikime të posaçme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

151. Ligji procedural penal ka pësuar ndryshime të konsiderueshme lidhur me kompetencën lëndore të hetimit dhe gjykimit të këtyre veprave, si dhe duke garantuar një rol me aktiv dhe të drejta të rëndësishme të viktimës në procesin penal. Me ndryshimet e reja ligjore, kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale për këto vepra janë prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe për gjykimin, gjykatat e rretheve gjyqësore. Në rastet kur këto vepra kryhen në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal apo organizate kriminale, sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurave Penale (neni 75/a), kompetente për hetimin e tyre është Prokuroria e Posaçme dhe gjykimi është në kompetencë të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

152. Organi i prokurorisë i ka kushtuar një vëmendje të posaçme të drejtave të viktimës së trafikimit, ku janë marrë parasysh elementet, që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve të përshtatshme për marrjen në pyetje të viktimës së trafikimit, duke siguruar praninë e punonjësit social apo psikologut, akomodimin e viktimës në qendrat pritëse ku përfitojnë strehim, ushqim dhe shërbime të tjera falas etj.

153. Nuk janë penalizuar viktimat e trafikimit për krime që ato kanë bërë si pasojë e trafikimit (falsifikim dokumentesh, ushtrim prostitucioni etj.), pasi nuk mund të penalizohet viktimat për vepra të kryera si rezultat i të qenit viktimë e trafikimit. Nga ana tjetër, ato kanë të drejtë të gjejnë mbështetjen e prokurorisë për futjen në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, nëse ndihen të kërcënuar.

154. Në kuadër të parandalimit dhe goditjes së fenomenit të trafikimit të personave, veprimet antitrafikim janë fokusuar kryesisht në përmirësimin e kuadrit ligjor, rivitalizimin dhe



forcimin e strukturave kombëtare; në identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit në nivel qendror dhe lokal; kontrollin e trafikimit të brendshëm, kryesisht të fëmijëve dhe grave; përmirësimin e standardeve të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave; intensifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për parandalimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe atë të personelit që punon me shërbimet e ndihmës.

155. Ligji nr. 70/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës”, parashikon se dispozitat e tij zbatohen për pasuritë e personave që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbi të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, për kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet e Kodit Penal të “Trafikimit të personave të rritur” dhe “Trafikimit të të miturve”. Ky ligj përcakton krijimin e një fondi të posaçëm për parandalimin e krimit të organizuar. Fondi i veçantë është caktuar për qëllime sociale, duke përfshirë rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të trafikimit (neni 37/2-c). Neni 37/3-b parashikon që nga ky fond përfitojnë edhe OJQ-të, duke përfshirë edhe strehëzat.

156. MASR-ja, në kuadër të mbështetjes së viktimave të trafikimit me tekste shkollore falas, ka propozuar projekt vendimin “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, i cili është miratuar me vendimin nr. 486, datë 17.6.2020, ku konkretisht (neni 6/f, e, g) përcaktohet se: “Kategoritë që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin në masën 100% të çmimit të teksteve shkollore janë, ndër të tjera:

f) viktima të trafikimit, të cilëve u ofrohet ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare;

e) pritjes së viktimave të trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës, sipas kërkesës zyrtare për sasinë e teksteve shkollore të nevojshme;

g) gëzojnë statusin e viktimës dhe të viktimës së mundshme të trafikimit, në përputhje me vendimin nr. 499, datë 29.8.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

157. Dokumente strategjike

- Strategjia e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit 2014–2017, miratuar me VKM-në nr. 814, datë 26.11.2014.

- Plani i Veprimit për Riintegrimin Social-Ekonomik të Grave dhe Vajzave Viktima/Viktima të Mundshme të Trafikimit (VKM nr. 115, datë 17.2.2016).

- Plani Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave 2018–2020, miratuar me VKM nr. 770, datë 26.12.2018.

- Aktivitetet e parashikuara synuan:

- përmirësimin e funksionimit të një sistemi gjithëpërfshirës nëpërmjet forcimit të mekanizmit të identifikimit, mbrojtjes dhe riintegrimin të viktimave të trafikimit;

- rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit publik lidhur me legjislacionin kombëtar e konventat ndërkombëtare antitrafikim, me të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët, fëmijët në situatë rruge etj.), si dhe pasojat e tij.

- Procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit (PSV), miratuar me VKM-në nr. 499, datë 29.8.2018. PSV-të janë dokumenti bazë për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Qëllimi është mbrojtja, përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo të mitur, shqiptarë, të huaj apo persona pa shtetësi, për të gjitha llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.

- Funksionimin efikas të “Mekanizmit Kombëtar të Referimit”, si dhe shtrirja e tij në nivel qarku, bashkie dhe komune (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për marrjen e masave parandaluese dhe identifikimin e personave të trafikuar) në përputhje me standardet dhe PSV-të.

- Përmirësimi i bazës së të dhënave për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit për regjistrimin, ndjekjen dhe monitorimin e rasteve.

- Rritja e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të punonjësve të policisë së strukturave vendore antitrafikim, nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme, në veçanti rreth zbatimit të “Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen



e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”, si dhe mbi teknikat proaktive të hetimit të veprave penale të trafikimit të personave.

- Për sa u përket rasteve fëmijë-viktima trafikimi ose viktima të mundshme trafikimi, të identifikuara në rrezik të lartë dhe menjëhershëm, janë të ngritura dhe funksionojnë dy qendra kombëtare, të cilat ofrojnë shërbimin emergjent deri në vendimin e grupit teknik ndërsektorial nëse fëmija do të vendoset në përkujdesje alternative apo do të kthehet në familje.

Rekomandimi 15. Nenet 7, 9, 10, 24. Hetimi i rasteve të keqtrajtimit të persona të ndaluar, shoqëruar në ambientet e policisë

158. Kodi i Procedurës Penale (i ndryshuar) parashikon dispozita të detajuara mbi: procedurat, afatet e përfundimit të hetimeve: kushtet e procedimit; gjykimin; Akuzat; marrja e vendimit; vendimi i dënimit.

159. Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve” (i ndryshuar me ligjin nr. 40/2014), ka pasur parashikime mbi trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarit duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore të tyre. Ligji ka pasur si qëllim rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Trajtimi i të paraburgosurve dhe i të dënuarve bëhet duke siguruar mjediset dhe mjetet e përshtatshme, si dhe në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre.

160. Ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” garanton kushtet për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

161. Ky ligj (neni 89 “Të drejtat e të paraburgosurve”), parashikon: 1. Personat e paraburgosur, që ndodhen në institucionet e paraburgimit ose seksionet e paraburgimit, gëzojnë të drejtat e përcaktuara nga ky ligj. 2. Të paraburgosurit lejohen të informojnë menjëherë familjen për arrestimin dhe për vendndodhjen e tyre. Atyre u krijohen të gjitha kushtet e nevojshme të takohen me anëtarët e familjes. Të paraburgosurit e huaj lejohen të informojnë përfaqësinë konsullore ose diplomatike të vendit të tyre.

162. Ligji (neni 90 “Ndihma juridike”), parashikon: 1. Të paraburgosurit informohen në çdo rast për të drejtën për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose kur nuk kanë mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. 2. Mjediset ku mbahen të paraburgosurit duhet të ofrojnë mundësinë që ata të takohen privatisht dhe të komunikojnë me mbrojtësit dhe të kenë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen gjatë gjithë gjykimit. 3. Të paraburgosurit të mitur i garantohet ndihmë juridike dhe psikologjike, si dhe ushtrimi i të gjitha të drejtave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

163. Policia e Shtetit ka marrë masa dhe garanton të drejtën e personave të ndaluar/arrestuar për të marrë informacion mbi të drejtat e tyre dhe në veçanti për realizimin praktik të së drejtës për t’u mbrojtur me avokat, si:

- afishimin në ambientet e drejtorive/komisariateve dhe stacioneve të policisë të posterave me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, ku pjesë e këtyre të drejtave është dhe ajo për t’u mbrojtur me avokat;

- dhënia për personat e ndaluar/arrestuar e kopjes së formatit/deklaratës të shkruar me të drejtat që u njeh ligji në këtë fazë këtyre personave;

- afishimi në ambientet e policisë, dhomat e shoqërimit dhe në dhomat e sigurisë të listave emërore të avokatëve mbrojtës që ushtrojnë aktivitet në juridiksionin që mbulon njësi policore, si dhe të numrave të kontakteve të tyre;

- komunikimi verbal që kryhet ndaj këtyre personave nga policia gjyqësore lidhur me të drejtat që gëzojnë.

164. Gjithashtu, në vijimësi janë përgatitur akte administrative (urdhra, letërporosi, tërheqje vëmendje) të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit apo drejtorëve të departamenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku strukturave vendore të policisë dhe personelit policor i është kërkuar marrja e masave për njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave të ndaluar/arrestuar, sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale.

165. Përmes mekanizmit të kërkesës dhe ankesës është krijuar akses nga administrata e



burgjeve që të dënuarit dhe të paraburgosurit të adresojnë ankesat e tyre në lidhje me të drejtat dhe trajtimin në sistemin e burgjeve, duke ruajtur konfidencialitetin në çdo rast. Protokolli i mekanizmit të kërkesës dhe ankesës përmban formatet përkatëse referuese të drejtimit të një ankese (apo kërkesë) pranë organeve kompetente, duke përfshirë edhe formatin përmes të cilës ankesa mund t'i drejtohet Institucionit të Avokatit të Popullit. Përdorimi i këtyre formateve nuk është detyrues, por orientues për të dënuarin/të paraburgosurin mbi mënyrën se si ai/ajo mund të drejtojë një ankesë, organet/institucionet ku mund të drejtohet, si dhe afatet zyrtare të cilat organet/institucionet duhet të respektojnë për kthimin e përgjigjes të burgosurit.

166. Janë zbatuar rregullat dhe procedurat për sjelljen në vëmendje të gjykatës të të gjitha rasteve të ndalimit/arrestimit nga policia gjyqësore nëpërmjet prokurorit, i cili brenda 48 orëve nga ndalimi/arrestimi paraqet në gjykatë kërkesën për shqyrtimin dhe vlerësimin e masës së marrë nga policia gjyqësore.

- Organi i gjykatës në të gjitha rastet brenda 48 orëve nga mbërritja e kërkesës së prokurorit ka caktuar dhe zhvilluar seancën gjyqësore për vlerësimin dhe caktimin e masës së sigurisë. Në përfundim të seancës gjyqësore gjykata ka vendosur masën e sigurisë ndaj personave të arrestuar/ndaluar, si: arrest në burg, arrest në burg me afat të caktuar, arrest shtëpie, detyrim paraqitje etj.

167. Në nenin 115, të ligjit nr. 108.2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, është përcaktuar: e drejta për të paraqitur kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore nga çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë, si dhe çdo shtetas tjetër lidhur me sjelljen/qëndrimin dhe veprimet e policisë, si dhe detyrimin e policisë për të evidentuar/regjistruar, trajtuar, zgjidhur dhe kthyer përgjigje ankuesit/kërkuesit. Garantohet:

- e drejta për të paraqitur ankesë/kërkesa nga personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuarit në ambientet e policisë, si dhe çdo shtetas tjetër që cenohet nga veprimet e qëndrimet e policisë;

- mënyrat e bërjes së ankësive me gojë ose me shkrim;

- institucionet se ku drejtohen ankesë/kërkesat, si: drejtuesve të policisë dhe institucioneve të tjera shtetërore;

- të drejtën për personat e shoqëruar që t'i drejtohen gjykatës në çdo kohë;

- detyrimin e policisë për të evidentuar e trajtuar ankesë/kërkesat e paraqitura;

- afatet e drejtimit të ankësive/kërkesave dhe kthimit të përgjigjeve për ankuesit: nëse ankesa iu drejtohet drejtuesve të policisë ku është i shoqëruari apo i ndaluar, përgjigja duhet të jepet menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë.

168. Është hartuar dhe vënë në zbatim procedura standarde e punës për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e policisë dhe zgjidhja e ankësive/kërkesave të tyre. Pjesë përbërëse e procedurës standarde për trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar janë dhe rregullat për evidentimin, trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankësive që bëhen nga personat e shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar (urdhri nr. 440/3, datë 27.4.2017, “Për miratimin e procedurës standarde të punës: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankësive të tyre”).

169. Regjistri për evidentimin, trajtimin dhe zgjidhjen e ankësive/kërkesave të personave të privuar nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit, i cili administrohet nga të gjitha njësitë policore. Për kërkesat/ankesat që u drejtohen drejtuesve të policisë ku është i shoqëruari, i ndaluar apo i arrestuar, përgjigja i jepet menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pune nga dita e paraqitjes së tyre.

170. Janë prodhuar dhe afishuar në ambientet e drejtorive dhe komisariateve të policisë, ambientet e dhomave të shoqërimit dhe ato të ndalim/arrestimit (korridoret dhe brenda dhomave të sigurisë):

- postera me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar të cilat janë të vendosura në ambiente të dukshme në dhomat e sigurisë e ambiente të tjera të njërive vendore të policisë;

- numra të telefonit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankësive, organizatës Instituti Evropian i Tiranës, në të cilat personat e ndaluar, arrestuar dhe të shoqëruar mund të telefonojnë pa pagesë për të paraqitur ankesa/kërkesa lidhur me qëndrimin, trajtimin që iu bëhet nga personeli



policor në këto ambiente dhe raste të keqtrajtmeve;

- listat emërore të avokatëve mbrojtës që ushtrojnë aktivitet në juridiksionin që mbulon njësia policore, si dhe të numrave të kontakteve të tyre.

171. Për hetimin dhe trajtimin e rasteve të ankesave për abuzime, keqtrajtime të kryera nga punonjës të Policisë së Shtetit ndaj personave të privuar nga liria (të shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar) dhe persona të tjerë, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Standardeve Profesionale. Kjo strukturë në varësi direkte të DP-së së Shtetit ka për objekt të punës inspektimin dhe kontrollin e veprimtarisë të të gjitha strukturave qendrore dhe vendore të Policisë Shtetit; administrimin dhe trajtimin e të gjitha ankesave të bëra nga shtetasit për abuzime, keqtrajtime e shkelje të të drejtave të shtetasve, si dhe të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë; fillimin e hetimit administrativ/disiplinor për punonjësit e policisë përgjegjës që nuk përmbushin detyrat sipas akteve ligjore, nënligjore dhe procedurave standarde të punës së policisë dhe nuk respektojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Pjesë e kontroleve të kësaj strukture kanë qenë dhe ato me objekt: trajtimi i personave të shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar në ambientet e Policisë së Shtetit dhe masat e marra për respektimin e garantimin e të drejtave të kësaj kategorie personash. Në përfundim të procesit hetimor disiplinor, jep masa disiplinore sipas kërkesave dhe parashikimeve të bëra në rregulloren e Policisë së Shtetit të miratuar me VKM-në nr. 750, datë 16.9.2015.

172. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat fillon hetimet administrative apo ato penale, bazuar në ligjin organik nr. 70/2014, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative. Në rastet kur evidentohen shkelje të karakterit penal, pra punonjësi i strukturës, ka dyshime se ka konsumuar elementë të veprës penale, materialet referohen pranë organit të prokurorisë, për regjistrimin e procedimit penal dhe ndjekjen penale të punonjësit përgjegjës. Në rastet kur evidentohen shkelje të karakterit administrativ, adresohen gjetjet e këtij hetimi pranë strukturave kompetentë të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe PMNZSH-së, për fillimin e hetimit disiplinor dhe dhënie e

ndëshkimit me masë disiplinore për punonjësin përgjegjës.

Ndihma juridike falas

173. Më datë 14.12.2017, është miratuar ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili ka hyrë në fuqi, më datë 1.6.2018. Ky ligj, udhëhiqet nga parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit të individëve lidhur me të drejtën për ndihmë juridike, profesionalizmit në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike.

174. Ky ligj përcakton parimet bazë të ndihmës juridike, si:

- aksesit i barabartë i individëve në ndihmën juridike;
- barazisë dhe mosdiskriminimit të individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- profesionalizmit në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike;
- cilësisë, eficiencës dhe efikasitetit në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike;
- ruajtjes së konfidencialitetit;
- shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit;
- mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël”.

175. Përfituesit e aksesit në drejtësi sipas ligjit nr. 111/2017, janë viktimat e dhunës në familje, viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal, viktimat e mitura dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal, si dhe kategoritë e tjera përfituese në kuadër të nenit 11, të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Ky ligj ka përforcuar aksesin në drejtësi duke i dhënë mundësi ligjore të gjitha kategorive përfituese në kuadër të nenit 11, të përfitojnë ndihmë juridike, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre, të cilët janë:

- viktimat e dhunës në familje;
- viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- viktimat e mitura dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- fëmijët, të cilët gjenden nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e



kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;

- personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;

- personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;

- personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;

- personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;

- personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitim të zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;

- personave, të cilët janë përfutues të skemave të mbrojtjes sociale;

- personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi”.

176. Krahës shumë kategorive të veçanta përfutuese, të cilët përfitojnë ndihmë juridike, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre, sipas nenit 11, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, janë: *personat, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi*”.

177. Ligji nr. 55/2018, më datë 23.7.2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Çështja lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi, është rregulluar, në shkronjën “b”, në nenin 8, me anë të cilit përcaktohet: “se një nga detyrat e avokatit, gjatë ushtrimit të profesionit, i ofron çdo klienti shërbim ligjor të barabartë, duke i garantuar mbrojtje pa asnjë diskriminim të çdo forme, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi...”

178. MASR-ja, në zbatim të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, ku parashikohet që të

paraburgosurit të mitur t’i ofrohet ndihmë në fushën e arsimit lidhur me pajisjen me tekste shkollore, si vijon: “Kategoritë që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin në masën 100% të çmimit të teksteve shkollore janë ndër të tjera, edhe kategoritë e moshës shkollore të arsimit parauniversitar, të cilët janë në institucionet e paraburgimit/vuajtjes së dënimit (pika 6, shkronja “gj”)”.

Rekomandimi 18 (neni 14). Reforma në drejtësi, organet, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, procesi i Vetting-ut

179. Në vitin 2016 janë miratuar me unanimitet të plotë ndryshime kushtetuese që kanë si qëllim reformimin e thellë dhe gjithëpërfshirës të sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të publikut te ky sistem dhe adresimin e çështjeve që lidhen me korrupsionin, mungesën e profesionalizmit, përgjegjshmërisë, transparencës, efikasitetit. Ndryshimet prekin disa çështje kyçe që parashikojnë parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Ndryshimet kushtetuese lidhen me sistemin e drejtësisë, duke synuar adresimin e problemeve ekzistuese përmes rritjes së aksesit dhe efektivitetit në sistemin të drejtësisë duke kryer një reformim të thellë të sistemit të drejtësisë, si dhe të drejtave dhe garancive procedurale të qytetarëve. Ndryshimet lidhen me:

180. Organet e reja të krijuara në kuadër të reformës në drejtësi. Sa i përket pushtetit gjyqësor synon të krijohet frymë e re e funksionimit dhe administrimit të gjykatave për të adresuar korrupsionin, tejzgjatjen e afateve të gjykimeve dhe mungesës së profesionalizmit për figurat e gjyqtarëve.

Qëllimet e reformës në gjyqësor lidhen me:

- 1) Përmirësimin e cilësisë së aksesit në drejtësi, sidomos për kategoritë në nevojë;
- 2) Rritjen e besimit publik në sistemin gjyqësor;
- 3) Përmirësimin e imazhit të gjyqësorit;
- 4) Garantimin e një sistemi eficient që nuk komprometon cilësinë e drejtësisë dhe aksesin në drejtësi.

181. Sistemi i drejtësisë është ristrukturuar duke përfshirë ngritjen e organeve të reja, si: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

***Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve (Vetting)***

182. Risia e ndryshimeve kushtetuese është procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve/*vettingu*, në bazë të kontrollit të figurës, verifikimit të pasurisë, si dhe të aftësisë profesionale. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe komisionerët publikë. Në fund të procesit subjekti vlerësohet, si:

a) i aftë – gjyqtari/prokurori ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e subjekteve të përfshira në proceset gjyqësore, është efektiv dhe eficient në punë;

b) me mangësi – gjyqtari/prokurori ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar të drejtat e palëve dhe nuk është efektiv. Rekomandohet ndjekja e një programi të ri trajnimi deri në 1 vit pranë Shkollës së Magjistraturës;

c) i papërshtatshëm – gjyqtari/prokurori ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar të drejtat e palëve dhe nuk është efektiv dhe ndjekja e një programi trajnimi deri në 1 vit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund të përmirësojë situatën. Në këtë rast, subjekti shkarkohet nga pozicioni i gjyqtarit dhe i prokurorit dhe nuk mund të aplikojë të rikthehet në sistem për një periudhë 15-vjeçare.

183. Në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ligji i ka dhënë publikut një vend të rëndësishëm në këtë proces përmes denoncimit të fakteve, që mund të përbëjnë prova për një nga komponentët e rivlerësimit. Gjithashtu, personi që ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të korrupsionit me subjektin e rivlerësimit, ka të drejtë t'i drejtohet zyrës së prokurorisë kompetente për hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe të marrë statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë.

184. Rezultatet e procesit të *Vetting*-ut paraqiten si më poshtë:

Nga fillimi i procesit të *Vetting*-ut (shkurt 2018), janë dhënë gjithsej 333 vendime, ndër të cilat:

- 138 vendime për konfirmimin në detyrë;
- 123 vendime shkarkimi nga detyra;
- 70 vendime për përfundimin ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, nga të cilat:
- 18 vendime janë për përfundimin e procesit për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit të

magjistratit pasi kanë mbushur moshën e pensionit subjekte dhe për shkak të mbarimit të statusit si rezultat i shkarkimit;

- 43 vendime për ndërprerjen e procesit si rezultat i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes nga funksioni;

- 9 vendime për pushimin e procesit si rezultat i dorëheqjes nga detyra brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit mbi rivlerësimin;

- 2 vendime për pezullimin nga detyra për një periudhë 1-vjeçare deri në përfundimin e programit pranë Shkollës së Magjistraturës.

Rekomandimi 21. Të drejtat e fëmijëve – nenet 23 dhe 24

185. Në kuadër të përmirësimit të legjislacionit për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi u miratua ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, që hyri në fuqi në qershor të vitit 2017. Ligji i ri (nr. 18/2017) parashikon detyrat dhe forcon institucionet, strukturat dhe mekanizmat që do të garantojnë dhe do të sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve nga individët, familja dhe shteti. Ligji zgjeron horizontin e të drejtave të fëmijëve, ndërkohë që thekson forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, duke përfshirë edhe nivelin vendor në veçanti.

186. Ligji nr. 18/2017 parashikon ekzistencën e strukturave të ngritura nga ligji i mëparshëm në nivel vendor, si njësitë për mbrojtjen e fëmijëve (NJMF) dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve (PMF), si struktura përgjegjëse për bashkërendimin dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve dhe menaxhimin e rastit. Ligji përcakton standardin që në çdo njësi administrative të bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, të ketë minimalisht, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Në çdo bashki dhe njësi administrative me më shumë se 3.000 fëmijë, ngrihet Grupi Teknik Ndërsektorial i Posaçëm (GTN), për adresimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve. Ky grup përbëhet nga përfaqësues të policisë, të shërbimeve sociale, të arsimit, të shëndetësisë dhe të drejtësisë, OJF-ve. Mbrojtja e fëmijës ka nevojë për ndërhyrjen e të gjithë këtyre aktorëve dhe nuk mund të bëhet vetëm nga punonjësit socialë. Ky mekanizëm ligjor mundëson një ndërhyrje ndërsektoriale të koordinuar.



187. Ligji nr. 18/2017 përcakton qartë se çfarë do të thotë “mbrojtje e fëmijës”, duke qartësuar se cilat janë masat e mbrojtjes që mund të aplikojnë punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë rreziku për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Këto përfshijnë masat emergjente për ta larguar fëmijën nga një situatë rreziku në mënyrë të menjëhershme, siç mund të jetë një fëmijë në situatë rruge apo një fëmijë i gjetur i neglizhuar rëndë në banesë. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës mund të marrë masën për ta larguar fëmijën nga familja dhe për ta vendosur në përkujdesje alternative kur vetë familja mund të rrezikojë integritetin dhe sigurinë e fëmijës. Gjithashtu, ligji parashikon si masë mbrojtjeje mbikëqyrjen e specializuar të fëmijës në mjedisin familjar. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

188. Përveç masave të mbrojtjes, ligji parashikon edhe mbrojtjen e posaçme për kategori të caktuara fëmijësh, më konkretisht atyre të abuzuar, dhunuar, neglizhuar, fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht dhe fëmijëve të cilët akuzohen se kanë kryer vepra penale, por janë nën moshën e përgjegjësisë penale. Kuadri ligjor parashikon qartësisht se prindërit, familja ka detyrimin kryesor për t'i garantuar fëmijës zhvillim, mirërritje, arsim dhe shëndet. Shteti ka detyrë të ndihmojë familjen kur është e nevojshme, në interesin më të lartë të fëmijës. Për këtë arsye ligji propozon masa të aftësimit prindëror, për të ndihmuar prindërit që të përmbushin detyrimin e tyre prindëror, në mënyrë që fëmija të rritet pranë familjes. Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të parashikuara në ligj për mbrojtjen e fëmijës nga institucionet apo profesionistët, ASHMDF-ja ka të drejtën të vendosë sanksione administrative ndaj personave fizikë ose juridikë.

189. Pas përfundimit të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012–2015, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) dhe Ministria e Mbrojtjes Sociale dhe Rinisë filluan procesin e hartimit të një dokumenti të ri strategjik për të drejtat e fëmijës. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020 (AKDF) është miratuar si një dokument strategjik që shpreh

angazhimin e qeverisë shqiptare për promovimin, mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve. AKDF-ja është hartuar përmes një procesi konsultimi ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, organizatat e shoqërisë civile, kryesisht ato që kanë në fokusin e tyre fëmijët, si dhe komuniteti ndërkombëtar. AKDF-ja është dokumenti i parë politik i cili është konsultuar me fëmijët.

190. Agjenda synoi të përmbushë këtë mision duke iu përmbajtur/integruar standardeve më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve. Vizioni i saj është të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e shëndetshëm fizik dhe psikosocial të fëmijëve, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e tyre në të gjitha proceset, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

191. Shtyllat strategjike të Agjendës ishin:

- mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;
- eliminimi i të gjitha formave të dhunës për fëmijët; dhe

- sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët: zhvillimi dhe arsimimi, drejtësia, shëndetësia dhe ushqyerja, dhe mbrojtja sociale.

192. AKDF-ja synon përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve duke synuar përforcimin e kuadrit rregullator dhe institucional, përfshirë mekanizmat e pavarur monitorues, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve në mënyrë që të gjenerohen të dhëna që ushqejnë politika efektive, si dhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendimmarrje.

Në kuadër të eliminimit të të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve AKDF-ja synon ngritjen e një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet një kuadri ligjor dhe institucional të përmirësuar.

193. Agjenda AKDF synon nxitjen e proceseve dhe sistemeve miqësore me fëmijët, si në arsim, shëndetësi, shërbime shoqërore, dhe drejtësi. Natyra e objektivave dhe e ndërhyrjeve synon një impakt më të madh në jetën e fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Rekomandimi 22. Personat me aftësi të kufizuara – nenet 2, 10, 25, 26

194. Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe qasjen e personave me aftësi të kufizuara”



përcakton si “persona me aftësi të kufizuara”, përkatësisht individët të cilët kanë pengesa afatgjata, mendore, intelektuale dhe ndijore, që së bashku me pengesa të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre personat në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët. Ky ligj mbështet përfshirjen sociale në të gjitha aspektet e jetës së personave me aftësi të kufizuara. Legjislacioni shqiptar garanton të drejtën për arsim në të gjitha nivelet e arsimit të përcaktuara me ligj, pavarësisht nga statusi social, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik.

195. Personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri trajtohen bazuar në kuadrin ligjor, si vijon:

- ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;
- ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar;
- ligji nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;
- ligji nr. 7889, datë 14.12.1994, “Mbi statusin e invalidit të punës”, të ndryshuar;
- ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Personat me aftësi të kufizuara përfitojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore në zbatim të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

196. Plani Kombëtar i Veprimit 2016–2020 parashikon përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, parandalimin e diskriminimit dhe qasjen në shërbimet dhe të drejtat e tyre. Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) është dokumenti strategjik i Qeverisë shqiptare për përfshirjen dhe integrimin në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara, i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 29.6.2016. Plani përmbante aktivitete për periudhën 2016–2020 dhe përcaktonte institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve, duke vendosur një theks të veçantë mbi bashkëpunimin mes institucioneve në nivel qendror dhe vendor, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

197. Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK) 2021–2025 është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për

personat me aftësi të kufizuara për zbatim gjatë 5-vjeçarit të ardhshëm.

Rekomandimi 23. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Romët dhe Egjiptianët – nenet 2, 25, 26, 27

198. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020, i miratuar me VKM-në nr. 1072, datë 23.12.2015, është i mbështetur në parimin themelor të mosdiskriminimit. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020 targeton dy pakicat përkatëse dhe parashikon aktivitete për nxitjen e integritit të romëve dhe egjiptianëve me fondet e parashikuara nga buxheti i shtetit, por duke identifikuar edhe hendekun financiar për periudhën 2016–2020, si dhe mundësinë e financimit nëpërmjet koordinimit me ndihmën e huaj.

199. Plani i Veprimit është hartuar në konsultim të ngushtë me ministritë përgjegjëse të linjës, përfaqësues nga komuniteti rom dhe egjiptian, si dhe aktorë të tjerë. Ky Plan përfshin politika specifike dhe masa konkrete që institucionet përgjegjëse do të ndërmarrin në realizimin e objektivave, në sektorët respektivë dhe programet publike, që synojnë të përmirësojnë jetesën e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Për herë të parë është një Plan masash konkrete i shoqëruar me një analizë buxhetore në përputhje me Planifikimin Buxhetor Afatmesëm dhe mbështetjen financiare të partnerëve.

200. Ky Plan Veprimi përfshiu një buxhet të caktuar për zbatimin e çdo veprimtarie. Në varësi të llojit të veprimtarisë, Plani i Veprimit specifikon: a) financimin nga qeveria; b) financimin nga donatorët; c) kombinimin e financimit nga qeveria dhe financimit nga donatorët. Analiza buxhetore që shoqëron këtë Plan tregon që burimet për financimin e zbatimit të Planit do të mbulohen 55% nga fondet e buxhetit të shtetit dhe 45% nga fondet e donatorëve. Nuk janë përfshirë, gjithashtu, buxhetet e bashkive, sepse ato do të pasqyrohen në planet lokale të veprimit për romët dhe egjiptianët (ndërsa plani kombëtar fokusohet në burimet dhe përgjegjësitë kombëtare).

201. Parimet kryesore të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, janë: 1. Nxitja e përfshirjes sociale. Aktivitetet e Planit të Veprimit synojnë të nxisin përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në shoqëri e



jo të krijojnë sisteme paralele për t'u përdorur nga këto komunitete. 2. Përdorimi i një qasjeje të targetuar/synuar për trajtimin e çështjeve specifike të përjashtimit. Ndërhyrjet kanë pasur si synim integrimin e tyre në sistemin e përgjithshëm dhe të përmirësojnë aksesin e tyre në shërbimet publike ekzistuese. 3. Respektimi i dallimeve. Plani i Veprimit respekton dallimet mes komunitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe brenda vetë këtyre komuniteteve. 4. Angazhimin e romëve dhe egjiptianëve. 5. Nxitja e bashkëpunimit midis qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore, shoqërisë civile, komunitetit ndërkombëtar dhe veçanërisht vet komuniteteve. 6. Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale: promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimin urban, punësimin, arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale, regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integritetit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. 7. Plani i Veprimit është i pajisur me tregues për matjen e progresit të zbatimit dhe treguesit fillestarë. 8. Ndërgjegjësimi mbi dimensionin gjinor. 9. Buxhetimi për zbatimin: ministritë e linjës kanë identifikuar një buxhet për zbatimin e çdo aktiviteti. Në rastet kur financimi publik është i pamjaftueshëm, ministritë kanë identifikuar edhe hendeqet e financimit për ndihmë nga donatorët.

202. Nga rekomandimet e Seminarit të Katërt të Dialogut mbi Politikat për Përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve, sektorët prioritarë rezultojnë: i) regjistrimi civil dhe aksesin në drejtësi; ii) arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor; iii) punësimi, aftësimi dhe formimi profesional; iv) kujdesi shëndetësor; v) strehimi; vi) përkujdesja sociale; dhe vii) antigipsizmi.

203. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me mbështetjen e projektit ROMACTED është fokusuar në zbatimin e politikave specifike të romëve dhe egjiptianëve në nivel vendor. Në vitin 2018 është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit në kuadrin e bashkëpunimit trepalësh midis Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe bashkive të Elbasanit, Pogradecit, Korçës, Fierit, Roskovecit, Vlorës dhe Përmetit. Tetë bashki të vendit (Tiranë, Durrës, Shkodër, Berat, Pogradec, Lezhë, Kurbini, Korçë)

kanë miratuar plane vendore veprimi për integrimin e romëve dhe egjiptianëve.

204. Garantimi i kujdesit shëndetësor cilësor, të barabartë dhe pa diskriminim për të gjitha gratë, burrat, vajzat e djemtë romë dhe egjiptianë është prioritet i MSHMS-së, i adresuar në mënyrë të vazhdueshme përmes masave të veçanta që synojnë përmirësimin e aksesit në shëndetësi të grupeve më në nevojë. Në kuadër të programit të Kujdesit Shëndetësor të Komunitetit, vëmendje të veçantë i kushtohet vaksinimit, mamografisë dhe shërbimeve të tjera parandaluese, përmes qasjes me shërbime afër vendbanimit për kategoritë e veçanta, veçanërisht për pakicat romë dhe egjiptiane. Kontakti i drejtpërdrejtë në komunitet dhe dhënia e informacionit mbi kujdesin shëndetësor me një gjuhë të përshtatshme e lehtësisht të kuptueshme për pakicat romë dhe egjiptiane, është një përparësi e këtij programi, paralelisht me rritjen e aksesit në shërbimet shëndetësore atje ku ata jetojnë.

205. Me miratimin e Strategjisë të Kujdesit Parësor po punohet për të bashkërenduar kujdesin shëndetësor me atë social. Një ndër qëllimet e Strategjisë së re është sigurimi i shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale për t'iu përgjigjur nevojave individuale të individëve dhe grupeve të cënueshme, me fokus të veçantë gratë dhe vajzat që pësojnë diskriminim të shumëfishtë.

206. Viti 2020 shënoi finalizimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Integritetit të Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020. Janë përgatitur 4 raporte monitorimi për vitet 2016, 2017, 2018, 2019, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), nën seksionin *Roma Integration*. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është aktualisht në procesin e hartimit të Planit të ri për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve 2021–2025. Procesi është formalizuar me krijimin e grupit të punës, me urdhrin nr. 521, datë 23.9.2020 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

207. Në dhjetor të 2020-s janë organizuar takime *online* për të gjitha fushat, si: arsimi, mbrojtja sociale, regjistrimi civil dhe aksesin në drejtësi, kujdesi shëndetësor, strehimi social dhe antiracizmi ndaj romëve dhe egjiptianëve. Duke synuar promovimin e integritetit të pakicave romë dhe egjiptiane, morën pjesë nëpunësit civilë të ministrive të linjës dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, si dhe organizatat



e shoqërisë civile, për të prezantuar rekomandimet e tyre mbi çështjet që lidhen me romët. Dokumentet kryesore, të përdorura gjatë hartimit të planit, janë: 1. Deklarata e Poznanit, e nënshkruar vitin e kaluar nga kryeministrat e Ballkanit Perëndimor; 2. Kuadri Strategjik i BE-së 2020–2030 për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen; 3. Rekomandimet e Seminarit të Katërt Shqipëri–BE. Si fushë strategjike, për herë të parë, është përfshirë fusha e “antiracizmit ndaj romëve dhe egjiptianëve”, me qëllim adresimin e tij në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve strukturore, për të garantuar një shoqëri jodiskriminuese.

208. Në nivel vendor, janë miratuar në disa bashki të vendit planet vendore të zhvillimit të pakicës rome dhe egjiptiane, të cilat adresojnë fusha prioritare për përfshirjen dhe integrimin e këtyre pakicave si në: punësimin, strehimin, shëndetësinë, ofrimin e shërbimeve, mbrojtjen sociale dhe regjistrimin civil. Në Bashkinë e Tiranës me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 4, datë 31.1.2018 është miratuar Plani Lokal i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2017–2020. Bazuar në Planin Lokal dhe Planin Kombëtar për zhvillimin dhe integrimin e pakicës rome dhe egjiptiane, strukturat e shërbimeve sociale, pranë bashkive, kanë mbështetur dhe ofruar shërbime për individët dhe familjet rome dhe egjiptiane.

209. Me mbështetjen e Këshillit të Evropës janë hartuar dhe miratuar 7 plane vendore, të cilat kanë në fokus integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane. Këto dokumente vendore përfaqësojnë modele të mira ku çështjet rome adresohen në mënyrë ekskluzive, por edhe të përfshira nën një kuadër më të përgjithshëm vendor të kohezionit social midis grupeve të tjera sociale si Plani i Veprimit për Përfshirjen Sociale. Planet e miratuara, janë:

- Roskovec: Plani Social 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Roskovec, me vendimin nr. 47, datë 17 maj 2019;

- Fier: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicës Rome dhe Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Fier, me vendimin nr. 73, datë 18 qershor 2019;

- Përmet: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicës Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Përmet, me vendimin nr. 109, datë 19 dhjetor 2019;

- Pogradec: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec nr. 22, datë 28 janar 2020;

- Vlorë: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Vlorë nr. 15, datë 27 shkurt 2020;

- Elbasan: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Elbasan, me vendimin nr. 43, datë 30 prill 2020;

- Korçë: Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Korçë, me vendimin nr. 47, datë 29 maj 2020.

Rekomandimi. Strehimi i pakicave kombëtare, veçanërisht pakicës rome dhe egjiptiane. Zbatimi i rekomandimeve të Komitetit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës

210. Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social” bazohet në një sërë parimesh si ai i mosdiskriminimit, përballueshmërisë së strehimit, strehimit të përshtatshëm dhe ka si objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Ky ligj mundëson shtimin e programeve të strehimit nga tre në gjashtë, të cilat janë: 1. Banesë me kosto të ulët. 2. Banesa sociale me qira. 3. Program i zhvillimit të zonave me qëllim strehim. 4. Programi i përmirësimit të kushteve të banesës. 5. Programi për krijimin e banesave të përkohshme dhe 6. Programi i banesave të specializuara. Njëkohësisht ligji ka parashikuar edhe një sërë instrumentesh financiare në mbështetje të familjeve me të ardhura të ulëta e të mesme, si: subvencionimi i qirasë, subvencionimi i interesave të kredisë për strehim, grant i menjëhershëm për blerjen e një banese me kosto të ulët dhe grantet konkurruese për përmirësimin e kushteve të banimit. Një hap i rëndësishëm në miratimin e këtij ligji është arritur me përcaktimin e procedurave të zhvendosjes, duke përcaktuar



mënyrën, kohën dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvendosje.

211. Në nenin 2 të këtij ligji, ndër të tjera, përcaktohet:

- “Programe sociale strehimi” janë programe që shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve që nuk kanë banesë dhe banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji, që nuk kanë mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë, si dhe ato familje/individë, banesa e të cilëve është nën normën ligjore të strehimit dhe që nuk kanë të ardhura që të sigurojnë pagesën për një qira minimale në tregun e lirë;

- “Dëbim” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtimet formale, informale ose strukturat që nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, pa një proces të rregullt ligjor, në mungesë të konsultimit dhe ofrimit të strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe pa siguruar një mbrojtje ligjore efektive;

- “Zhvendosje” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, me ose kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtimet formale ose strukturat që nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, mbështetur në konsultim me subjektet e prekura, në ofrimin e strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe në garantimin e mbrojtjes ligjore efektive.

212. Ky ligj mbështetet në një sërë parimesh, si:

- Parimi i mosdiskriminimit: 1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese. 2. Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të përfutur strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur një

program social strehimi është i programuar në mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t'i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë;

- Parimi i respektimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve: njësitë e vetëqeverisjes vendore, në planifikimin e zonave të banimit e të programeve të strehimit, respektojnë traditat dhe kulturat e ndryshme të komuniteteve;

- Parimi i pjesëmarrjes: çdo subjekt që zbaton një program social strehimi përfshin në proces konsultimi komunitetin që preket dhe/ose atë që përfiton nga programi, në përputhje me ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;

- Parimi i transparencës dhe i informimit të publikut: organet e njësitë të vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë: informacion të plotë, të lehtë për t'u gjetur, të kuptueshëm dhe të lexueshëm për çdo individ/familje;

- Parimi i sigurisë së qëndrimit: 1. Qëndrimi në një vendbanim, strehim të përkohshëm ose të përhershëm është i pacenueshëm, përveç rasteve që janë në kundërshtim me parimet kushtetuese, si dhe ato të parashikuara me ligj. 2. Ndalohej dëbimi i individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre. 3. Zhvendosja e individëve/familjeve në rastet e parashikuara në ligj kryhet në përputhje me parimet e njoftimit, konsultimit dhe strehimit të përshtatshëm.

213. Ky ligj parashikon procedurën e zhvendosjes në rast se qëndrimi në një vendbanim ose strehim bëhet i pamundur, për shkak të investimeve me interes publik, prishje të objektit për shkak të përjashtimit nga procesi i legalizimit ose raste të tjera, të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera. Ligji parashikon procedurën që ndiqet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore:

- njoftimin me shkrim të individit/familjes për arsyet e zhvendosjes 30 ditë përpara nxjerrjes së aktit administrativ për zhvendosjen nga banesa;

- informimin e individit/familjes për mundësitë alternative të strehimit;

- nxjerr aktin administrativ për zhvendosjen nga banesa 45 ditë përpara zhvendosjes, duke njoftuar edhe formën e miratuar për strehim alternativ;

- zhvendosja, nuk zbatohet pa siguruar më parë sistemin e strehimit të përshtatshëm të individëve/familjeve që zhvendosen dhe nuk përfitojnë shpronësim;

- kundër vendimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për zhvendosje nga banesa, mund të



bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente;

- individët/familjet që preken nga zhvendosja përfitojnë ndihmë juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

- dispozitat tranzitore të ligjit parashikojnë që për dy vjet nga hyrja në fuqi e ligjit, jo më pak se 5% e përfituesve nga programet e strehimit i përkasin pakicës rome dhe pakicës egjiptiane.

214. VKM nr. 405, datë 1.6.2016, “Për miratimin e Strategjisë së Strehimit Social 2016–2025”. Qëllimi kryesor i strategjisë është: “Ofrimi i zgjidhjeve të gatshme, të arritshme, të përbalueshme dhe cilësore për strehim për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë një shtëpi në treg të hapur dhe, në veçanti, për familjet me tregues të pozitive të pafavorizuar që çojnë në përfshirje nga strehimi”. Objektivat e strategjisë përfshijnë: 1. Sigurimin e evidencës rreth strehimit social dhe kapaciteteve vendore; 2. Përmirësimin e kuadrit ligjor, institucional dhe rregullator; 3. Fuqizimin e instrumenteve financiare për grupet në pozita të pafavorizuara; 4. Zgjerimin dhe riorientimin e programeve të strehimit social.

215. Pas miratimit të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, janë miratuar 22 akte nënligjore në zbatim të këtij ligji, të cilat mundësojnë edhe zbatimin e tij nga pushteti vendor, duke plotësuar kështu paketën e akteve nënligjore në masën 90%: janë miratuar.

216. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për edukimin zgjedhor të shtetasve, ka treguar vëmendje të veçantë për hartimin dhe realizimin e programeve edukues dhe informues për çështje zgjedhore për pakicat kombëtare, me fokus të veçantë pakicën rome dhe pakicën egjiptiane. Problemet e mprehta ekonomike dhe sociale të këtij komuniteti kushtëzojnë qasjen me procesin zgjedhor, ku më evidentet janë mungesa e informacionit dhe pjesëmarrja e ulët në procesin e votimit. Programi i veçantë për pakicat kombëtare, parashikon mjete dhe mënyra, jo vetëm të shkruara, por edhe përmes spoteve televizive, duke synuar që zgjedhësit që u përkasin pakicave kombëtare edhe në gjuhën e pakicave kombëtare.

SHTOJCAT

SHTOJCA NR. 1

ORGANET E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Gjykata Kushtetuese ka pësuar disa ndryshime të cilat fokusohen në:

- pavarësinë dhe efektivitetin GJK-së duke përcaktuar rregullat dhe kriteret për përzgjedhjen e gjyqtarëve të GJK-së ku 1/3 e anëtarëve zgjidhet nga Presidenti i Republikës, 1/3 nga Kuvendi me shumicë të cilësuar prej 3/5 të votave dhe 1/3 nga trupa e Gjykatës së Lartë, midis 3 kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi;

- funksionimin kolegjal të GJK-së dhe shmangien e qëndrimit të tejzgjatur në detyrë;

- respektimin e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit kushtetues (9 vjet);

- krijimin e modaliteteve dhe afateve të qarta për çështje që kanë të bëjnë me shkarkimin dhe mbarimin e mandatit të gjyqtarëve;

- përgjegjësinë disiplinore të tyre;

- krijimin e mekanizmave për identifikimin më të saktë të çështjeve që lidhen me juridiksionin e GJK-së, duke synuar shmangien e saj si shkallë e katërt gjykimi në funksion të ekonomisë dhe eficiencës gjyqësore.

Gjykata e Lartë

Si rezultat i kryerjes së procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve, aktualisht Gjykata e Lartë ka 3 anëtarë nga 19 anëtarë që duhet të ketë sipas Kushtetutës. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Kushtetuta parashikon që një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë (4 nga 19 anëtarë) përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë.

Të tre anëtarët e Gjykatës së Lartë janë përzgjedhur nga radhët e juristëve të spikatur. Aktualisht, vakancat në Gjykatën e Lartë duhen plotësuar edhe me një anëtar nga radhët e juristëve të spikatur dhe 15 anëtarë nga radhët e gjyqësorit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjëshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Ai përbëhet nga 11 anëtarë, që e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Gjashtë anëtarë



zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë. Pesë anëtarët, që zgjidhen nga Kuvendi, prej të cilëve zgjidhet dhe kryetari, vijnë nga avokatia (2 anëtarë), nga Akademia (2 anëtarë) dhe shoqëria civile (1 anëtar). Ndërkohë janë përjashtuar tre anëtarët *ex officio* në këtë organ (Presidenti i Republikës, kryetari i Gjykatës së Lartë, ministri i Drejtësisë, por ministri mund të ftohet në mbledhje mbi politikat e përgjithshme, pa të drejtë vote).

Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;

b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit;

ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;

d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave;

e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;

ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Ai përbëhet nga 11 anëtarë që e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Gjashtë anëtarë zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë. Zgjedhja e prokurorëve kryhet nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve pasi kandidati për anëtar të KLP-së t'i jenë nënshtruar procesit të vlerësimit kalimtar. Pesë anëtarët që zgjidhen nga Kuvendi, prej të cilëve zgjidhet dhe Kryetari, vijnë nga avokatia (2 anëtarë), nga akademia (2 anëtarë) dhe shoqëria civile (1 anëtar).

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Ai zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional dhe nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati. Ai është një organ i përkohshëm që mblidhet sa herë është e nevojshme dhe përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit, si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në funksion të efektivitetit dhe luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar është krijuar një strukturë e posaçme e cila nga ka në përbërje të saj gjykata, prokurorinë dhe njësinë e posaçme



hetimore të cilat janë struktura të specializuara të ngritura si më poshtë:

Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.

Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet nga radhët e prokurorëve të kësaj prokurorie me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për 3 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje, sipas ligjit. Prokurori i Prokurorisë së Posaçme shkarkohet për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një shkeljeje të rëndë disiplinore me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kandidati për prokuror, oficer i hetimit, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Njesisë së Posaçme Hetimore, si dhe familjarët e afërm të tij, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve personale, sipas ligjit.

Prokuroria e Posaçme u ngrit si nevojë për të pasur një strukturë të specializuar për të hetuar dhe ndjekur penalisht në mënyrë efikase çështjet e vështira të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe krimet e kryera nga zyrtarë të rëndësishëm, në

mënyrë të pavarur dhe pa asnjë ndikim të papërshtatshëm. Prokurorët e Posaçmë janë të pavarur në zhvillimin e hetimeve dhe ndjekjes penale nga çdo prokuror tjetër, duke përfshirë dhe Prokurorin e Përgjithshëm, madje edhe nga vetë drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe veprimet e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Atyre iu është dhënë pavarësi në marrjen e vendimeve të pa ndikuar nga faktorë të paligjshëm. Madje ata mund të hetojnë dhe ndjekin penalisht edhe vetë kolegët e tyre ose gjyqtarë të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçmë i janë dhënë garanci edhe mbi mandatin e tyre duke qenë se emërohen nga KLGJ-ja dhe KLP-ja respektivisht, si dhe mund të shkarkohen vetëm me 2/3 e votave të tyre për shkelje të rënda disiplinore, dhe për më tepër kundër këtij vendimi ata mund të bëjnë ankim në Gjykatën Kushtetuese.

Aktualisht, Prokuroria e Posaçme ka 13 anëtarë, nga 15 që kërkohet të ketë sipas ligjit. Anëtarët e saj emërohen nga KLP-ja për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Në kuadër të procesit të reformës në drejtësi, Prokuroria e Posaçme ka filluar procedimet penale ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese të cilët me vendim të KPK-së janë shkarkuar mbi bazën e gjetjeve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Gjykata e Posaçme Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar përbëhet nga 16 gjyqtarë dhe Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar përbëhet nga 11 anëtarë.

Aktualisht, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë ka 6 gjyqtarë të caktuar në mënyrë të përkohshme dhe 3 gjyqtarë të caktuar në mënyrë të përhershme, ndërsa Gjykata e Posaçme e Apelit ka 5 gjyqtarë të caktuar në mënyrë të përhershme. Njëkohësisht KLGJ-ja ka shpallur dhe vakancat përkatëse.

Byroja Kombëtare e Hetimit është në varësi të Prokurorisë së Posaçme si një njësi e specializuar për të kryer hetime efikase mbi rastet e korrupsionit, krimit të organizuar, si dhe krimet e kryera nga zyrtarë të rëndësishëm, në mënyrë të pavarur dhe pa asnjë ndikim të papërshtatshëm. Njësoj si Prokuroria e Posaçme edhe kjo njësi është e pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm. Ajo përbëhet nga drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit



dhe punonjësit e administratës. Drejtori i BKH-së emërohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me propozimin e grupit drejtues të Prokurorisë së Posaçme. BKH-ja ka, gjithashtu, në përbërje të saj shërbime të Policisë Gjyqësore, të përbëra nga oficerë të Policisë Gjyqësore, nga Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera përkatëse me qëllim bashkëpunimin dhe komunikimin midis BKH-së dhe institucioneve të tjera, si dhe të ndihmojnë në hetimet e Prokurorisë së Posaçme, që kryhen nga institucione të tjera. Punonjësit e BKH-së, pas përfundimit të trajnimit dhe emërimit në detyrë, qëndrojnë në detyrë për jo më pak se shtatë vjet.

Të gjitha organet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit për hetimin e çështjeve penale, sipas legjislacionit në fuqi. Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë akses të drejtpërdrejtë në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore dhe organet shtetërore kanë detyrim të japin informacionin e kërkuar brenda 24 orëve ose, në qoftë se baza e të dhënave ekziston, t'i japin akses të drejtpërdrejtë Prokurorisë së Posaçme.

Procesi i për zgjedhjes së drejtuesit dhe 60 hetuesve është përcaktuar në nenet 6, 34 dhe nenin 38, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i cili specifikon kriteret për emërimin e hetuesit të BKH-së dhe kriteret për emërimin e drejtuesit të BKH-së, ku përfshihet ndër të tjera përvoja në punë, arsimimi dhe sjellja në të shkuarën.

SHTOJCA NR. 2 STREHIMI

1. Pas miratimit të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, janë miratuar 22 akte nënligjore:

- VKM nr. 361, datë 29.5.2019, “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”, i cili parashikon në përputhje me udhëzimet e Kombeve të Bashkuara, procedurat e dëbimit, afatet kohore dhe bashkëpunimin institucional për rastet e zhvendosjes. Kjo VKM trajton të gjithë shtetasit shqiptarë, pavarësisht nëse ata janë pronarë të

shtëpisë ku janë vendosur apo jo. VKM-ja parashikon se qytetarët nuk do të detyrohen të largohen nga shtëpia e tyre, deri në ofrimin e një zgjidhje të përshtatshme për ta sipas programit të strehimit social;

- VKM nr. 453, datë 3.7.2019, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”;

- VKM nr. 458, datë 3.7.2019, “Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore, që përshtaten nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me grante konkurruese nga buxheti i shtetit”;

- VKM nr. 459, datë 3.7.2019, “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”;

- VKM nr. 384, datë 12.6.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;

- VKM nr. 361, datë 29.5.2019, “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”;

- VKM nr. 362, datë 29.5.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”;

- VKM nr. 522, datë 25.7.2019, “Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”;

- VKM nr. 823, datë 18.12.2019, “Për procedurat e blerjes së shtëpive në tregun e lirë që do t'i shtohen fondit publik të shtëpive me qira sociale”;

- VKM nr. 179, datë 26.2.2020, “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave”;

- VKM nr. 300, datë 15.4.2020, “Për procedurat e shkëmbimit të njëjësive të përballueshme të banesave”;



- VKM nr. 301, datë 15.4.2020, “Për normat e strehimit, kushtet dhe standardet për shtëpitë sociale që blihen në tregun e lirë dhe shtëpitë me kosto të ulët”;

- Rregullorja e ministrit nr. 31, datë 18.11.2019, “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin nga fondet e buxhetit të shtetit për programet e strehimit;

- Mbështetje për strehimin e familjeve rome dhe egjiptiane, përmes projekteve të investimeve;

- Udhëzim i përbashkët nr. 22, datë 5.6.2020, “Për mënyrën e ndërveprimit të programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale të punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor”;

- VKM nr. 496, datë 24.6.2020, “Për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar të strehimit, si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë”;

- VKM nr. 579, datë 22.7.2020, “Për përcaktimin e institucioneve publike që administrojnë strehët, i kriterëve, procedurave dhe kapaciteteve të mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike, si dhe procedurat e administrimit dhe mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme, kompetencat e subjekteve përgjegjëse dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre”;

- Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 33, datë 26.8.2020, “Për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme”;

- Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 40, datë 23.10.2020, “Për mënyrën e administrimit dhe të mirëmbajtjes së banesave të specializuara”;

- VKM nr. 898, datë 18.11.2020, “Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyer në fond banesë të paprivatizuara”;

- VKM nr. 142, datë 10.3.2021, “Për përcaktimin e kriterëve për përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës, me qëllim strehimin, mënyrën e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, formën e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, për strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre”.

2. Gjatë vitit 2019, afërsisht 118 milionë lekë janë ndarë nga buxheti i shtetit, nga të cilat 65 milionë lekë janë akorduar për subvencionin e qirasë të 674 familjeve që kanë aplikuar sipas ligjit

mbi strehimin. Rreth 15,7% i përkasin përfituesve që u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane; 5 milionë lekë për programin e subvencionit të shumës së njëpasnjëshme të 24 familjeve, ku 100% e përfituesve janë familje rome dhe egjiptiane dhe 48 milionë lekë janë dhënë për subvencionin 1 mujor të qirasë së familjeve që janë prekur nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.

3. Gjatë vitit 2020, për zbatimin e projekteve të investimeve, janë vënë në dispozicion rreth 354 milionë lekë nga buxheti i shtetit, nga të cilat 92 milionë lekë për projektet në vazhdim nga 2019 dhe 262 milionë lekë për zbatimin e fazës së parë të projekteve të reja. Pjesa tjetër e fondeve janë parashikuar nga fondet e buxhetit të shtetit të vitit 2021. Projektet e investimeve, përfshijnë investime për: a) përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese nga të cilat kanë përfituar 561 familje; b) përshtatjen e ndërtesave shtetërore në objekte banimi, nga të cilat janë përftuar 99 njësi banimi që i shtohen fondit publik të banesave sociale. Familjet e pakicave rome dhe egjiptiane përbëjnë rreth 42% të numrit të përgjithshëm të përfituesve.

4. Në funksion të instrumentit financiar për subvencionimin e qirasë së banesave në treg, janë ndarë nga buxheti i shtetit rreth 3,003 milionë lekë nga të cilat 87 milionë lekë janë akorduar për subvencionin e qirasë për 1,235 familjeve që kanë aplikuar sipas ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”. Rreth 16% e totalit të përfituesve u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane dhe 2,945 milionë lekë për subvencionimin e qirasë, për rreth 13,900 familje të mbetura të pastreha si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019.

SHTOJCA NR. 3

INFORMACION PËR INFORMIMIN E PAKICAVE MBI ZHVILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR

1. KQZ-ja ka identifikuar nevojat për informacion zgjedhor të pakicave kombëtare, përmes një projekti të realizuar në bashkëpunim me OSBE-në dhe me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane. Përmes intervistave dhe pyetësorëve të zhvilluar në qarqet Tiranë, Shkodër, Fier dhe Gjirokastrë, u mblodh informacioni i nevojshëm mbi bazën e të cilit, u analizua situata për nevojat dhe mënyrat më eficiente të shpërndarjes së



informacionit zgjedhor të pakicave kombëtare, me fokus hartimin e kurikulave për edukim zgjedhor të pakicave kombëtare, romëve dhe egjiptianëve.

2. KQZ-ja nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA), qëllimi kryesor i së cilës ishte realizimi në vijimësi i projekteve edukuese zgjedhore për komunitetet rome. Mbështetja e OSBE-së, mundësoi që sesionet e edukimit zgjedhor të zhvillohen në të gjitha vendqëndrimet e komunitetit: Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Kuçovë, Pogradec, Korçë, Gjirokastrë, Lezhë, Delvinë dhe të shtrihet në kohë duke garantuar qëndrueshmërinë e veprimtarisë. Zgjedhje për Kuvendin e RSH-së 2017: KQZ-ja miratoi dhe realizoi projekt të veçantë për informimin dhe ndërgjegjësimin e pakicave kombëtare, pjesë e Strategjisë për Edukimin Zgjedhor të Shtetasve. Pakicat kombëtare: greke, maqedonase, rome, malazeze dhe arumune shpërndarja e informacionit zgjedhor dhe mesazheve sensibilizuese për pjesëmarrje në votim u realizua nëpërmjet posterave dhe fletëpalosjeve në gjuhët respektive.

3. KQZ-ja, në bashkëpunimit të ngushtë me Komitetin Shtetëror të Minoriteteve, si dhe me OJF-të përfaqësuese të pakicave kombëtare identifikoi zonat dhe numrin përkatës së popullsisë së pakicave kombëtare, realizoi përkthimin e materialeve në gjuhët respektive, u realizua prodhimi dhe shpërndarja e posterave dhe fletëpalosjeve në gjuhën e pakicave (greke, maqedonase, malazeze, arumune, rome).

Në të gjitha zonat respektive sipas numrit përkatës së popullsisë rezidente që i përkasin pakicave kombëtare, KQZ-ja shpërndau fletëpalosje me informacion të plotë për sistemin zgjedhor, llojin e zgjedhjeve, mandatet, subjektet zgjedhore, kandidatët, oraret e votimit, procedurat e votimit, rëndësinë dhe vlerën e votës, rëndësinë e pjesëmarrjes në votime, për veprat penale në zgjedhje dhe masën e dënimit për to, numrin e telefonit pa pagesë dhe aplikacionin ku merret informacion për procesin zgjedhor dhe mund të raportohet për veprime joligjore në zgjedhje.

4. Në të gjitha qendrat e votimit ku ishin të regjistruar zgjedhës të pakicave kombëtare u afishuan postera në gjuhët respektive, me informacion për procedurat e votimit, veprimet e ndaluara në Qendrën e Votimit. Në zonat me pakica kombëtare u afishohen në vende publike

dhe në të gjitha qendrat e votimit, postera ndërgjegjësuës dhe sensibilizues në gjuhë të pakicave kombëtare që për të rinj, të moshuar, gra, votues me aftësi të kufizuar, për rëndësinë e pjesëmarrjes në votime, veprat penale në zgjedhje dhe masën e dënimit për to, numrin e telefonit pa pagesë apo adresën e aplikacionit ku çdokush mund të marrë informacion zgjedhor, apo të raportojë për veprime joligjore në zgjedhje.

Zgjedhje vendore 2019: KQZ-ja nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Komitetin Shtetëror të Pakicave Kombëtare. Të gjitha materialet informuese/edukuese/ndërgjegjësuës, që KQZ-ja prodhoi për procesin zgjedhor, u prodhuan edhe në gjuhët e nëntë pakicave kombëtare. Komiteti Shtetëror i Pakicave Kombëtare realizoi përkthimin në gjuhët e pakicave kombëtare të materialeve informuese, edukuese, ndërgjegjësuës për zgjedhjet e datës 30.6.2019, si dhe u angazhua për shpërndarjen e tyre në njësitë e vetëqeverisjes vendore me numrin më të madh të tyre.

5. Në bashkëpunim me Policinë e Kufirit, fletëpalosje në gjuhë të pakicave kombëtare u shpërndanë në pikat e kalimit kufitar, me vendndodhje pranë territoreve të banuara nga pakicat kombëtare. Komisioneve zonale të administrimit të zgjedhjeve (KZAZ-ve) që ushtronin veprimtarinë në territore me vendbanim të pakicave kombëtare, u janë shpërndanë fletëpalosje edhe në gjuhë të pakicave kombëtare përkatëse.

Fletëpalosjet në gjuhë të pakicave kombëtare u shpërndanë në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat që u përkasin pakicave kombëtare përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, bazuar në informacionin e dërguar nga Ministria e Brendshme, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, e cila referonte të dhëna për popullsinë banuese dhe pakicat kombëtare përkatëse në nivel bashkie, si dhe në nivel qarku. Posterat informues dhe edukues në gjuhë të pakicave kombëtare (5 lloje), u dërguan në KZAZ-të përkatëse për t'u shpërndarë dhe afishuar në qendrat e votimit me vendndodhje në njësitë e vetëqeverisjes vendore me numrin më të madh të pakicave kombëtare. Informacione për zhvillimin e procesit zgjedhor të datës 30.6.2019, si dhe mesazhe sensibilizuese për pjesëmarrje në votime u përcollën nga Komiteti Shtetëror i Pakicave Kombëtare, në kuadër të bashkëpunimit me KQZ-



në, përmes hapësirës mediatike në gjuhë të secilës pakicë kombëtare në Radio-Televizionin Shqiptar (lajmet ditore).

6. U realizua projekti i veçantë “Vota ime vlen” për pakicën kombëtare rome dhe atë egjiptiane në bashkëpunimin me IRCA (Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri), mbështetur nga Instituti Demokratike Amerikan (NDI), në 12 qarqet e vendit. Gjithashtu, KQZ-ja, në bashkëpunim me prezencën e OSCE-së, realizoi në vendqëndrimet e komuniteteve rome dhe egjiptiane projektin informues dhe ndërgjegjësues me fokus gratë dhe të rinjtë. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, përcakton se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka si kompetencë drejtimin e punës për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve. Aktualisht po punohet për hartimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

Programi i veçantë për pakicat kombëtare, parashikon mjete dhe mënyra, jo vetëm të shkruara, por edhe përmes spoteve televizive, duke synuar që zgjedhësit që u përkasin pakicave kombëtare, edhe në gjuhën e pakicave kombëtare:

- të informohen për të drejtat dhe detyrat e zgjedhësit gjatë periudhës zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve;

- llojin e zgjedhjeve, orarin e votimit, kush gëzon të drejtën për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur;

- dokumentet e identifikimit të vlefshme për votim;

- kontrollin e emrit në ekstraktin e përbërësve zgjedhor dhe në listën e zgjedhësve, hapat që duhen ndërmarrë për korrigjimin e pasaktësive apo mungesës së emrit në lista;

- procedurat e votimit, ku në fokus do të jetë procedurat për identifikimin elektronik;

- veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;

- informimin mbi procesin zgjedhor: sistemin e zgjedhjeve për Kuvend, përmbajtjen e fletës së votimit, kandidatët për deputetë, formulën e shpërndarjes së mandateve; administrimin e procesit zgjedhor të datës 25 prill 2021, ndërgjegjësimin, për:

- vlerën që ka vota e lirë dhe e pandikuar në zgjedhjet demokratike;

- shmangien dhe denoncimin e veprimeve që cenojnë votën e lirë dhe sistemin e zgjedhjeve demokratike;

- pjesëmarrjen në votime, si e drejtë kushtetuese dhe detyrim qytetar për shoqërinë dhe vendin.

SHTOJCA NR. 4

TË DHËNA STATISTIKORE PËR PERIUDHËN 2018–2020, PËR DHUNËN DHE KRIME TË TJERA NË MARRËDHËNIET FAMILJARE – MINISTRIA E BRENDSHME

1. Gjatë vitit 2018

- Janë evidentuar gjithsej 4951 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat;

- Janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori 1914 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në marrëdhëniet familjare, prej të cilave 1373 raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 608 autorë.

- Janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 3037 raste të dhunës në familje.

- Janë evidentuar 11 vrasje në familje, me 20 viktimë, prej të cilave gra/vajza janë 11 dhe nga këto 4 kanë qenë bashkëshorte.

2. Gjatë vitit 2019

- Janë evidentuar gjithsej 4629 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat;

- Janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori në 1793 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në marrëdhëniet familjare, prej të cilave 1341 raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 535 autorë.

- Janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 2836 raste të dhunës në familje.

- Janë evidentuar 14 vrasje në familje, me 17 viktimë, prej të cilave gra/vajza janë 12 dhe nga këto 8 kanë qenë bashkëshorte.

3. Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2020

- Janë evidentuar gjithsej 2053 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat;

- Janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori 847 raste të dhunës dhe krimeve të tjera



në marrëdhëniet familjare, prej të cilave 674 raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 270 autorë.

- Janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 1206 raste të dhunës në familje.

- Janë evidentuar 4 vrasje në familje, nga të cilat janë shkaktuar 5 viktima, prej të cilave gra/vajza janë 4 dhe nga këto 3 kanë qenë bashkëshorte.

4. Tabela përmbledhëse e të dhënave për dhunën në familje.

Viti	Raste dhune në familje/ evidentuar gjithsej	Kërkesëpadi për UMM/UM	Procedime neni 130/a, K.P.	Arrestuar për 130/a	Vrasje në familje
2018	4951	3037	1373	608	11
2019	4629	2836	1341	535	14
2020 6-mujori	2053	1206	674	270	4

SHTOJCA NR. 5

TË DHËNA MBI PROCEDIMET PENALE (DHUNA) – PROKURORIA E PËRGJITHSHME

- Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 1349 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 1050 procedime;
- Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 1239 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 878 procedime;
- Gjatë vitit 2020 (6-mujori I) janë regjistruar 554 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 380 procedime.

SHTOJCA NR. 6

TË DHËNAT STATISTIKORE, MBI TRAFIKIMIN, PARAQITUR NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË PËR PERIUDHËN 2014 – KORRIK 2020, paraqiten si më poshtë:

Për vitin 2018, janë evidentuar në total 38 vepra penale me 51 autorë, sipas veprave penale:

- 30 vepra penale për “Trafikimi personave të rritur”, me 42 autorë.
- 8 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 9 autorë.

Për vitin 2019, janë evidentuar në total 41 vepra penale me 62 autorë, sipas veprave penale:

- 34 vepra penale për “Trafikim i personave”, me 21 autorë.
- 7 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 8 autorë.

Për periudhën janar–korrik 2020 janë evidentuar në total 20 vepra penale me 25 autorë, sipas veprave penale:

- 16 vepra penale për “Trafikim i personave”, me 21 autorë;
- 4 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 4 autorë.



SHTOJCA NR. 7

TË DHËNA MBI TRAJNIMET E REALIZUARA NGA POLICIA E SHTETIT “PËR GARANTIMIN E TË DREJTAVE TË SHTETASVE TË SHOQËRUAR, NDALUAR, ARRESTUAR NË AMBIENTET E POLICISË, PARANDALIMI I TORTURËS DHE KEQTRAJTIMIT NË AMBIENTET E POLICISË”

Nr.	Viti	Nr. i trajnimeve	Nr. i pjesëmarrësve
1	2014	16	334
2	2015	6	93
3	2016	6	110
4	2017	0	0
5	2018	1	23
6	2019	2	12
7	Janar–qershor 2020	0	0
		Gjithsej 31 trajnime	572 punonjës të trajnuar

SHTOJCA NR. 8

MASAT DISIPLINORE TË DHËNA NDAJ PERSONELIT POLICOR PËR USHTRIM DHUNE, KEQTRAJTIME DHE SHKELJE TË TJERA TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE, JANË SI VIJON PËR PERIUDHËN 2014–2020

Nr.	Lloji masës/viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1	Përfshirje nga Policia	-	10	6	5	1	4	1
2	Ulje me një gradë për 6 muaj	1	-	3	-	-	-	-
3	Shtyrje e afatit të gradimit deri 2 vjet	2	3	6	13	2	13	2
4	Pezullim pa pagesë deri 30 ditë	8	3	-	-	-	-	-
5	Masa të lehta	-	5	44	9	1	9	3
6	Në proces hetimi	-	-	-	-	4	-	-
7	Totali	11	21	59	27	8	26	6

SHTOJCA NR. 9

TRAJNIME – DHUNA ME BAZË GJINORE DHE DHUNA NDAJ GRAVE. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË

- Përmirësimi i kuadrit ligjor në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.
- Dhuna në familje dhe roli i autoriteteve përgjegjëse.
- Kompjuterizimi i të dhënave dhe përdorimi i sistemit *on-line* të rasteve të dhunës në familje.
- Buxheti gjinor dhe ngritja e kapaciteteve të nëpunësve gjinorë në nivel qendror dhe vendor.
- Trajnimi i nëpunësve gjinorë të ministrive.
- Standardet evropiane lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin – rëndësia e njohjes dhe zbatimit nga sistemi i drejtësisë.
- Trajnime të punonjësve të policisë, për dhunën në familje, në drejtoritë vendore të policisë.
- “Roli i Policisë së Shtetit në zbatim të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

dhe në mekanizmin e reagimit të koordinuar ndaj dhunës në familje”.

- “Hetimi i krimeve seksuale”, ku janë trajnuar 60 specialistë për dhunën në familje, të miturit dhe krimet seksuale, si dhe specialistë të krimeve në komisariatet e policisë.

- Trajnime për njohjen dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore në adresimin e dhunës në familje.

SHTOJCA 10

INFORMACION MBI TRAJNIMET PERIODIKE TË KRYERA NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

- Viktima e mitur në procesin penal. I mituri viktimë i veprave penale me natyrë seksuale. Standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut GJEDNJ-së në lidhje me marrjen në pyetje të të miturit dhe përdorimin e deklarimeve të të miturit si provë në procesin penal. Risitë e



ndryshimeve ligjore në Kodin e Procedurës Penale, si edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. Viktima e mitur e trafikimit dhe shfrytëzimit. Risetë në Kodin e Procedurës Penale, në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

- Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave.

- Konventat e Hagës me fokus në të drejtën familjare dhe të drejtat e fëmijëve. Roli i gjyqësorit në zbatimin e tyre.

- Konventa e Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së. Trajtime me fokus konventat e Hagës të detyrueshme për Shqipërinë.

- Zbatimi në praktikë i Konventës së Hagës; përditësimi i gjyqësorit shqiptar me jurisprudencën e GJEDNJ-së.

- Trafikimi i qenieve njerëzore. Ndjekja dhe gjykimi penal i veprave të trafikimit të qenieve njerëzore në përputhje me risitë në Kodin e Procedurës Penale. Të drejtat e viktimës së trafikimit gjatë procesit penal.

- Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Roli i gjykatës me fokus problematikën e praktikës gjyqësore.

- Detyrimet që burojnë nga Konventa e Stambollit dhe rekomandimet e Komitetit Grevio për sistemin e drejtësisë.

- Ndryshimet në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe bashkërendimi institucional në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.

- Rrethi i subjekteve që gëzojnë mbrojtje nga ligji nr. 9669/2006 dhe subjekteve të mbrojtura nga neni 130/a i Kodit të Familjes;

- Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave.

- Roli i alternativave të dënimit me burgim dhe shërbimi i provës. Lirimi para kohe me kusht si një nga alternativat e dënimit me burgim. Praktika

gjyqësore. Marrëdhëniet e shërbimit të provës me prokurorinë në fazën e ekzekutimit.

- Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, në këndvështrim të ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017:

- ekstradimi;

- arresti i përkohshëm;

- njohja e vendimit penal të huaj për të gjykuarin në mungesë “*in absentia*” nga autoriteti gjyqësor i huaj.

- Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave.

- Gjikimi në mungesë.

- Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me fokus kryesor praninë e të pandehurit në gjykim.

- Probleme të praktikës gjyqësore shqiptare pas ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017.

- Barazia gjinore dhe dhuna me bazë gjinore me fokus ndryshimet ligjore, shërbimet ndaj viktimës dhe rehabilitimin/punën me dhunuesit.

VENDIM

Nr. 394, datë 30.6.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1151, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOZHME PËR VITIN 2021 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1151, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 2 572 punonjës.

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, bëhen këto shtesa:

a) Shtohet ndarja “Gr. 73, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në ndarjen “Gr. 05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, në ndarjen “Gr. 10, Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, në ndarjen “Gr. 13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” dhe në ndarjen “Gr. 41, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” shtohen nëndarjet përkatëse, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Periudha kohore e 2 punonjësve manovratorë dhe e 10 punonjësve mirëmbajtës zgarash për Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Durrës, e përcaktuar në ndarjen “Gr. 05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, bëhet 6 muaj.

II. Ngarkohen Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar që të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhën kohore të punësimit dhe kategorinë përkatëse të pagës së tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Tabela nr.1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
05	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	70			
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	1	kontrollor	6 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	6	operator sistemi	6 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	2	sanitar	6 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	11	Roje/mirëmbajtës	6 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Drejtoria Rajonale Shërbimeve të Veterinarisë Elbasan	2	punonjes arkive	6 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Drejtorite Rajonale Shërbimeve të Veterinarisë	47	teknikë të mesëm (veterinere)	6 orë/ditë	qershor-dhjetor
	AREB Tirane	1	punonjes arkive	6 orë/ditë	qershor-dhjetor
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	10			
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Menaxhimit të	1	Specialist	8 orë/ditë	korrik-dhjetor
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Financave Vendore)	1	Specialist	8 orë/ditë	korrik-dhjetor
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Bashkrendimit	1	Specialist	8 orë/ditë	korrik-dhjetor
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Huamarrjes)	1	Specialist	8 orë/ditë	korrik-dhjetor
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Privatizimit)	1	Specialist	8 orë/ditë	korrik-dhjetor
	Inspektoriat Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve	5	punonjes arkive	8 orë/ditë	korrik-dhjetor
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	16			
	Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastr	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Shtëpia e të Moshuarve Fier	1	Sanitar	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Shtëpia e të Moshuarve Fier	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Shtëpia e të Moshuarve Kavaje	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Shtëpia e të Moshuarve Kavaje	1	Sanitar	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Qendra Polivalente Perkuqdesit Social Polican	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Shtëpia e Foshnjës Durrës	1	Mjek pediater	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Shtëpia e Foshnjës Korçë	1	Mjek pediater	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Shtëpia e Foshnjës Shkoder	1	Mjek pediater	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Shtëpia e Foshnjës Vlorë	1	Mjek pediater	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Shkoder	1	Mjek pediater	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Sarandë	1	Mjek pediater	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Qendra e Zhvillimit Korçë	1	Mjek	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Qendra e Zhvillimit Vlorë	1	Mjek	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Qendra e Zhvillimit Berat	1	Mjek	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
	Qendra e Zhvillimit Shkoder	1	Mjek	4 orë/ditë	qershor-dhjetor
41	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	3			
	Administrata e Strukturës	3	Specialist	8 orë/ditë	korrik-dhjetor
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1			
	Administrata e KQZ	1	Specialist	8 orë/ditë	korrik-dhjetor
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	100			



VENDIM
Nr. 411, datë 8.7.2021

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË
TELEGRAFIKE SHQIPTARE (ATSH)**

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Armela Krasniqi, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Valbona Zhupa emërohet drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 422, datë 8.7.2021

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË FËMIJËS ARBAS HOXHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Arbas Hoxha, në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 423, datë 8.7.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 587, DATË 22.7.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN
E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË
NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA
(PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT
E REJA PËR ZHVILLIM DHE
RINDËRTIM NË TË NJËJTIN TRUALL”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, 18, pika 2, shkronja “c”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 2.1 dhe 3.1, shifra “... 666 179 207 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me shifrën “... 1 666 179 207 (një miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH ...”.



2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 424, datë 8.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 645, DATË 3.8.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) DHE NDËRTESAVE PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSITË ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA “5 MAJI”, DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE 6, ZONA “KOMBINAT”, BASHKIA TIRANË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2.1 e vendimit nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.1 Përdorimi i fondit për vitin 2021 të jetë në masën 990 233 627 (nëntëqind e nëntëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) lekë dhe i transferohet Bashkisë Tiranë për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike,

Faqe | 10124

në zonat e reja për zhvillim në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji”, dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat”, Bashkia Tiranë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 425, datë 8.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3.1 e vendimit nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.1 Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2021, do të jetë në masën 1 331 932 076 (një miliard e treqind e tridhjetë e një milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, nga të cilat:



a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 897 566 799 (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi prej 434 365 277 (katërqind e tridhjetë e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh, pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 426, datë 8.7.2021

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO NDËRHYRJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9,

datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 2.1, shtohet pika 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.2 Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2021, do të jetë në masën 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë pa TVSH, nga i cili:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 500 000 000 (pesëqind milionë) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM
Nr. 427, datë 8.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 26, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË DHE ÇAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në bashkitë Kamzë dhe Kavajë, në masën 914 561 348 (nëntëqind e katërmbydhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit dhe detajohet, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 445 562 231 (katërqind e dyzet e pesë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

b) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi në masën 468 999 117 (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Efektu financiar, sipas kësaj pike, të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit

në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë e Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 428, datë 8.7.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË BASHKINË KURBIN DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 266 835 173 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Milot”, Bashkia Kurbin, në masën 147 116 112 (njëqind e dyzet e shtatë milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Milot”, Bashkia Kurbin, në masën 119 719 061 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH.



2. Bashkisë Kurbin, për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 53 367 034 (pesëdhjetë e tre milionë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, për rikonstruksionin e objekteve arsimore, detajuar, si më poshtë vijon:

a) Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Milot”, Bashkia Kurbin, në masën 29 423 222 (njëzet e nëntë milionë e katërqind e njëzet e tre mijë e dyqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH;

b) Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Milot”, Bashkia Kurbin, në masën 23 943 812 (njëzet e tre milionë e nëntëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese për rikonstruksionin e objekteve arsimore, shkollës 9-vjeçare “Milot” dhe shkollës së mesme “Milot”, Bashkia Kurbin.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

UDHËZIM
Nr. 269, datë 1.7.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
SË REGJISTRIMIT NË REGJISTRIN
KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE TË
VITIT 2010, TË REFUGJATIT OSE TË
PERSONIT NËN MBROJTJE
PLOTËSUESE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, të nenit 92, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21, 33 dhe 59 të ligjit nr. 10129, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010, të refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.

2. Të dhënat e refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese që i është miratuar leja e qëndrimit, importohen elektronikisht nga Regjistri Elektronik për të Huajt (FER) në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC).

3. Refugjati ose personi nën mbrojtje plotësuese paraqitet për regjistrimin e vendbanimit pranë zyrës së gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative në juridiksionin e së cilës ndodhet ndërtesa. Nëpunësi i gjendjes civile, pasi verifikon përputhshmërinë e të dhënave të dokumenteve të paraqitura, kryen regjistrimin e vendbanimit, duke aktivizuar më pas të dhënat e gjeneruara automatikisht nga ndërlidhja e sistemit FER në RKGJC.

4. Refugjatit ose personit nën mbrojtje plotësuese, të cilit leja e qëndrimit i lëshohet për herë të parë, duhet që brenda 30 ditëve nga dita e tërheqjes së dokumentit të lejes së qëndrimit, të regjistrojë vendbanimin pranë zyrës së gjendjes civile në bashki/njësisë administrative përkatëse, duke paraqitur:

a) kërkesën me shkrim dhe lejen e qëndrimit;

b) dokumentin e pronësisë së banesës ose kontratë qiramarrjeje/huadhënie/përdorimi apo banimi; kontratën apo çdo dokument tjetër të ligjshëm, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që i jep personit të drejtën e përdorimit të banesës; ose vërtetimin e vendbanimit të lëshuar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, nëse personi është me qëndrim pranë Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkues.

5. Për ndryshimin e vendbanimit të refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese, zbatohet legjislacioni në fuqi për gjendjen civile.

6. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, sa herë që e çmon të nevojshme, kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, informacionin e plotë për refugjatin ose personin nën mbrojtje plotësuese të regjistruar në RKGJC.

7. Me marrjen e informacionit për ndryshime në përbërësit e gjendjes civile për refugjatin ose personin nën mbrojtje plotësuese, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, njofton



Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ndjek këtë veprimtari me zyrat respektive të gjendjes civile në bashki/njësi administrative në vlerësimin e dokumentacionit dhe përcjelljen e akteve të nevojshme shkresore për përditësimin e të dhënave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

9. Urdhri nr. 28, datë 16.1.2017, “Për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të shtetasve të huaj që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

VENDIM

Nr. 277, datë 1.7.2021

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT, NË ZBATIM TË NENIT 10, TË LIGJIT NR. 115/2016, “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 10, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Formular në zbatim të nenit 10, të ligjit nr. 115/2016, ‘Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë’, të ndryshuar”, sipas modelit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

FORMULAR

NË ZBATIM TË NENIT 10, TË LIGJIT NR. 115/2016, “PËR ORGANET E
QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR

(Dhënie e informacionit mbi të afërmit e shkallës së dytë (ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër) dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit (prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra), që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor.)

I. TË DHËNAT E GJYQTARIT QË KONKURRON PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR:

EMRI:
MBIEMRI:
ATËSIA:
GJYKATA:
BASHKËSHORTI/JA /BASHKËJETUESI/JA (nëse ka):

II/A A USHTRON NË MËNYRË AKTIVE PROFESIONIN E AVOKATIT NDONJË I AFËRM I JUAJI I SHKALLËS SË DYTË (UNGJ/EMTË, NIP/MBESË, GJYSH/GJYSHE, GJYSMË VËLLA/MOTËR)? (vendosni shenjë x përmbri përgjigjes)

PO

☐

JO

☐

(Nëse përgjigjeni PO, specifikoni të dhënat për personin dhe aktivitetin që ushtron.)

(emër, mbiemër, nënshkrim)



II/B A ËSHTË PRONAR OSE DREJTUES EKZEKUTIV NË SUBJEKTET EKONOMIKE, TË CILAT KLASIFIKOHEN SI TATIMPAGUES TË MËDHENJ NGA AUTORITETI TATIMOR, NDONJË I AFËRM I JUAJI I SHKALLËS SË DYTË (UNGJ/EMTË, NIP/MBESË, GJYSH/GJYSHE, GJYSMË VËLLA/MOTËR)? (Vendosni shenjë x përmbri përgjigjes.)

PO ☐JO ☐

(Nëse përgjigjeni PO, specifikoni të dhëna për personin dhe aktivitetin që ushtron.)

III/A A USHTRON NË MËNYRË AKTIVE PROFESIONIN E AVOKATIT NDONJË I AFËRM I SHKALLËS SË PARË (PRINDËR, FËMIJË DHE VËLLEZËR/MOTRA) I BASHKËSHORTIT/ES /BASHKËJETUESIT/ES TUAJ? (Vendosni shenjë x përmbri përgjigjes.)

PO ☐JO ☐

(Nëse përgjigjeni PO, specifikoni të dhëna për personin dhe aktivitetin që ushtron.)

III/B A ËSHTË PRONAR OSE DREJTUES EKZEKUTIV NË SUBJEKTET EKONOMIKE, TË CILAT KLASIFIKOHEN SI TATIMPAGUES TË MËDHENJ NGA AUTORITETI TATIMOR NDONJË I AFËRM I SHKALLËS SË PARË (PRINDËR, FËMIJË DHE VËLLEZËR/MOTRA) I BASHKËSHORTIT/ES/BASHKËJETUESIT/ES TUAJ? (Vendosni shenjë x përmbri përgjigjes.)

PO ☐JO ☐

(Nëse përgjigjeni PO, specifikoni të dhëna për personin dhe aktivitetin që ushtron.)

Unë, i/e nënshkruari/a _____, me nënshkrimin e këtij formulari konfirmoj nën përgjegjësinë time saktësinë e të dhënave të pasqyruara.

Datë _____._____._____

EMRI MBIEMRI

nënshkrimi

**KËRKESË****Nr. 5436, datë 6.7.2021****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rehabilitimi i fasadës së pallatit të kryqëzimi i Rrugës së Dibrës me Unazën e Vogël”, Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për

pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 16 848 178 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI, ME OBJEKT “REHABILITIMI I FASADËS SË PALLATIT TE KRYQËZIMI I RRUGËS SË DIBRËS ME UNAZËN E VOËLË”, TIRANË

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pas.	Sip. përgj. truall m ²	Sip. prekur truall m ²	Çmimi për truall lek/m ²	Vlera truall i prekur (lek)	Sip. objekti sipas kartelës (m ²)	Sip. objekt shërbimi (m ²)	Sip. banimi (m ²)	Çmimi për objekt banimi (lek/m ²)	Vlera sip. prekur objekt shërbimi me situacion (lek)	Vlera sip. prekur objekt banimi (lek)	Vlera e përgjithshme truall + objekt (lek)	Shënime në kartelë	Konfirmim i ASHK-së Tiranë
1	B.P. Sallaku	Truall	8360	7/150	25	25	66969	1674225				151202			1674225		Konfirmuar me shkresën nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020
2	B.P. Vathi, Lleshi, Vathi (Disha)	Truall	8360	7/220	30	30	66969	2009070				151202			2009070	C- V.K.K.P.	Konfirmuar me shkresën nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020
3	B.P. Vathi	Truall	8360	7/219	28	28	66969	1875132				151202			1875132	C- V.K.K.P., D. Trashëgimie	Konfirmuar me shkresën nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020
4	B.P. Vaqari, Kujxhiu. Toska	Truall	8360	7/422	23	23	66969	1540287				151202			1540287	Ndërtesa nuk ekziston sipas VKM. nr. 236, datë 30.3.2016; T. nd. pasurie VKM nr. 236, datë 30.3.2016 (Sektori i shpronësimeve: Ndërtesa në pasurinë mëmë 7/149 është shpronësuar me VKM-në nr. 723, datë 16.9.2020, për pasurinë nr. 7/422. shpronësime vetëm truallin	Konfirmuar me shkresën nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020
5	Bujar Isuf Bucalija	Truall	8360	7/424	36	36	66969	2410884				151202			2410884	C- T. nd. pasurie	Konfirmuar me shkresën nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020
6	B.P. Dinc	Njesi	8360	7/437/ND-N2	0	0	66969	0	39.20	39.2			793410		793410	C - Leje legalizimi; e- Kufizohen veprimet deri ne zgjidhjen e marrëdhënies me truallin	Konfirmuar me shkresën nr. 2351/1 prot., datë 9.9.2020, nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020
7	B.P. Caushi	Apartament	8360	7/151+1-11	0	0	66969	0	113.00	0	39	151202	0	5896878	5896878	C- Transaksion i gjeneruar nga bashkim pasurish	Konfirmuar me shkresën nr. 2351/1 prot., datë 9.9.2020, nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020
8	Liljana Siri Vogli	Njesi	8360	7/151-N9	0	0	66969	0	68.00	11	0	0	159880	0	159880	C- A.K.P.	Konfirmuar me shkresën nr. 2351/1 prot., datë 9.9.2020, nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020
9	B.P.Liaci	Njesi	8360	7/151-N1	0	0	66969	0	75.00	9.8	0	0	221143	0	221143	C- A.K.P. Bllokohet në favor të Bankës Kombëtare Tregtare	Konfirmuar me shkresën nr. 2351/1 prot., datë 9.9.2020, nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020
10	Vjollca Kita	Njesi	8360	7/151-N10	0	0	66969	0	42.00	13.52	0	0	267269	0	267269	C- 4181992; 291/2000; D- Pasuria rivlerësohet me shumën 10 920 000	Konfirmuar me shkresën nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020
Vlera totale paraprake															16848178		

1. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në shkresat e ASHK-së nr. 8324 prot., datë 24.2.2020, nr. 2351/1 prot., datë 9.9.2020, nr. 8324/2 prot., datë 22.2.2020, nr. 2351/3 prot., datë 7.10.2020.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
3. Për objektet e banimit 7/151+1-1, vlerësimi është bërë sipas çmimit mesatar të shitblerjes për 3 muajt e fundit të objekteve të banimit përcjellë me shkresën nr. prot. 2351/3, datë 7.10.2020, të ASHK-së, Tirana Veri.
4. Për objektet me funksion social-ekonomik (njësitë e shërbimit), vlerësimi është bërë sipas kostos së ndërtimit, bazuar në çmimet e EKB-së, për qytetin e Tiranës.

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. (662) 1, datë 21.6.2021, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Osman Halilaj, i datëlindjes 3.5.1977, lindur në Skavicë, Kukës.

KËRKESË

Shtetasi Pashuk Nikolla kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër shpalljen të vdekur të shtetasit Kol Nikolla, i datëlindjes 1.5.1922.

KËRKUES
Pashuk Nikolla

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë